



Ligji Nr. 04/L-042

PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe
Ligjin Nr. 05/L-092

(Versioni i Konsoliduar)

- | |
|--|
| - Teksti pa ngjyra është teksti i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Data e hyrjes në fuqi 05.10.2011 |
| - Teksti me ngjyrë të verdhë paraqet ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 05/L-068. Data e hyrjes në fuqi 21.01.2016 |
| - Teksti me ngjyrë të kaltër paraqet ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 05/L-092. Data e hyrjes në fuqi 01.03.2016 |

Ky version nuk është zyrtar dhe është përgatitur për nevojat e brendshme të KRPP-së, AQP-së, OSHP-së, autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik dhe personat tjerë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit.

LIGJI Nr. 04/L-042

PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PËRMBAJTJA

PJESA I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kreu I. Qëllimi, Fushëveprimi, Përjashtimet, Përkufizimet

Neni 1 Qëllimi

Neni 2 Fushëveprimi

Neni 3 Përjashtimet

Neni 4 Përkufizimet

Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore

Kreu II Parimet e Përgjithshme

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Kreu III Kërkesat e Përgjithshme

Neni 8 Planifikimi i Prokurimit

Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Neni 12 Valutat, Pagesat dhe Kushtet e Zakonshme të Kontratës

Neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik

Neni 14 Pranuesit e të Drejtave të Veçanta ose Ekskluzive që Angazhohen në Aktivitete të Shërbimeve Publike

Kreu IV Rregullat për Vlerësimin dhe Klasifikimin e Kontratave Publike dhe Konkurseve të Projektimit

Neni 15 Klasifikimi i Kontratave të Përziera

Neni 16 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim

Neni 17 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime

Neni 18 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës së Punëve

Neni 19 Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar

Neni 20 Klasifikimi i Konkursit të Projektimit sipas Vlerës

Neni 21 Kufizimet për zbatimin e Neneve 16-20

Neni 21/A Ekonomizimi i aktivitetit të prokurimit

Kreu V Autorizimi për iniciimin e një aktiviteti të prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës Publike

Neni 22 Iniciimi i aktivitetit të prokurimit

Neni 23 Zyrtarët e Prokurimit

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit

Neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike

PJESA II

Kreu I Rregullat për specifikimet teknike dhe dosjen e tenderit

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 27/A Ndarja e kontratave në Lote

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 29 Variantet e specifikimeve teknike

Neni 30 Nën-kontraktimi

Neni 31 Ekzekutimi i kontratave

Kreu II Llojet dhe Zbatueshmëria e Procedurave të Prokurimit

Neni 32 Rregullat e Përgjithshme

Neni 33 Procedurat e hapura dhe të kufizuara

Neni 34 Procedurat konkurruese me negociata

Neni 35 Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

Neni 36 Procedurat për kuotimin e çmimeve

Neni 37 Procedurat për kontratat me vlerë minimale

Neni 38 Kontratat Publike Kornizë

Kreu III Rregullat mbi Reklamimin dhe Transparencën

Neni 39 Njoftimi Paraprak

Neni 40 Njoftimi i Kontratës

Neni 41 Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës

Neni 41/A Njoftimi për nënshkrimin e kontratës

Neni 42 Publikimi i njoftimeve

Neni 43 Forma dhe Përmbajtja e Njoftimeve

Neni 44 Rregullat e Përgjithshme mbi Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje

Neni 45 Rregullat e posaçme për përcaktimin e afatit kohor për pranimin e tenderëve të një kontrate publike të përfshirë nga një njoftim paraprak

Neni 46 Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore

Neni 47 Fillimi i Afatit Kohor për Pranimin e Kërkesave për Pjesëmarrje dhe Tenderëve

Neni 48 Dorëzimi i Dosjes së Tenderit

Neni 49 Mënyra e Dërgimit të Kërkesave për Pjesëmarrje

Neni 50 Dërgimi dhe Përmbajtja e Ftesave për Tender

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Neni 54 Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Neni 55 Mënyrat e Komunikimit

Kreu IV Udhëheqja e Procedurave të Prokurimit

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 57 Sigurimi i Tenderit

Neni 58 Hapja e Tenderëve

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 63 Siguria e Ekzekutimit

Kreu V Kërkesat e Përshtatshmërisë dhe të Kualifikimit

Neni 64 Dëshmitë e kërkesave

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

Neni 67 Provat Shkresore

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

PJESA III

RREGULLAT PËR KONKURSET E PROJEKTIMIT

Neni 73 Dispozitat e Përgjithshme

Neni 74 Fushëveprimi

Neni 75 Njoftimi mbi Konkursin e Projektimit

Neni 76 Formulari dhe Përmbajtja e Njoftimeve për Konkursin e Projektimit

Neni 77 Publikimi i Njoftimeve për Konkursin e Projektimit

Neni 78 Njoftimi mbi Rezultatet e Konkursit të Projektimit

Neni 79 Mjetet e komunikimit

Neni 80 Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

PJESA IV

Neni 81 Aktivitetet e Menaxhimit të Kontratës

PJESA V Aktivitetet e Prokurimit të Operatorëve të Shërbimeve Publike

Neni 82 Fushëveprimi

Neni 83 Ftesa për tender me anë të Njoftimit Paraprak

Neni 84 Sistemi i Kualifikimit

Neni 85 Vlerësimi i Aplikantëve në Sistemin e Kualifikimit

PJESA VI

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Neni 86 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

Neni 87 Funksionet Themelore të KRPP-së

Neni 88 Funksionet e Vëzhgimit dhe të Mbikëqyrjes të KRPP-së

Neni 89 Emërimi i Anëtarëve

Neni 90 Organizimi dhe Votimi në KRPP

Neni 91 Masat Zbatuese.

Neni 92 Fshtetësia

Neni 93 Pezullimi dhe Suspendimi i Anëtarëve të KRPP-së

PJESA VII

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

Neni 94 Agjencia Qendrore e Prokurimit

Neni 95 Aktivitetet e Prokurimit të AQP

Neni 96 Emërimi, Largimi dhe Pezullimi i Drejtorit të AQP-së

Neni 97 Fshehtësia

PJESA VIII

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Neni 98 Organi Shqyrtues i Prokurimit

Neni 99 Funksionet dhe Kompetencat e OSHP

Neni 100 Emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të OSHP-së

Neni 101 Suspendimi, largimi dhe shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të OSHP-së

Neni 102 Organizimi i OSHP

PJESA IX

PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PROKURIMIT

Kreu I Dispozitat e përgjithshme

Neni 103 Fushëveprimi

Neni 104 Parimet themelore

Kreu II

Neni 105 Kompetencat e OSHP-së

Neni 106 Themelimi dhe përbërja e paneleve shqyrtuese

Neni 107 Rregullorja e procedurave të OSHP-së

Neni 108 Konfidencialiteti

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Kreu III Fillimi dhe Zbatimi Fillestar i Procedurave të Shqyrtimit

Neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës

Neni 110 Autoriteti për të ndjekur ankesat

Neni 111 Arkivimi dhe Përmbajtja Thelbësore e Ankesës

Neni 112 Efekti pezullues i ankesave

Neni 113 Shqyrtimi fillestar nga eksperti shqyrtues

Neni 114 Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues

Neni 115 Vendimi i autoritetit kontraktues

Kreu IV Procedurat para OSHP-së

Neni 116 Procedurat e vendim-marrjes.

Neni 117 Afati i fundit për marrjen e vendimeve

Neni 118 Siguria, Gjobat dhe Dëmet

Neni 119 Veprimet e Gjykatave

Kreu V Raportimi

Neni 120 Raportimi në Kuvend

Neni 121 Dërgimi i Informacioneve

PJESA X

PROCEDURAT E POSAÇME TË PROKURIMIT PËR MISIONET DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE

Neni 122 Përgjegjësitë për Prokurim në Misionet Diplomatike dhe Konsullore

Neni 123 Kontratat me Vlerë të Mesme dhe të Madhe

Neni 124 Miratimi

Neni 125 Përdorimi i Procedurës së Negociuar

Neni 126 Përdorimi i Procedurës së Kuotimit të Çmimeve

Neni 127 Mos zbatimi i Neneve 57 dhe 63

Neni 128 Konsultimi mes KRPP dhe MPJ

PJESA XI

Neni 129 Prokurimi Elektronik

PJESA XII Mjetet juridike, dispozitat ndëshkimore dhe përfundimtare

Kreu I Shkeljet e Ligjit dhe Ndëshkimet

Neni 130 Ndikimi i Paligjshëm

Neni 131 Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues

Neni 132 Prokurimet e Mbyllura në Kundërshtim me Këtë Ligj

Neni 132/A Kontraktimi i shërbimeve nga OSHC

Neni 133 Deklaratat e jo-efektivitetit

Neni 134 Hyrja në Fuqi

Kreu II Dispozitat Përfundimtare

Neni 134 Shfuqizimi i Legjislacionit të Mëparshëm

Neni 135 Hyrja në fuqi e ligjit

PJESA I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

KREU I QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI, PËRJASHTIMET, PËRKUFIZIMET

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky ligj vlen për të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese dhe koncesionerëve të punëve, ashtu siç janë përkufizuar këto terme në këtë ligj. Gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre të prokurimit, autoritetet kontraktuese dhe koncesionerët janë të obliguara që të zbatojnë dhe respektojnë kërkesat procedurale dhe përmbajtjesore të këtij ligji.
2. Ky ligj vlen për të gjithë personat, operatorët ekonomik, dhe ndërmarrjet, ashtu si përcaktohen këto terme në këtë ligj, që janë të përfshirë, marrin pjesë ose interesohen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitete prokurimi të rregulluara me këtë ligj; nga personat e tillë, operatorët, dhe ndërmarrjet gjithashtu kërkohet që t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji.

3. Të gjithë operatorët e shërbimeve publike mund të përdorin rregullat specifike procedurale të përcaktuara në Kreun V të këtij ligji në bazë të kushteve të përcaktuara në Kreun V.
4. Misionet diplomatike të Republikës së Kosovës u nënshtrohen rregullave të posaçme të përcaktuara në dispozitat e posaçme në Pjesën X të këtij ligji.

Neni 3 **Përfshirjet**

1. Ky ligj do të zbatohet për kontratat e prokurimit publik, të shpërblyera nga autoritetet kontraktuese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me përfshirje të kontratave të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.
2. Rregullat e prokurimit për qëllime të mbrojtjes dhe të sigurisë, do të zbatohen për prokurimet si në vijim:
 - 2.1. Furnizimi i pajisjeve ushtarake, duke përfshirë çdo pjesë dhe/ose komponentë të tij;
 - 2.2. Furnizimi i pajisjeve të ndjeshme, duke përfshirë çdo pjesë dhe/ose komponentë të tij;
 - 2.3. Punët, furnizimet dhe shërbimet e ndërlidhura drejtpërdrejt me pajisjet e referuara në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2, të këtij paragrafi për secilin dhe të gjitha elementet e ciklit të jetës së tij;
 - 2.4. Punët dhe shërbimet për qëllime specifike ushtarake; dhe
 - 2.5. Punët dhe shërbimet e ndjeshme.
3. Ky ligj ose rregullat e prokurimit për qëllime të mbrojtjes dhe të sigurisë, nuk do të zbatohen për kontratat e mëposhtme:
 - 3.1. Kontratat që rregullohen me rregullat e veçanta të prokurimit, në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare ose marrëveshje e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe një ose më shumë vendeve të treta;
 - 3.2. Kontratat që rregullohen me rregulla të veçanta të prokurimit, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare lidhur me stacionimin e trupave ushtarake të Republikës së Kosovës;
 - 3.3. Kontratat që rregullohen me rregullat e veçanta të prokurimit të një organizate ndërkombëtare që blen për qëllimet e veta, apo kontrata të cilat Republika e Kosovës duhet të veprojë në përputhje me këto rregulla;
 - 3.4. Kontratat për të cilat aplikimi i dispozitave të këtij ligji ose të rregullores mbi prokurimin për qëllime të mbrojtjes dhe të sigurisë, do të detyrojë Republikën e Kosovës për të dhënë informacion, zbulimi i të cilave është në kundërshtim me interesat thelbësore të sigurisë së tij;
 - 3.5. Kontratat për qëllimet e organeve që kanë të bëjnë me sistemin e inteligjencës;
 - 3.6. Kontratat e dhëna në kuadër të programit të bashkëpunimit, bazuar në kërkim dhe zhvillim, të kryera bashkërisht nga Republika e Kosovës, me një apo më shumë shtete tjera, për zhvillimin e një produkti të ri dhe, kur është e zbatueshme, për fazat e fundit të të gjitha ose të një pjesë të ciklit të jetës së këtij produkti;
 - 3.7. Kontratat e dhëna në një vend të tretë, përfshirë edhe për qëllime civile, ku forcat janë të vendosur jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nëse nevojat operacionale kërkojnë që kontratat të lidhen me operatorët ekonomikë, të vendosur në zonën e

operacioneve;

3.8. Kontratat e lidhura nga organet shtetërore ose njësitë e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës me organet shtetërore ose organet e autoriteteve lokale të një shteti tjetër, dhe në lidhje me furnizimin e pajisjeve ushtarake apo pajisjeve të ndjeshme:

3.8.1. punët dhe shërbimet, të lidhura drejtpërdrejt me pajisje të tilla, ose

3.8.2. punët dhe shërbimet në mënyrë specifike për qëllime ushtarake, ose punët dhe shërbimet e ndjeshme.

3.9. Për zbatimin e paragrafëve 3.4, 3.5 dhe 3.8, vendos Autoriteti Kontraktues dhe për këtë paraprakisht e njofton Kryeministrin e Republikës së Kosovës.

4. Rregullorja mbi prokurimin për qëllime të mbrojtjes dhe të sigurisë që rregullon rregullat, kushtet dhe procedurat e prokurimit të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. Ky ligj nuk zbatohet për aktivitetet e prokurimit që qojnë në dhënien e një kontrate publike, që bie në fushën e veprimit të një marrëveshje, që parashikon zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera të prokurimit, ku (i) kjo marrëveshje e kushtëzon disponueshmërinë e financimit të kontratës në fjalë me zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera, dhe (ii) marrëveshja është lidhur ndërmjet Qeverisë dhe një institucioni financiar ndërqeveritar, dypalësh, shumëpalësh ose ndërkombëtar.

6. Ky ligj nuk do të zbatohet për një kontrate të punësimit, nëse aktiviteti i tillë i prokurimit është lëndë e rregullave të tjera që vendosen me një ligj ose rregullore tjetër. Njëjtë, ligji aktual nuk do të aplikohet për kontratat në lidhje me trajnimet pasuniversitare apo trajnime profesionale nga punëdhënësit për zhvillimin e aftësive specifike të punëtorëve individualë. Për më shumë, ligji nuk do të aplikohet në prokurim ekskluzivisht të orientuar në përfaqësimin në formë të ofrimit të ushqimit dhe pijeve.

7. Ky ligj aplikohet për një Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, vetëm nëse ndërmarrja në pronësi shoqërore është e angazhuar në një aktivitet të shërbimeve publike, në bazë të të drejtave ekskluzive, të cilat i janë dhënë nga një autoritet kompetent publik. Në raste të kështilla, ndërmarrja konsiderohet se është edhe ndërmarrje publike dhe operator i shërbimeve publike dhe do të zbatojë dispozitat përkatëse të këtij ligji.

8. Aktivitetet e prokurimit të cilat qojnë drejt dhënies së një kontrate të koncesionit për punë ose shërbime i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat. Këto aktivitete të prokurimit u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji vetëm deri në masën e përcaktuar në Ligjin për Partneritet Publiko-Privat.

9. Ky ligj nuk aplikohet nga autoritetet kontraktuese për blerjen apo marrjen me qira, përmes çfarëdo metode të financimit, të tokës, objekteve ekzistuese apo pronave tjera të paluajtshme apo në lidhje me të drejta të tilla, përveç nëse me ligjet e veçanta është paraparë ndryshe.

Neni 4 Përkufizimet

1 Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si vijojnë:

1.1. **Zyrtar Autorizues** - personi i autorizuar nga ZKA sipas nenit 22.1 të këtij ligji, si përgjegjës për autorizimin e Zyrtarit të Prokurimit të autoritetit kontraktues për iniciimin e një aktiviteti të prokurimit.

- 1.2. **Agjenci Autonome Ekzekutive** - një autoritet publik që (i) nuk është vetë organizatë buxhetore por është pjesë e një organizate buxhetore, dhe (ii) shprehimisht kërkohet nga një akt primar normativ që të veprojë në mënyrë autonome ose me autonomi substanciale nga organizata buxhetore pjesë e së cilës është.
- 1.3. **Organ i themeluar në bazë të së drejtës publike** - personi, ndërmarrja ose organi që (i) është themeluar me qëllim të veçantë për plotësimin e nevojave të përgjithshme që nuk kanë karakter prodhues ose komercial, dhe (ii) i plotëson këto kritere: (a) merr 50% ose më shumë nga financimi i tij prej fondeve një ose më shumë autoriteteve publike dhe/ose organeve të themeluara në bazë të drejtës publike, (b) i nënshtrohet mbikëqyrjes menaxhuese nga një ose më shumë autoritete publike dhe/ose organe të themeluara në bazë të së drejtës publike, ose (c) ka një bord administrativ, mbikëqyrës ose menaxhues, 50% ose më shumë e votave të cilit mund të ushtrohen nga anëtarët e emëruar nga një ose më shumë autoritete publike dhe/ose organeve të themeluara në bazë të së drejtës publike.
- 1.4. **Kandidat** - një operator ekonomik që ka kërkuar të ftohet ose është ftuar të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit që është duke u ushtruar me procedurë të kufizuar ose të negociuar pa publikim ose procedurë konkurruese me negociata.
- 1.5. **AQP** - Agjencia Qendrore e Prokurimit e themeluar sipas Pjesës VII të këtij ligji.
- 1.6. **Zyrtari Kryesor Administrativ ose ZKA** - do të thotë (i) për komunat, Kryetarin e Komunës, dhe (ii) për organizatat tjera buxhetore (a) Sekretarin e Përgjithshëm, (ii) nëse organizata buxhetore nuk ka Sekretar të Përgjithshëm, atëherë Kryeshefin Ekzekutiv, ose (iii) nëse organizata nuk ka as Sekretar të Përgjithshëm dhe as Kryeshef Ekzekutiv, atëherë personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të organizatës dhe personelit. Në rastin e agjencive autonome ekzekutive, këto terma nënkuptojnë drejtorin ose udhëheqësi e asaj agjencie dhe jo ZKA të organizatës buxhetore pjesë e së cilës është agjencia. Në rastin e ndërmarrjeve publike ose ndërmarrjeve të tjera, ky term nënkupton kryeshefin ekzekutiv, drejtorin menaxhues ose personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të veprimtarisë dhe personelit. Në rastin e misioneve diplomatike të themeluara nga Ministria e Punëve të Jashtme jashtë Kosovës, ky term nënkupton udhëheqësin e misionit.
- 1.7. **Zyrtari Kryesor Financiar ose ZKF** - ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Për ndërmarrjet që nuk janë ndërmarrje publike, ky term nënkupton personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të çështjeve financiare të ndërmarrjes.
- 1.8. **Mallra** - të gjitha produktet, përfshirë energjinë elektrike, të cilat janë të zëvendësueshme dhe çmimet e të cilave janë të kuotuar në një treg ekzistues të mallrave ose në një platformë ose sistem të ngjashëm tregtar.
- 1.9. **Specifikim i përbashkët teknik i Bashkimit Evropian** - specifikimi teknik të përpiluar në përputhje me procedurën e njohur nga shtetet anëtare, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
- 1.10. **Artikuj të përdorimit të përbashkët** - prodhimi ose shërbimi i kërkuar nga një ose më shumë autoritete kontraktuese, për të cilat mund të arrihet përdorimi më efikas dhe me kosto ekonomike i fondeve publike me anë të zhvillimit të prokurimit qendror, të përbashkët ose të konsoliduar.
- 1.11. **Parashtrues i ankesës** - pala e interesuar që parashtrohet ose ka parashtuar ankesë në pajtim me dispozitat e nenit 111 të këtij ligji.
- 1.12. **Informacionet sekrete afariste** - informacioni i përcaktuar në nenin 11.2 të këtij ligji.

- 1.13. **Autoriteti kontraktues** – autoriteti publik, operatori i shërbimeve publike, ndërmarrja publike dhe/ose personi, komisioni, ose kompania private e cila operon në bazë të të drejtave të veçanta apo ekskluzive, ose ndërmarrja që ushtron aktivitete të prokurimit në emër të/ose për llogari të autoritetit publik ose operatorit të shërbimeve publike ose një ndërmarrje publike.
- 1.14. **Aktiviteti i menaxhimit të kontratave** - aktivitetet e kërkuara për të siguruar që dispozitat e kontratës në lidhje me dorëzimin me kohë dhe korrekt dhe të drejtat tjera të autoritetit kontraktues të ushtrohen në mënyrë efektive.
- 1.15. **Data e publikimit** do të thotë (i) në lidhje me njoftimet paraprake ose njoftimet e kontratës, datën në të cilën njoftimi i tillë për herë të parë publikohet sipas nenit 42 (2), dhe (ii) në lidhje me njoftimet për dhënien e kontratës, datën në të cilën ky i fundit u është dërguar operatorëve ekonomik sipas nenit 42 (3).
- 1.16. **Konkurs projektimi** - një procedurë prokurimi që ka për qëllim t'i mundësoj autoritetit kontraktues të fitoj një plan ose një projekt të zgjedhur nga një juri, pasi që është vënë në konkurrim me ose pa shpërblim, veçanërisht në sferat e planifikimit hapësinor, planifikimit urbanistik, arkitekturës, ingjineriut, përpunimit të të dhënave, dhe projektet e veprave të artit.
- 1.17. **Ndikimi mbizotërues** - nënkupton por nuk është i kufizuar një situatë kur autoriteti kontraktues ose një ndërmarrje, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mban shumicën e kapitalit të një ndërmarrje, kontrollon shumicën e votave nga aksionet e emetuara të ndërmarrjes, ose mund të emëroj më shumë se gjysmën e anëtarëve të organit administrativ, menaxhues ose mbikëqyrës të ndërmarrjes së tillë.
- 1.18. **Sistemi dinamik i blerjes** - një proces krejtësisht elektronik për të kryer blerjet e zakonshme, karakteristikat e të cilave, që zakonisht gjinden në treg, plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktues, e cila është e kufizuar në kohëzgjatje dhe është e hapur gjatë tërë kohës valide për të gjithë operatorët ekonomik të cilët përmbushin kriteret e përzgjedhjes dhe që kanë dorëzuar një tender indikativ i cili është në harmoni me specifikimet.
- 1.19. **Operator ekonomik** - term i përgjithshëm që përfshinë furnizuesin, ofruesin e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve. **Për qëllim të këtij ligji, edhe organizatat e shoqërisë civile konsiderohen operator ekonomik.**
- 1.20. **Blerja elektronike** - një proces që përsëritet dhe që përfshin një pajisje elektronike për prezentimin e çmimeve të reja, të ndryshimeve dhe/ose vlerave të reja në lidhje me elemente të caktuara të tenderëve, të cilat ndodhin pas një vlerësimi të plotë të tenderëve, duke ju mundësuar klasifikimin në mënyrën automatike të vlerësimit.
- 1.21. **Mjetet elektronike** – përdorimi i pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë kompresimin shifror) dhe ruajtjen e të dhënave të transmetuara, të bartura ose të pranuara me telegraf, me radio, me mjete pamore, ose me mjete tjera elektromagnetike.
- 1.22. **Standard Evropian** - standardi i miratuar nga (i) Komiteti Evropian për Standardizime (European Committee for Standardization, CEN) ose nga Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik (European Committee for Electrotechnical Standardization CENELEC) si “Standard Evropian” (European Standard, EN) ose “Dokumenti Harmonizimi” (Harmonization Document, HD), në përputhje me rregullat e përbashkëta të këtyre organizatave, ose (ii) nga Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (European Telecommunication Standards Institute, ETSI) në pajtim me rregullat e tyre si Standarde Evropiane të Telekomunikacionit (European Telecommunications Standard (ETS).

- 1.23. **Miratimi Teknik Evropian** - vlerësimi i favorshëm teknik të dhënë nga organi miratues i një shteti anëtar i UE-së mbi përshtatshmërinë e përdorimit të prodhimit për qëllime të veçanta, mbështetur në përmbushjen e kërkesave themelore për punët ndërtimore, me anë të karakteristikave qenësore të prodhimit dhe kushtet e përcaktuara të kërkesës dhe përdorimit.
- 1.24. **Rregullat Financiare** - Rregullat e Menaxhimit dhe Kontrollit Financiar të cilat shpallen nga Ministri përkatës për Financa sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- 1.25. **Kontratë e pronës së paluajtshme** - një kontratë me shpërblim në të holla e lidhur me shkrim ndërmjet një autoriteti kontraktues dhe një personi, ndërmarrje, ose autoriteti kontraktues që lidhet kryesisht ose ekskluzivisht me blerjen e pronës së paluajtshme nga autoriteti kontraktues apo një interesi në pronën e paluajtshme.
- 1.26. **Palë e interesuar** - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.
- 1.27. **IKAP** - Instituti i Kosovës për Administratë Publike.
- 1.28. **Kontratë me vlerë të madhe** - kontrata publike që trajtohet në nenin 19 (1) të këtij ligji.
- 1.29. **Konkurs projektimi me vlerë të madhe** - konkursin për projektim që trajtohet në nenin 20 (1) të këtij ligji.
- 1.30. **Kontratë me vlerë të vogël** - kontrata publike që trajtohet në nenin 19.3 të këtij ligji.
- 1.31. **Konkurs projektimi me vlerë të vogël** - konkursi i projektimit që trajtohet në nenin 20 (3) të këtij ligji.
- 1.32. **Kontratë me vlerë mesatare** - kontrata publike që trajtohet në nenin 19 (2) të këtij ligji.
- 1.33. **Konkurs projektimi me vlerë mesatare** - konkursi i projektimit që trajtohet në nenin 20 (2) të këtij ligji.
- 1.34. **Kontratë me vlerë minimale** - një kontratë publike që trajtohet në nenin 19 (4) të këtij ligji.
- 1.35. **Procedura e negociuar** - procedura e prokurimit që i lejon autoritetit kontraktues të ftojë dhe të këshillohet me operatorët ekonomik të zgjedhur nga ai për t'i negociuar kushtet e kontratës me njërin ose më shumë prej tyre.
- 1.36. **Tenderët e pa-përgjegjshëm** – tenderi i cili nuk janë në përputhje me a) dosjen e tenderit, duke përfshirë kërkesat teknike dhe kontraktuale, b) kërkesat e legjislacionit relevant të Kosovës ose të cilët c) përndryshe nuk përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues siç janë specifikuar në dosjen e tenderit.
- 1.37. **Procedurë e hapur** - procedurat e prokurimit që i lejojnë çdo operatori të interesuar ekonomik të paraqet tender.
- 1.38. **Person** - personi fizik.
- 1.39. **KRPP** - Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik të themeluar sipas Pjesës VI të këtij ligji.

- 1.40. **OSHP** - Organin Shqyrtues të Prokurimit të themeluar sipas Pjesës VIII të këtij ligji.
- 1.41. **Ky ligj** - ky ligj dhe aktet normative nën-ligjore dhe instrumentet e nxjerra në bazë të këtij ligji, duke përfshirë edhe rregullat e prokurimit publik dhe kodin etik që janë lëshuar sipas këtij ligji.
- 1.42. **Aktivitet i prokurimit** - çdo aktivitet që ndërlidhet me fillimin ose ekzekutimin e një procedure ose një aktiviteti tjetër që shpie ose që ka për qëllim të shpie drejt dhënies së një kontrate publike.
- 1.43. **Zyrtari i Prokurimit** - personi i caktuar autoritetit kontraktues sipas paragrafit 1 të nenit 23.
- 1.44. **Autoritet publik** - ka secilin nga kuptimet vijuese: (i) autoritetin ekzekutiv qendror, rajonal, komunal ose lokal, organin publik, ministrinë, departamentin, agjencinë, ose autoritetin tjetër që ekzekuton, konform me çdo akt normativ ose nën-normativ, pushtetin ekzekutiv, legjislativ, rregullativ, administrativ-publik ose gjyqësor; (ii) organin e themeluar në bazë të së drejtës publike; dhe (iii) një asociacion i një ose më shumë autoriteteve dhe/ose organeve të tilla.
- 1.45. **Kontratë publike** - term i përgjithshëm që përfshin ndonjërin dhe të gjitha llojet e veçanta të kontratave vijuese të lidhura nga një autoritet kontraktues: (i) një kontratë shërbimi, (ii) një kontratë e furnizimi, (iii) një kontratë pune duke përfshirë kontratën koncesionere të punës dhe/ose (iv) kontratën publike kornizë.
- 1.46. **Kontratë publike kornizë** - një marrëveshje me shkrim ndërmjet një ose më shumë autoriteteve kontraktuese dhe një ose më shumë operatorëve ekonomik, qëllimi i të cilës është të themelojë kushtet e qeverisjes së kontratave që duhet të jepen gjatë një periudhe të caktuar, sidomos në lidhje me çmimin dhe, ku është e përshtatshme, sasinë e parapare.
- 1.47. **Regjistri i Prokurimit Publik** - regjistri i themeluar nga KRPP-ja sipas nenit 87 të këtij ligji.
- 1.48. **Rregullat e prokurimit publik** - udhëzimet, rregullat, dokumentet, kodin etik dhe formularët standard që nxirren dhe shpallen nga KRPP sipas këtij ligji.
- 1.49. **Aktivitet i shërbimeve publike** - do të thotë se ky ligj do të zbatohet për aktivitetet pasuese që përfshin (i) ofrimin ose mbajtjen e rrjetit fiks fizik me qëllim të ofrimit të shërbimeve për publikun në lidhje me, mes tjerash, prodhimin, transportin, ose përpunimin ose shpërndarjen e ujit, rrymës, gazit ose ngrohjes, (ii) furnizimin me ujë, rrymë, gaz ose ngrohje për rrjetin e tillë, (iii) shfrytëzimin e zonave gjeografike me qëllim të hulumtimit ose nxjerrjes së naftës, gazit, thëngjillit ose karburanteve tjera të ngurta (iv) ofrimin e aeroportit ose pajisjeve të tjera terminale (v) ofrimin ose mbajtjen e një rrjete publike të telekomunikacionit ose ofrimin e një ose më shumë shërbimeve të telekomunikacionit ose postare, apo (vi) mbajtjen e një rrjete që i ofron publikut shërbime të transportimit duke përfshirë përdorimin e hekurudhës, autobusëve, tramvajeve, trolejbusëve, sistemeve kablloviqe ose automatike; një rrjetë e tillë do të ekzistojë kur shërbimet e tilla transportuese ofrohen në përputhje me kushtet operative të përcaktuara nga një autoritet kompetent publik, siç janë kushtet mbi territorin i cili do mbulohet nga shërbimi, kapaciteti i cili do të vihet në dispozicion ose frekuentimi i shërbimit.
- 1.50. **Operator i shërbimeve publike**- nënkupton: (i) autoritetin publik ose ndërmarrjen publike të angazhuar në një aktivitet të shërbimeve publike, dhe (ii) një person, ndërmarrje, organ ose organizatë që nuk është as autoritet publik e as

ndërmarrje publike dhe që është e angazhuar, në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive që i janë dhënë nga një autoritet kompetent publik, në një aktivitet të shërbimeve publike.

- 1.51. **Ndërmarrje publike** - çdo ndërmarrje mbi të cilën një ose më shumë autoritete publike mund të ekzekutojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndikim mbizotërues në bazë të pronësisë në ndërmarrjen e tillë, pjesëmarrjes financiare në ndërmarrjen e tillë dhe/ose dispozitave që rregullojnë ndërmarrjen e tillë.
- 1.52. **Ndërmarrje e ndërlidhur** - çdo ndërmarrje (i) mbi të cilën koncesioneri i punëve mund të ushtrojë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndikim mbizotërues, (ii) që mund të ekzekutoj ndikim mbizotërues mbi koncesionerin përkatës të punës, ose (iii) që, bashkë me koncesionerët përkatës të punës, i nënshtrohet ndikimit mbizotërues të ndërmarrjes tjetër në bazë të pronësisë, pjesëmarrjes financiare, ose dispozitave që e rregullojnë atë.
- 1.53. **Procedurat e kufizuara** - procedura e prokurimit në të cilat secili operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë dhe ku vetëm ata operatorë ekonomik të ftuar nga autoriteti kontraktues mund të dorëzojnë një tender.
- 1.54. **Paneli shqyrtues** - paneli i shqyrtimit që themelohet nga Kryetari i OSHP në pajtim me Pjesën IX të këtij ligji.
- 1.55. **Kontratë për koncesion shërbimi** - kontrata e llojit të njëjtë sikur që është kontrata e shërbimit përveç se kompenzimi për shërbimet e ofruara realizohet nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet, ose në këtë të drejtë bashkë me pagesën.
- 1.56. **Kontratë shërbimi** - një kontratë duke përfshirë kontratat e punës apo furnizimit me shpërblim me para, të lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë ofruesve të shërbimeve.
- 1.57. **Ofrues i shërbimeve** - çdo person, ndërmarrje ose organ publik, ose i personave, ndërmarrjeve dhe/ose organeve të tilla që kryejnë dhe/ose ofrojnë të kryejnë shërbime.
- 1.58. **Të drejta të veçanta ose ekskluzive** - të drejtat që dalin prej lejes ose autorizimit të dhënë nga organi kompetent publik sipas dispozitave ligjore, rregullative ose administrative që (i) ka efekt kufizues ndaj një ose më shumë entiteteve në të drejtën ose aftësinë për t'u angazhuar në aktivitete të caktuara, dhe (ii) qenësisht ndikon në të drejtën ose aftësinë e personave të tjerë, ndërmarrjeve, organeve ose organizatave për të kryer një aktivitet të tillë në të njëjtin territor dhe nën kushte esencialisht të njëjta.
- 1.59. **Furnizues** - çdo person, ndërmarrje ose organ publik, ose grup i personave të tillë, ndërmarrjeve, dhe/ose organeve që furnizojnë ose ofrojnë të furnizojnë produkte.
- 1.60. **Kontratë furnizimi** - kontrata me shpërblim në para të lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë furnizuesve që ka të bëjë vetëm ose kryesisht me blerjen, qiradhënien, qiradhënien ose blerjen me këste, me ose pa mundësi blerje, të një ose më shumë produkteve; "produktet" interpretohen gjerësisht si një ose më shumë sende të prekshme të lëvizshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, mallrat, artikulat, prodhimet e përpunuara, lëndët e para, dhe pajisjet.
- 1.61. **Standard** - specifikimi teknik i miratuar nga një organ i pranuar i standardizimit dhe i vënë në dispozicion për publikun për përdorim të përsëritur ose të vazhdueshëm, përpunues me të cilin përgjithësisht nuk është e detyrueshme.

- 1.62. **Referencë teknike** - çdo produkt i prodhuar nga organet e standardizimit Evropian, përveç standardeve zyrtare, sipas procedurave të miratuara për zhvillimin e nevojave të tregut.
- 1.63. **Specifikimi teknik** - do të thotë në raste të kontratave të punëve publike, tërësia e përshkrimeve teknike të përmbajtura veçanërisht në dokumentacionin e tenderit, që përkufizojnë karakteristikat e kërkuara të një materialit, produktit ose furnizimit që i mundëson llojit të punës, materialit, produktit, furnizimit ose shërbimit që të përshkruhet në mënyrë që të plotësoj nevojat e paracaktuara nga autoriteti kontraktues. Këto karakteristika do të përfshijë nivelet e performancës mjedisore, projektimin për të gjitha kërkesat (duke përfshirë qasjen për persona me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin të konformitetit, treguesin e zbatueshmërisë, aspektin e sigurisë apo dimensionet, duke përfshirë procedurat në lidhje me sigurinë e kualitetit, terminologjisë, simboleve, metodave testit dhe testimin, ambalazhimin, shënimit dhe etiketimit dhe proceset dhe metodat e prodhimit. Ato do përfshijnë gjithashtu rregullat në lidhje me projektim dhe shpenzime, testin, inspektimin dhe kushtet e pranimit për punët dhe metodat ose teknikat e ndërtimit dhe të gjitha kushtet tjera teknike të cilat autoriteti kontraktues është në gjendje t'i përshkruaj sipas rregulloreve të veçanta ose të përgjithshme, lidhur me punët e kryera dhe materialet ose pjesët që ato i përfshijnë;
- 1.64. **Specifikim teknik** - në raste të kontratave të shërbimeve ose furnizimeve publike, nënkupton një specifikim në një dokument që përkufizon karakteristikat e kërkuara të një produkti apo shërbimi, të tillë si nivelet e cilësisë, nivelet e zbatueshmërisë mjedisore, projektimi i të gjitha kërkesave (përfshirë qasjen për persona me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, treguesin e zbatueshmërisë, përdorimi i produktit, aspektin e sigurisë apo dimensioneve, duke përfshirë kërkesat relevante të produktit në lidhje me emrin nën të cilin shitet, terminologjia, simbolet, testimet dhe metodat e testimin, ambalazhi, shënimi dhe etiketimi, udhëzimet e përdorimit, proceset e prodhimit dhe metodat e prodhimit dhe procedurat e vlerësimin të konformitetit;
- 1.65. **Tender** - një dokument që i dorëzohet autoritetit kontraktues nga një operator ekonomik, duke parashtruar kushtet e ofertës së operatorit ekonomik si përgjigje ndaj një njoftimi specifik të kontratës, njoftimit për tenderim ose ndonjë kërkesë tjetër që është nxjerrë ose përgatitur nga autoriteti kontraktues në fjalë. Termi "tender" përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një propozim ose kuotim të çmimeve.
- 1.66. **Tenderues** - operatori ekonomik që ka dorëzuar tenderin.
- 1.67. **Dosje tenderi** - ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 27 të këtij ligji.
- 1.68. **Ndërmarrje** - secili subjekt afarist (duke përfshirë edhe subjektet personale afariste), ortakëri, ndërmarrje të përbashkët, person juridik, shoqatë, projekt, filial, zyrë, ose organizatë ose themelatë tjetër.
- 1.69. **Punë** - rezultati i ndërtimit ose punët ndërtimore ose aktivitetet që, marrë në tërësi, janë të mjaftueshme të plotësojnë një funksion ekonomik ose teknik.
- 1.70. **Koncesioner i punëve** - nënkupton (i) personin, ndërmarrjen ose autoritetin kontraktues që ka marrë kontratë pune koncesioni nga autoriteti kontraktues, dhe/ose (ii) secili person, ndërmarrje ose autoritet kontraktues që kryen aktivitete prokurimi në emër të ose për llogari të personit të tillë, - ndërmarrjes ose autoritetit kontraktues.
- 1.71. **Kontratë pune me koncesion** - kontrata e punës, përmbushja e së cilës kompensohet tërësisht ose pjesërisht, me dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të objektit të kësaj kontrate.
- 1.72. **Kontratë pune** - kontrata me shpërblim në para, të lidhur ndërmjet autoritetit

kontraktues dhe një ose më shumë kontraktuesve të punëve i cili ka detyrë kryesore zbatimin, projektimin dhe përmbushjen, ose realizimin, me çfarëdo mënyre, të punës ose ndërtimit ose aktiviteteve ndërtimore komunale, që do të thotë aktiviteteve që janë drejtpërdrejt të përfshira në ndërtimin, restaurimin, riparimin ose shkatërrimin e godinave, pajisjeve, strukturave ndërtimore, strukturave tjera, ose të një pjesë të tyre.

1.73. **Kontraktues pune** - secili person, ndërmarrje ose autoritet kontraktues, ose grup të personave të këtillë, ndërmarrjeve, që ofrojnë të ekzekutojnë, projektojnë ose përmbarojnë, ose realizojnë, me çfarëdo mjeti, punën ose ndërtimin ose aktivitetet ndërtimore, do të thotë aktivitetet që janë drejtpërdrejt të përfshira në ndërtimin, restaurimin, riparimin ose shkatërrimin e godinave, pajisjeve, strukturave ndërtimore, strukturave tjera, ose secilës pjesë të tyre.

1.74. **Me shkrim** - çdo shprehje që përbëhet nga fjalët dhe/ose shifrat që mund të lexohen, riprodhohen dhe më pastaj të komunikohen. Kjo mund të përfshijë informacionin e transmetuar dhe të ruajtur me mjete elektronike.

1.75. **Konfliktet e interesit** - çdo situatë ku anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit.

2. Personi ose ndërmarrja që ka për qëllim t'i caktoj/jap kontratë personit tjetër ose ndërmarrjes, nëse 50% ose më shumë e vlerës së çmuar të kontratës së tillë është qoftë drejtpërdrejt e subvencionuar nga autoriteti kontraktues ose përndryshe e financuar me fonde publike, do të konsiderohet se është "autoritet kontraktues" në kuptim të këtij ligji lidhur me çdo aktivitet prokurimi me lejin/dhënien e kontratës së tillë. Personi ose ndërmarrja e tillë me këtë rast, do të zhvilloj aktivitetet e prokurimit rreptësisht në përputhje me kërkesat a zbatueshme procedurale dhe thelbësore të këtij ligji.
3. Përveç kur konteksti në mënyrë të qartë kërkon një kuptim tjetër, termet dhe përkufizimet në nenin 4 të këtij ligji do të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me interpretimin dhe zbatimin e termeve të ngjashme ose të njëjta të cilat janë përdorur në Direktivat e KE-së.
4. Në këtë ligj njëjësi përfshin shumësin dhe shumësi përfshin njëjësin, dhe kudo që përmendet "neni" ka të bëjë me nenet e këtij ligji, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe.
5. Përemri "a" dhe mbiemri "i tij" vlejnë në mënyrë të barabartë për secilën gjini dhe po ashtu i referohen një ndërmarrje aty ku kjo kërkohet nga konteksti.
6. Përveç nëse konteksti qartësisht kërkon një interpretim tjetër, të gjitha referencat në këtë ligj ndaj ligjeve, rregulloreve ose akteve të tjera nënligjore ose cilësdo dispozitë të caktuar të tyre duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Nëse ligji, rregullorja ose akti nënligjor është shfuqizuar dhe zëvendësuar me akte të reja që rregullojnë fushën e njëjtë, referencat në këtë ligj duhet të interpretohen për t'i përfshirë këto akte të reja dhe, sipas rasti, dispozitat gjegjëse në to.

Neni 5

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00

të ditës së skadimit.

2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

KREU II

PARIMET E PERGJITHËSHME

Neni 6

Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasi të artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.
6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii)

eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

KREU III KËRKESAT E PËRGJITHËSHME

Neni 8 Planifikimi i Prokurimit

1. Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzojë me shkrim te Zyrtares Kryesore Administrative të Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Planifikimi i tillë paraprak i prokurimit saktëson:

- 1.1. në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal;
 - 1.2. në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; dhe
 - 1.3. në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.
2. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon të prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal. Planifikimi i tillë përfundimtar duhet të përmbajë të dhënat që kërkojnë nga sipas nën-paragrafit 1.1., 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1. të këtij neni.
3. AQP-ja menjëherë shqyrton dhe mbledh informacionet e dhëna në planifikimet e tilla. AQP-ja identifikon produktet e përdorimit të përbashkët dhe të gjitha artikujt dhe produktet e tjera që mund të sigurohen në mënyrë më efektive përmes zbatimit të një procedure të konsoliduar ose të përbashkët të prokurimit.
4. Qeveria sipas propozimit të Ministrisë përkatëse për financa autorizon AQP-në për të udhëhequr prokurimet e përbashkëta.

Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

1. Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtësore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara

funkionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përlogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikim in e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues.

2. Nëse pas vlerësimit të nevojave, ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal.
3. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.
4. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.
5. Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1. deri 4. të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një "Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve". Deklarata e tillë e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve do të përmbajë informatat në vijim: (i) një deklaratë të nevojave me shkrim, e cila i përmbledh rezultatet e vlerësimit të nevojave që është bërë nga autoriteti kontraktues sipas paragrafit 1. të këtij neni, (ii) një deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve, që demonstroi se autoriteti kontraktues i ka përmbushur obligimet e tij sipas paragrafit 2. të këtij neni, (iii) nëse është e aplikueshme, atëherë duhet që gjithashtu të dorëzohet një deklaratë me shkrim që i parashtron bazat, që kërkohen nga paragrafi 3. të këtij neni, për /pritjet e autoritetit kontraktues në lidhje me përvetësimet e ardhshme: dhe (iv) nëse është e aplikueshme, një deklaratë me shkrim që përshkruan masat që autoriteti kontraktues i ka marrë për t'u përputhur me paragrafin 4. të këtij neni. ZKA do të sigurojë që origjinali i nënshkruar i secilës Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të ruhet në dokumentacionin e autoritetit kontraktues dhe që një kopje ti dërgohet ZKF-së. Nëse ZKA vendos që autoriteti kontraktues të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit, ZKA do ti dërgojë një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve Zyrtarit Autorizues dhe funksionarit më të lartë të autoritetit kontraktues (përveç rasteve kur ZKA është funksionari më i lartë i autoritetit kontraktues). KRPP do të përgatisë një formular standard të "Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" të cilin ZKA dhe ZKF e përdorin për përmbushjen e kërkesave të këtij neni.
6. Për autoritetet kontraktuese që janë autoritete publike ose ndërmarrje publike, nëse objektet e aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të

autoritetit kontraktues i cili është dorëzuar në AQP sipas paragrafit 2. të nenit 8 të këtij ligji, ZKA do të dërgojë në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. AQP -ja do të shqyrtojë çdo deklaratë të nevojave për të përcaktuar se nëse ka ndonjë metodë tjetër më efikase dhe më ekonomike për blerjen e mallrave të tilla ose produkteve të tjera, që i plotësojnë nevojat e autoritetit kontraktues. Në veçanti, nëse mallrat ose produktet përkatëse nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të prokurimit që i është dorëzuar AQP -së sipas paragrafit 2. të nenit 8 të këtij ligji, AQP -ja do të shqyrtojë objektet e tilla për të identifikuar artikujt e përbashkët të prokurimit si dhe mallrat e tjera dhe artikujt që mund të sigurohen në mënyrë më efikase, përmes procedurës së përbashkët ose procedurës së zakonshme të prokurimit.

Neni 10

Mjetet për promovimin e Transparencës

1. Autoriteti kontraktues mban një përmbledhje të rregulluar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që e kryen, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në dhënien e kontratës ose konkursit të projektimit. **Ruajtja e dokumenteve përkatëse bëhet sipas legjislacionit në fuqi për Arkivat shtetërore.**
2. Shënimet për secilin aktivitet të prokurimit duhet të përmbajnë se paku: (i) të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një aktivitet të prokurimit ose që janë zhvilluar apo pranuar gjatë, ose që janë mbledhur ose shfrytëzuar për të filluar ose përmbyllur një aktivitet të prokurimit, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në një kontratë ose në dhënien e konkursit të projektimit, dhe (ii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në dhënien e një kontrate ose konkursi të projektimit, atëherë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënien e tillë, dhe (iii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në ekzekutimin e një kontratë publike, atëherë një kopje të kontratës publike dhe të të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me kontratën dhe/ose ekzekutimin e saj. Dokumentacioni në lidhje me ekzekutimin e kontratës përfshinë në veçanti planin e menaxhimit të kontratës i kërkuar sipas nenit 81 të këtij ligji.
3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.
4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafi 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.
5. Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.
6. KRPP do të publikojë në mënyrë elektronike, këtë ligj dhe rregullat e prokurimit publik në webfaqen e saj zyrtare në internet.
7. KRPP do të vendosë në rregullat e prokurimit publik, një tarifë të arsyeshme që autoriteti kontraktues dhe KRPP-ja mund ta vendosin për të mbuluar shpenzimet e

fotokopjimit që kërkohen nga paragrafit 5. i këtij neni; sidoqoftë, tarifa e tillë të mos jetë më e madhe se sa konsiderohet e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që ndërlidhen më prodhimin e kopjeve të tilla.

8. Autoriteti kontraktues do t'i sigurojë një ekspert shqyrtues, KRPP-së, OSHP-së dhe/ose një paneli shqyrtues, qasje në kopjet e cilitdo aktivitet të prokurimit, duke përfshirë edhe informatat sekrete afariste dhe çfarëdo informata të tjera që kanë të bëjnë me prokurimin, menjëherë pas kërkesës së të mësipërmeve. Autoriteti kontraktues gjithashtu do t'i sigurojë qasje dhe kopje të shënimeve dhe informatave një gjykatë kompetente, nëse qasja ose kopjet e tilla kërkohen nga një urdhër i nxjerrë nga gjykata e tillë. Autoriteti kontraktues menjëherë do të sigurojë qasjen dhe kopjet e kërkuara në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa.
9. Në çdo rast kur KRPP, OSHP, AQP planifikon të nxjerrë një akt nënligjor për zbatimin e këtij ligji, janë të obliguara që draftin e aktit nënligjor t'a vënë në disponim për publikun dhe palët e interesuara, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë për të komentuar draftin.

Neni 11 **Informatat Sekrete Afariste**

1. Pa prejudikuar detyrimin për t'u siguruar palëve të interesuara dhe publikut qasje në shënimet e aktiviteteve të tij të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen.
2. Informatat që sipas paragrafit 3. të nenit 58 të këtij ligji duhet të shpallen dhe regjistrohen gjatë hapjes publike të tenderëve nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste.
3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:
 - 3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;
 - 3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikuljt e tillë si sekret; dhe
 - 3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.
5. Nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, dhe prandaj ky autoritet

kontraktues vendos që këtë dokument ta largoj nga materiali në të cilin palët e interesuara dhe anëtarët e publikut kanë të drejt qasjeje sipas paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin publiku ka qasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të përmbledhjes së tillë një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar të gjitha informacionet që gjendeshin në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesë të operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) se dokumenti i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe se është një përmbledhje e përgjithshme jo-sekrete e origjinalit.

6. Nëse, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, autoriteti kontraktues kërkon nga një operator ekonomik që të dorëzojë informatat që mbulohen nga neni 68 dhe/ose 69 të këtij ligji, autoriteti i tillë kontraktues në dosjen e tenderit duhet të përfshijë një deklaratë duke i njoftuar operatorët ekonomik se, nëse ata dëshirojnë që informatat në fjalë të trajtohen si informata sekrete afariste, ata duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim në përputhshmëri me paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 12

Valutat, Pagesat dhe Kushtet e Zakonshme të Kontratës

1. Të gjitha çmimet dhe vlerat e specifikuara në çfarëdo kontrate publike, dosje të tenderit, njoftim, ftesë për tender ose pjesëmarrje, duhet të deklarohen dhe të gjitha pagesat e tyre duhet të bëhen në Euro.
2. Kushtet dhe termet e kontratave publike duhet të jenë në përputhje me praktikën e zakonshme publike dhe afariste për llojin dhe lëndën e veçantë të kontratës përkatëse.

Neni 13

Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik

1. Autoriteti kontraktues do ti përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë minimale, të vogël dhe të mesme në gjuhën Shqipe dhe Serbe. Autoriteti kontraktues mundet që gjithashtu t'i përgatisë dokumentet në fjalë edhe në gjuhën Angleze.
2. Autoriteti kontraktues do ti përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë të madhe në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.
3. Kurdo që një dokument kërkohet në më shumë se një gjuhë duhet të deklarohet në faqen e parë të të gjitha dokumenteve, versioni përkatës gjuhësor që mbizotëron.
4. Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

Neni 14

Pranuesit e të Drejtave të Veçanta ose Ekskluzive që Angazhohen në Aktivitete të Shërbimeve Publike

Nëse një person ose ndërmarrje, përveç një autoriteti kontraktues – pavarësisht nga statusi i tij ligjor – pranon ose ka pranuar të drejta të veçanta ose ekskluzive për t'u angazhuar në çfarëdo aktiviteti të shërbimeve publike, personi, ose ndërmarrja e tillë duhet t'i respektojë rregullat dhe procedurat e këtij ligji gjatë dhënies së kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, palëve të treta.

KREU IV
RREGULAT PËR VLERËSIMIN DHE KLASIFIKIMIN E KONTRATAVE PUBLIKE DHE
KONKURSEVE TË PROJEKTIMIT

Neni 15
Klasifikimi i Kontratave të Përziera

1. Nëse një kontratë për furnizim përmban dispozita që kërkojnë nga furnizuesi që të dërgojë, vendosin edhe/ose instalojnë artikullin/artikujt përkatës, ekzistenca e këtyre dispozitave, nuk do të ndikojë në klasifikimin e kontratës në fjalë si kontratë për furnizim.
2. Kontrata që përfshin njëkohësisht furnizimet dhe shërbimet, konsiderohet si kontratë e shërbimeve nëse vlera e parashikuar e shërbimeve e kalon vlerën e parashikuar të furnizimeve. Nëse në kontratë përfshihen dispozitat mbi dërgimin, vendosjen dhe/ose instalimin e furnizimeve përkatëse, vlera e parashikuar e aktiviteteve të tilla përfshihet në vlerësimin e komponentëve të furnizimeve të kontratës së tillë.
3. Kontrata për lëndë kryesore ka sigurimin e shërbimeve profesionale të ndërtimtarisë (d.m.th. shërbimet arkitektonike dhe/ose të inxhinieringut, të lokacionit gjeoteknik ose gjeodezik, shërbimet hulumtuese, shërbimet për vlerësimin e strukturës ose projektimin e strukturës, mbikëqyrjen e ndërtimtarisë ose shërbimet për menaxhimin e ndërtimit) konsiderohet si kontratë e shërbimeve edhe nëse kontrata e tillë po ashtu mbulon, përveç lëndës së tillë kryesore edhe ushtrimin e një ose më shumë aktiviteteve që përcaktohen në përkufizimin e “kontratës së punëve”.
4. Kontrata që për lëndë kryesore ka ushtrimin e aktiviteteve të përmendura në përkufizimin e “kontratës së punëve”, por që po ashtu përfshin sigurimin e shërbimeve të ndërtimtarisë, konsiderohet “kontratë e punëve” nëse shërbimet e tilla janë të nevojshme për përmbushjen e kësaj kontrate.
5. Kontrata që për lëndë ka njëkohësisht edhe furnizimin e produkteve edhe ushtrimin e aktiviteteve të përcaktuara në përkufizimin e “kontratës së punëve” klasifikohet si “kontratë e punëve”, përveç kur aktivitetet e tilla përfshijnë vetëm aktivitetet e vendosjes dhe/ose të instalimit.
6. Të gjitha kontratat, pavarësisht nga struktura, që i mundësojnë operatorit ekonomik marrjen ose mbajtjen e një përqindje ose lloj tjetër kompensimi, për kryerjen e shërbimeve të shitjes ose mbledhjes në emër të autoritetit kontraktues, duhet të trajtohet si “kontratë për shërbime” që rregullohet nga ky ligj, me kusht që kontratat e tilla për shërbime të mos drejtohen me ligj tjetër, veçanërisht të dekretuar për kontratat e tilla.

Neni 16
Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim

1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera.
2. Në rastin e kontratave për qiradhënie, qiramarrje ose blerje me këste të produkteve, vlera që do të merret si bazë për përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës është:
 - 2.1. në rastin e kontratës publike me afat të caktuar, nëse ky afat është më pak se ose i

barabartë me dymbëdhjetë (12) muaj, vlera totale e parashikuar për afatin e kontratës ose, nëse afati i kontratës është më i gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj, vlera totale duke përfshirë mbetjen e vlerës së parashikuar.

2.2. në rastin e kontratës me afat të pacaktuar ose kur ekziston dyshimi për kohëzgjatjen e kontratës, vlera mujore e shumëzuar me 48.

3. Kur kontrata e propozuar përmban një opsion tjetër, baza për llogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës është shuma e gjithëmbarshme e lejuar maksimale e blerjeve, qiramarrjes, qiradhënies ose blerjes me këste, duke përfshirë çfarëdo shumash që tani duhet të paguhet si pasojë e ekzekutimit të klauzolës së opsioneve.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të zgjedh ose përdor metodën e vlerësimit me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në Nenin 19 të këtij ligji; dhe asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji.

Neni 17

Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime

1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensueshme që do të paguhet nga autoriteti kontraktues sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifën e tjera.
2. Kur kontrata e propozuar për shërbime përmban një opsion, baza për llogaritjen e vlerës së kontratës merret shuma e gjithëmbarshme e lejuar maksimale që duhet të paguhet sipas kontratës së propozuar për shërbime, duke përfshirë çfarëdo shumash që tani duhet të paguhet si pasojë e ekzekutimit të klauzolës së opsioneve.
3. Me qëllim të llogaritjes së vlerës mesatare të kontratës, në të cilën përfshihen shërbimet e sigurimit, shërbimet bankare dhe llojet tjera të shërbimeve financiare, ose shërbimet e projektimit, duhet marrë në konsideratë, kur është e mundshme:
 - 3.1. në rastin e shërbimeve të sigurimit, shpërblimin (preminë) e pagueshëm;
 - 3.2. në rastin e shërbimeve bankare dhe shërbimeve të tjera financiare, tarifën, provizionet, kamatat si dhe llojet e tjera të kompensimit; ose
 - 3.3. në rastin e shërbimeve të projektimit, tarifën dhe provizionet.
4. Kur shërbimet ndahen në disa pjesë më të vogla, dhe secila është lëndë e një kontrate të veçantë, vlera e gjithëmbarshme e parashikuar e të gjitha sasive të tilla duhet të shfrytëzohet për klasifikimin e secilës kontratë sipas nenit 19 të këtij ligji.
5. Në rastin e një kontrate të propozuar të shërbimeve që nuk e cek çmimin e përgjithshëm, vlera që duhet marrë si bazë për llogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës së tillë është si vijon:
 - 5.1 në rastin kontratës me afat të caktuar deri në dyzet e tetë (48) muaj ose më pak, vlera e përgjithshme e parashikuar e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj;
 - 5.2 në rastin e kontratës me afat të pacaktuar ose me afat më të gjatë se dyzet e tetë (48). muaj, vlera e parashikuar mujore e shumëzuar me dyzet e tetë (48).

6. Autoriteti kontraktues nuk do të zgjedhë ose përdorë metoda të vlerësimit, që kanë për qëllim zvogëlimin e vlerës së kontratës për shërbime nën kufirin e përcaktuar në nenit 19 të këtij ligji; as pala kontraktuese nuk do të bëjë ndarjen e kërkesave të prokurimit për shumën e shërbimeve të ofruara me qëllim të zvogëlimin të vlerës së kontratës për shërbime nën kufirin e përcaktuar në nenit 19 të këtij ligji.

Neni 18

Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës së Punëve

1. Vlera e parashikuar e një kontrate të propozuar të punëve është e barabartë me çmimin e parashikuar që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha punët, shërbimet, produktet si dhe lëndët e tjera që mbulohen nga ajo; duke përfshirë – në rast të një kontrate të punëve – lëndët e nevojshme për ekzekutimin e kontratës në fjalë që duhet ti vihen në dispozicion kontraktuesit të punëve nga autoriteti kontraktues. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar të punëve, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për punët, shërbimet, produktet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifatat e tjera.
2. Kur një punë nën-ndahet në disa pjesë, dhe secila prej tyre është lëndë e kontratës së veçantë, vlera e përgjithshme e parashikuar e të gjitha sasive të tilla, duhet të shfrytëzohet për klasifikimin e secilës kontratë, në kuadër të nenit 19 të këtij ligji.
3. Kur kontrata e propozuar e punëve përmban një klauzolë të mundësisë, baza për përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës merret shuma maksimale e mundshme e përgjithshme që duhet të paguhet në bazë të kontratës së propozuar të punëve, përfshirë çdo shumë që do të duhej të paguhej si rezultat i ushtrimit të klauzolës së mundësisë.
4. Kur parashikohet që një kontratë e punëve mund të zgjatet ose rifillohet ose të pasohet nga një kontratë pasardhëse për punë të reja në kuadër të nenit 35.2.4 të këtij ligji, si bazë për përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës do të merret shuma maksimale e mundshme e përgjithshme e punëve të mbuluara me kontratë si dhe vlera maksimale e të gjitha punëve të tilla të parashikuara shtesë.
5. Autoriteti kontraktues nuk do të bëjë ndarjen punëve ose kontratës së punëve me qëllim të zvogëlimin të vlerës së punës ose të kontratës së punëve nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji.

Neni 19

Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar

1. “Kontratë me vlerë të madhe” konsiderohet me sa vijon:
 - 1.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritët që të jetë e barabartë ose më e madhe se njëqind njëzet e pesë mijë (125.000) Euro; ose
 - 1.2. kontrata për punë, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se pesëqind mijë (500.000) Euro.
2. “Kontratë me vlerë të mesme” konsiderohet me sa vijon:
 - 2.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se dhjetë mijë (10.000) Euro, por më e vogël se njëqind e njëzet e pesë mijë (125.000) Euro; ose

- 2.2. kontrata për punë, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se dhjetë mijë (10.000) Euro, por më e vogël se pesëqind mijë (500.000) Euro.
3. Kontratat në vijim konsiderohen “kontrata me vlerë të vogël”: Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se një mijë (1.000) Euro, por më e vogël se dhjetë mijë (10.000) Euro.
4. Kontratat në vijim konsiderohen “kontrata me vlerë minimale”: Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është më e vogël se, ose me arsye pritët që të jetë më e vogël se një mijë (1.000) Euro.

Neni 20

Klasifikimi i Konkursit të Projektimit sipas Vlerës

1. “Konkurs i projektimit me vlerë të madhe” konsiderohet me sa vijon:
- 1.1. konkursi i projektimit që organizohet si pjesë e procedurës që shpie drejt ose që përfshinë shpalljen e kontratës fituese për shërbime, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se njëqind e njëzet e pesë mijë (125.000) Euro; ose
- 1.2. konkursi i projektimit në të cilin shuma e përgjithshme e çmimeve të konkursit dhe e pagesave për pjesëmarrësit është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se njëqind mijë (100.000) Euro.
2. “Konkurs i projektimit me vlerë mesatare” konsiderohet me sa vijon:
- 2.1. konkursi i projektimit që organizohet si pjesë e procedurës që shpie drejt ose përfshinë dhënien e kontratës së shërbimeve vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë ose më e madhe se dhjetë mijë (10.000) Euro, por më e vogël se njëqind e njëzet e pesë mijë (125.000) Euro; ose
- 2.2. konkursi i projektimit në kuadër të së cilit shuma e përgjithshme e çmimeve dhe pagesave për pjesëmarrësit është e barabartë ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se dhjetë mijë (10.000) Euro por më pak se njëqind mijë (100.000) Euro.
3. Konkursi i projektimit që nuk përfshihet në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni konsiderohet “konkurs i projektimit me vlerë të vogël”.

Neni 21

Kufizimet për zbatimin e Neneve 16-20

1. Autoriteti kontraktues mund t'i zbatojë nenet 16-20 vetëm për qëllim të klasifikimit të një kontrate publike ose një konkursi projektimi si kontratë me vlerë të madhe, të mesme, të ulët ose minimale. Dispozitat e neneve 16-20 nuk mund të zbatohen për qëllime të tjera.

Neni 21/A

Ekonomizimi i aktivitetit të prokurimit

1. Për qëllime të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë përkatëse kryejnë procedurat e prokurimit të Agjencive që i përgjigjen atyre, të cilat kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës.

2. Për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen Agjencia Qendrore e Prokurimit.

KREU V

AUTORIZIMI PËR INICIMIN E NJË AKTIVITETI TË PROKURIMIT DHE NËNSHKRIMIN E KONTRATËS PUBLIKE

Neni 22

Inicimi i aktivitetit të prokurimit

1. Për çdo aktivitet të prokurimit të autoritetit kontraktues, ZKA duhet të caktojë një person që të shërbejë si Zyrtar Autorizues për atë aktivitet të prokurimit. Gjatë caktimit të Zyrtarit Autorizues, ZKA duhet të përmbush të gjitha kushtet e parapara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe në Rregullat Financiare të shpallura nga Thesari. Zyrtari Autorizues nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të iniciojë aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit Autorizues Deklaratën përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF i autoritetit kontraktues sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji.
2. Pasi ZKA t'i ketë dorëzuar Zyrtarit Autorizues Deklaratën e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të përgatitur në mënyrë të rregullt dhe të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF, Zyrtari Autorizues e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të iniciojë aktivitetin e prokurimit. Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruar. Zyrtari i Prokurimit do të mban një kopje të këtyre dokumenteve në dokumentacionin për prokurimin përkatës. Zyrtari Autorizues gjithashtu i dërgon një kopje të udhëzimit të tij me shkrim ZKF-së dhe ZKA-së të autoritetit kontraktues si dhe funksionarit më të lartë të autoritetit kontraktues, përveç kur ZKA është funksionari më i lartë.

Neni 23

Zyrtarët e Prokurimit

1. ZKA i autoritetit kontraktues përcakton një person të shërbejë si **Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit** për autoritetin kontraktues. Nëse punëtorët tjerë të autoritetit kontraktues janë nëpunës civil, Zyrtari i Prokurimit gjithashtu është nëpunës civil.
2. Një person mund të shërbejë si Zyrtarë Përgjegjës i Prokurimit nëse posedon diplomë universitare, dhe një certifikatë valide, bazike apo të avancuar të prokurimit të lëshuar në pajtim me nenin 25 të këtij ligji.
3. Asnjë person nuk mund të shërbejë si Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit apo si anëtar i stafit të njësisë së prokurimit nëse ai nuk kualifikohet që të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit në bazë të dispozitave të paragrafit 3. të nenit 65 të këtij ligji. Dy apo më shumë autoritete kontraktuese të cilat kanë prokurime të pakta mund të arrijnë marrëveshje që të përcaktojnë personin e njëjtë si Zyrtar të Prokurimit.
4. Asnjë person nuk mund të shërbejë si Zyrtar i Prokurimit ose si punonjës i njësisë së Prokurimit përveç dhe përderisa ai të ketë dorëzuar një deklaratë me shkrim nën betim se ai: (i) është i kualifikuar për të shërbyes si **Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit ose si punonjës i njësisë së prokurimit** sipas këtij neni, (ii) do të ushtrojë aktivitetet e prokurimit të autoritetit kontraktues në mënyrë të ndershme dhe të ndërgjegjshme dhe në pajtim të plotë me këtë ligj, dhe (iii) menjëherë do të ushtrojë në mënyrë profesionale të gjitha detyrat tjera të përcaktuara në këtë ligj. Deklarata nën betim dorëzohet në KRPP, e cila menjëherë e regjistron deklaratën dhe i siguron personit në fjalë një vërtetim për

regjistrimin e deklaratës. KRPP do të mbajë të gjithë deklaratat e dorëzuara sipas këtij paragrafi në dokumentacionin publik të KRPP.

5. Çdo autoritet kontraktues do të sigurojë që personi i cili është caktuar si Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit të përmbushë kërkesat e paragrafit 2. të këtij neni, nuk konsiderohet i papërshtatshëm dhe ka ekzekuton deklaratën e kërkuar nga paragrafi 4. i këtij neni. Çdo autoritet kontraktues do të sigurojë që të gjithë punonjësit tjerë të njësisë të Prokurimit nuk konsiderohen të papërshtatshëm dhe gjithashtu kanë ekzekutuar deklaratën e kërkuar në paragrafin 4. të këtij neni.
6. Nëse një Zyrtar i Prokurimit humb të drejtën për të mbajtur këtë pozitë, ZKA menjëherë do ta largojë personin në fjalë nga kjo pozitë. Nëse Zyrtari i Prokurimit është nëpunës civil, ZKA do të sigurojë që largimi i tij të bëhet në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil.

Neni 24

Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

1. Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë përgjegjësi të autoritetit përkatës kontraktues pavarësisht nga shpërndarja e detyrave brenda autoritetit kontraktues sipas Nenit 22 të këtij ligji. Kjo nuk zbatohet në rastet kur Ministri i financave e ka caktuar AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të caktuar të prokurimit sipas këtij ligji. Kurdo që AQP kryen aktivitetet e prokurimit në emër të autoritetit kontraktues, përgjegjësitë për këto aktivitete i merr përsipër AQP-ja.
2. Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.
3. Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është përgjegjës që menjëherë t'i raportojë KRPP-së mbi aktivitetet e prokurimit të autoritetit përkatës kontraktues që ekzekutohen në një mënyrë që nuk është në pajtim me këtë ligj.
4. Në rast të ndonjë arsyeje që një **Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit ose punonjës i njësisë së prokurimit** nuk mund të mbajë më atë post për shkaqet e parapara në paragrafin 3. të nenit 23 të këtij ligji, autoriteti kontraktues menjëherë do të njoftoi KRPP-në. KRPP do të vendosë nëse ekziston ndonjë arsye e tillë, dhe udhëzon në bazë të rastit. Në rast të largimit të zyrtarit të prokurimit aplikohen dispozitat e Ligjit të Shërbimit Civil.

Neni 25

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit

1. KRPP-ja është përgjegjëse për zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim. KRPP-ja duhet të identifikojë personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in duhet të aranzhojë zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë ditë (10) për trajnime të avancuara. KRPP-ja siguron që kurse të tilla të përgatiten dhe mbahen nga një person i trajnuar ose institucion i trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikat më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.
2. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të jenë përgjegjëse për organizimin e provimeve.
3. Çdo person i interesuar mund të marrë pjesë në trajnimin profesional të prokurimit. Autoriteti Kontraktues duhet që në lidhje me Zyrtarët e Prokurimit të punësuar të trajtojë kohën e shpenzuar nga Zyrtari i Prokurimit në trajnim si orar të zakonshëm pune dhe ta kompensojë atë njëllë sikurse të kishte shpenzuar atë kohë në punë. Autoriteti kontraktues po ashtu mund t'i ofrojë personit në fjalë, në pajtim me aktet e zbatueshme ligjore dhe nën-ligjore edhe kompensim për shpenzimet që domosdoshmërisht janë bërë nga personi për pjesëmarrjen në trajnim.

4. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in të lëshojnë “certifikatën themelore profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset themelore dhe të cilët rekomandohen nga trajnuesi. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të lëshojnë “certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset e avancuara.
5. Certifikatat themelore profesionale të prokurimit janë të vlefshme për tri (3) vite nëse nuk anulohen më herët në pajtim me paragrafin 8. të këtij neni. Personi i cili mban një certifikatë themelore të prokurimit dhe i cili nuk arrin të marrë certifikatën e avancuar brenda kësaj periudhe tri (3) vjeçare e humb të drejtën për të shërbyer si Zyrtar përgjegjës i Prokurimit përderisa ai/ajo të marrë certifikatën e avancuar. Certifikatat e avancuara kanë validitet të përhershëm dhe në rast se KRPP-ja organizon trajnime, bartësit e tyre janë të obliguar që të ndjekin trajnimet.
6. Personat të cilët posedojnë një certifikatë ose diplomë të avancuar të nivelit bachelor ose master të prokurimit të njohur ndërkombëtarësh janë të përjashtuar nga obligimi për certifikim, siç është përcaktuar në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni. Megjithatë, këta persona janë të obliguar që të marrin pjesë në trajnimin e vazhdueshëm të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni. Certifikatë ose diplomë e avancuar konsiderohen, një certifikatë ose diplomë e avancuar, të cilën e disponon një kandidat, dhe e cila është fituar në një institucion të licencuar arsimor, brenda apo jashtë Kosovës, nëse program arsimor është i bazuar në Direktivat e Prokurimit të KE, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare, të ketë zgjatur minimum pesëmbëdhjetë (15) ditë, si dhe në fund kandidati ti jetë nënshtruar provimit dhe me sukses ta ketë përfunduar atë. Diplomë bachelor ose master e prokurimit publik konsiderohet ajo diplomë e cila është fituar në një institucion të licencuar arsimor brenda apo jashtë Kosovës, dhe që i përket drejtimit të prokurimit publik.
7. Çdo person mund të marrë pjesë në kurset profesionale të trajnimit në prokurim të organizuara nga KRPP-ja dhe IKAP-i, nëse ka hapësirë të mjaftueshme pas akomodimit të Zyrtarëve të Prokurimit dhe punonjësve të njësive të Prokurimit. KRPP-ja mund të vendosë një tarifë të arsyeshme për pjesëmarrje për personat që marrin pjesë në këto kurse. Megjithatë, asnjë tarifë nuk mund të vendoset për Zyrtarët përgjegjës të Prokurimit, punonjësit e njësive të Prokurimit ose nëpunësit civil. KRPP-ja do ti sigurojë një kopje të materialeve të trajnimit çdo personi të interesuar i cili duhet të paguajë një tarifë të arsyeshme për mbulimin e shpenzimeve të kopjimit; megjithatë asnjë pagesë nuk do të kërkohej nga personat të cilët janë Zyrtarë përgjegjës të Prokurimit, punonjës të njësive të Prokurimit ose nëpunës civil të cilët kanë të drejtë të marrin një kopje të këtyre materialeve falas.
8. Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga KRPP-ja ose IKAP-i mund të anulohet nga KRPP-ja nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil. Nëse poseduesi i certifikatës nuk është nëpunës civil, KRPP-ja duhet ti dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative, personi në fjalë është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Pas periudhës një vjeçare zyrtari në fjalë mund të fillojë trajnimin bazik.
9. Në bazë të një kërkesë nga një autoritet kontraktues ose OSHP, KRPP-ja vendos nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit të specifikuara në nenin 23 apo janë bërë shkelje të rënda të këtij ligji ose rregullave të prokurimit për një certifikatë profesionale të prokurimit.

Në rast se KRPP-ja konstaton se kushtet e përmendura janë plotësuar, KRPP-ja do të vazhdojë me procedurat e theksuara në paragrafin 8 të këtij neni.

10. Për çështje më specifike të zbatimit të këtij neni KRPP-ja dhe IKAP-i do të hartojnë një rregullore për funksionimin në lidhje për trajnimin në prokurim publik.
11. Të gjithë zyrtarët të prokurimit duhet të kryejnë programet e trajnimit dhe të certifikohen në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe vendimet përkatëse të KRPPsë deri më 31.12.2016. Të gjitha certifikatat ekzistuese të mbajtura nga zyrtarët të prokurimit janë valide deri më 31.12.2016.
12. KRPP-ja, në bashkëpunim me MASHT-in, IKAP-in dhe Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, mund të vendos për akreditimin e programeve të certifikimit dhe për aprovimin e kualifikimeve të dhëna, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Nënshkrimi i kontratave publike

1. Përveç, siç përcaktohet në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni, zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Nënshkrimi dokumenton se kontrata është dhënë në pajtueshmëri me ligjin aktual. Përfundimisht, për kontratat me vlera minimale që zhvillohen në Institucionet arsimore, në pajtim me nenin 19 paragrafi 4 të këtij ligji, person i autorizuar të nënshkruaj një kontratë është Drejtori i Institucionit Arsimor.
2. Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nga kjo rregull përjashtohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme.
3. Kur Ministria e Financave cakton AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të prokurimit konform nenit 95 të këtij ligji, personat e autorizuar për përmbylljen ose nënshkrimin e kontratës janë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe ZKA-ja i AQP-së.
4. Personat e autorizuar që të nënshkruajnë sipas paragrafit 1. dhe 2. ose 3. të këtij neni mund të nënshkruajnë kontratën e tillë vetëm nëse përmbushen kushtet vijuese:
 - 4.1. Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale;
 - 4.2. Personat kanë konfirmuar edhe një herë se informatat që gjinden në "Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" janë ende të sakta;
 - 4.3. Personat nuk kanë pranuar asnjë komunikatë nga OSHP ose gjykata në të cilën thuhet se kontrata nuk duhet nënshkruar.

PJESA II

KREU I

RREGULLAT PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE DOSJEN E TENDERIT

Neni 27

Dosja e Tenderit

1. Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.
2. Kushtet e Dosjes së Tenderit sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk zbatohen për aktivitetet e prokurimit për kontratat me vlerë minimale.
3. Pa marrë parasysh se a kërkohet dosja e tenderit apo jo, furnizimet, shërbimet apo punët sipas kontratës duhet të përshkruhet me anë të fjalorit të përgjithshëm të prokurimit dhe kodeve të duhura. KRPP-ja do të ketë autoritetin për të vendosur rregulla mbi këto çështje.
4. Kurdo që një aktivitet i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të kompletohet para publikimit të njoftimit të kontratës; KRPP-ja mund të vendosë për monitorimin e kësaj dispozite, me akte nënligjore. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.

Neni 27/A

Ndarja e kontratave në Lote

1. Kontratat publike mund të ndahen në lote homogjene apo heterogjene. Autoritetet kontraktuese duhet të tregojnë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën e konfirmimit të interesit, nëse tenderët janë të kufizuar në një ose më shumë lote.
2. Autoritetet kontraktuese mundën, edhe atëherë kur është përcaktuar mundësia për të tenderuar në të gjitha lotet, të kufizojnë numrin e loteve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues, me kusht që numri maksimal të përcaktohet në njoftimin e kontratës ose në ftesën për të konfirmuar interesin. Autoritetet kontraktuese do të përcaktojnë dhe do të paraqesin në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jo-diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e loteve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kriteve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi me më shumë lote se sa numri maksimal.

Neni 28

Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do të parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyrë sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.
2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera.
4. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.
5. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës.
6. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.
7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"
8. Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Standardet apo specifikimet e tjera të paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni mund të përdoren si një mjet i ruajtjes së përputhshmërisë me kërkesat ekzekutuese apo funksionale.
9. Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për refuzimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është në përputhshmëri me një specifikim të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni nëse specifikimi i tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutuese ose funksionale dhe është i përshtatshëm. Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrën më të përshtatshme (siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimit nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me specifikimet e lartpërmendura gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale të autoritetit kontraktues.
10. Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të

dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Neni 29

Variantet e specifikimeve teknike

1. Nëse kontrata do ti shpërblehet tenderuesit ekonomikisht më të favorshëm, autoritetet kontraktuese mund të autorizojë që tenderuesit të paraqesin variantet.
2. Autoriteti kontraktues duhet të tregoj në dosjen e tenderit nëse ata autorizojnë variante apo jo;
variantet nuk do të autorizohen pa këtë indikacion.
3. Autoritetet kontraktuese që autorizojnë variantet duhet të deklarojnë në dosjen e tenderit kërkesat minimale për tu plotësuar nga variantet dhe ndonjë kërkesë specifike për prezantimin e tyre.
4. Vetëm variantet që përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara nga këto autoritete kontraktuese do të merren në konsideratë. Në procedurat për dhënien e kontratave publike për furnizime ose shërbime, autoritetet kontraktuese të cilat kanë autorizuar variantet nuk mund të refuzojnë një variant duke u bazuar vetëm në atë se, nëse është e suksesshme, më tepër do të shpie në një kontratë shërbimi se sa në një kontratë publike për furnizime ose më tepër në një kontratë furnizimi se sa një kontratë publike për shërbime.

Neni 30

Nën-kontraktimi

Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Një indikator i tillë nuk ka efekt mbi detyrimin kontraktual nga tenderuesi në lidhje me autoritetin kontraktues apo të tjerët. Autoritetet kontraktuese mund të sigurojnë, ku ata e konsiderojnë atë si të nevojshme, për pagesat direkte për nënkontraktorët.

Neni 31

Ekzekutimi i kontratave

1. Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 dhe janë paraqitur në dosjen e tenderit. Kërkesat e tilla në lidhje me ekzekutimin e një kontrate kanë qëllim të sigurojnë një nivel të caktuar të kushteve të punës ose të mbrojtjes së mjedisit.
2. Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e performancës së kontratës në veçanti atyre të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike. Autoriteti kontraktues mund të vendosë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh, në mënyrë alternative si në vijim:
 - 2.1 Detyrim për të rekrutuar persona të papunë, dhe në veçanti persona të cilët nuk janë në punë për një periudhë të gjatë;
 - 2.2 Detyrim për të rekrutuar persona të hendikepuar dhe me aftësi të kufizuara;
 - 2.3 Për të themeluar programe trajnimi për të papunët apo për të rinjtë gjatë zbatimit të kontratës;

2.4 Detyrim për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë projektuar për të nxitur barazinë gjinore apo diversitetit mbi baza të tjera; apo

2.5 Detyrim për të qenë në përputhje me substancën e dispozitave të konventave themelore të ILO-së gjatë ekzekutimit të kontratës, nëse këto dispozita nuk janë zbatuar në ligjin respektiv.

3. Një Autoritet Kontraktues mund të theksoi në dokumentacionin e kontratës organin apo organet nga të cilat një kandidat apo tenderues mund të marrë informatat e duhura për obligimet që kanë të bëjnë me tatimet, mbrojtjen e mjedisit, dispozitave të mbrojtjes së punëtorëve dhe për kushtet të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë.

KREU II

LLOJET DHE ZBATUESHMËRIA E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Neni 32

Rregullat e Përgjithshme

1. Gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurën e hapur ose procedurën e kufizuar. Nëse një dispozitë e neneve 34-37 të këtij ligji shprehimisht autorizon shfrytëzimin e një procedure tjetër prokurimi, autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë atë procedurë ose procedurën e hapur. Ushtrimi i një procedurë të prokurimit duhet të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme të këtij ligji.
2. KRPP-ja do të vendosë rregulla dhe kushte, në përputhje me ligjin e tanishëm dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, që rregullojnë zbatimin e secilës nga procedurat e vendosura të prokurimit nga nenet 32-38 të këtij ligji.
3. Kurdo që autoriteti kontraktues shfrytëzon një procedurë të përshkruar në nenin 34 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përfshijë në dosjen e tenderit një shpjegim të hollësishëm të arsyetimit të përdorur dhe faktorëve të marrë parasysh nga autoriteti kontraktues gjatë procesit të vendosjes se nëse shfrytëzimi i procedurës alternative është i duhur dhe i autorizuar sipas këtij ligji.

Neni 33

Procedurat e hapura dhe të kufizuara

1. Përveç nëse ndonjë dispozitë e neneve 34 – 37, posaçërisht e autorizon përdorimin e procedurave tjera të prokurimit, autoriteti kontraktues do të zgjedhë dhe përdorë procedurat e hapura ose të kufizuara gjatë zbatimit të aktiviteteve që kanë për qëllim dhënien e një kontrate publike.
2. Autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë procedurat e kufizuara për të kryer një aktivitet prokurimi që çon te dhënia e ndonjë kontrate publike në bazë të faktorëve të verifikueshëm dhe pa qëllime diskriminuese.
3. Pas pranimit të kërkesës për të marrë pjesë, autoriteti kontraktues do të ftojë me shkrim që të parashtrijnë tenderin ose propozimin kandidatët të cilët përmbushin kriteret e përzgjedhjes të caktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me nenin 51 të këtij ligji. Kandidatët që nuk përzgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtejshme.

Neni 34

Procedurat konkurruese me negociata

1. Në procedurat konkurruese me negocim, çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një thirrje për konkurrim, duke siguruar informacionin për përzgjedhjen cilësore që kërkohet nga autoriteti kontraktues. Në dosjen e tenderit, autoritetet kontraktuese do të identifikojnë lëndën e prokurimit duke siguruar një përshkrim të nevojave të tyre dhe karakteristikat e kërkuara të furnizimeve, punëve ose shërbimeve që do të prokurohen dhe do të specifikojnë kriteret për dhënien e kontratës. Ata gjithashtu duhet të përcaktojnë se cilat elemente të përshkrimit përcaktojnë kërkesat minimale që duhet të përmbushin të gjithë tenderët. Informacioni i siguruar duhet të jetë mjaft i saktë për t'iu mundësuar operatorëve ekonomik që të identifikojnë natyrën dhe qëllimin e prokurimit dhe të vendosin nëse do të parashtrojnë kërkesë për pjesëmarrje në procedurë. Afati kohor minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje duhet të jetë dhjetë (10) ditë nga data në të cilën është dërguar njoftimi për kontratë ose, kur përdoret një njoftim paraprak si një mjet për të bërë thirrje për konkurrencë, nga data kur është dërguar ftesa për të konfirmuar interesimin. Minimumi afati kohor për pranimin e tenderëve fillestarë do të jetë njëzet (20) ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa.
2. Vetëm ata operatorë ekonomik të ftuar nga autoriteti kontraktues pas vlerësimit të informacionit të ofruar mund të dorëzojnë një tender fillestar i cili do të jetë bazë për negociatat e mëvonshme. Autoritetet kontraktuese duhet të tregojnë, në njoftimin e kontratës numrin minimal të kandidatëve që ata kanë për qëllim që ti ftojnë dhe, kur është e përshtatshme, numrin maksimal. Në çdo rast numri minimal i kandidatëve do të jetë tre. Në çdo rast numri i kandidatëve të ftuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencë të mirëfilltë.
3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në paragrafin 4, autoritetet kontraktuese do të negociojnë me ofertuesit tenderët fillestar dhe të gjithë tenderët pasues të dorëzuar nga ana e tyre, me përjashtim të tenderëve përfundimtar brenda kuptimit të paragrafit 7, për të përmirësuar përmbajtjen e saj. Kërkesat minimale dhe kriteret e dhënies nuk do të jenë subjekt i negociatave.
4. Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata ku ata kanë përcaktuar këtë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për të konfirmuar interesin, që ata rezervojnë mundësinë për të bërë këtë.
5. Gjatë negociatave, autoritetet kontraktuese do të sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë tenderuesve. Për këtë qëllim, ata nuk do të japin informacion në mënyrë diskriminuese që mund t'u sjellë avantazhe disa ofertuesve mbi të tjerët. Ata do të informojnë të gjithë tenderuesit, tenderët e të cilëve nuk janë eliminuar në pajtim me paragrafin 6, me shkrim për çdo ndryshim në specifikimet teknike ose dokumentet tjera të prokurimit, dokumente tjera nga ato që përcaktojnë kërkesat minimale. Pas këtyre ndryshimeve, autoritetet kontraktuese do të japin kohë të mjaftueshme tenderuesve për të modifikuar dhe ri-dorëzuar tenderët e ndryshuar, sipas rasti. Autoritetet kontraktuese nuk do të zbulojnë tek pjesëmarrësit tjerë informacionin konfidencial të komunikuar nga një kandidat ose tenderues që merr pjesë në negociata pa miratimin e tij. Marrëveshja e tillë nuk do të marrë formën e një dokumenti të përgjithshëm revokues por do të epet referenca në lidhje me komunikimin e synuar të informacionit specifik.
6. Procedurat konkurruese me negocim mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar duke aplikuar kriteret e dhënies të specifikuar në njoftimin e kontratës, në ftesën për të konfirmuar interesin apo në një dokument tjetër të prokurimit. Në njoftimin e kontratës, ftesën për të konfirmuar interesin apo në një dokument tjetër të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të tregojë nëse do të përdorë atë opcion.
7. Kur autoriteti kontraktues synon të përfundojë negociatat, do të njoftoj ofertuesit e mbetur dhe do të vendos një afat kohor të përbashkët për të dorëzuar ndonjë tenderë të ri ose të rishikuar. Do të verifikojë se tenderët përfundimtar janë në përputhje me kërkesat minimale, do të vlerësojë tenderët përfundimtar në bazë të kriterëve të dhënies dhe do të shpërblejë kontratën.

Neni 35
Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm në përputhje me këtë nen. KRPP-ja, në përputhje me nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.3 të këtij ligji, duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë Brenda dy (2) ditëve nga data kur vendimi për përdorimin e procedurave të tilla është marrë. Autoriteti kontraktues duhet që në njoftim të ofrojë një shpjegim të hollësishëm të fakteve të konsideruara dhe justifikim për përdorimin e procedurës.

2. Autoriteti kontraktues mund të përdor procedurë të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e:

2.1. çfarëdo kontrate publike:

- (i) nëse, për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet ti ipet një operatori të caktuar ekonomik;
- (ii) nëse, për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i ipet vetëm një operatori të caktuar ekonomik;
- (iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektive të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

2.2 një kontrate për furnizim:

- (i) Për dërgesa shtesë nga furnizuesit fillestar kur dërgesat e tilla shtesë janë zëvendësime për produktet ose instalimet e dërguara ose kur përbëjnë një zgjatje të dërgesave aktuale të produkteve ose instalimeve nëse ndryshimi i furnizuesit domosdo kërkon nga autoriteti kontraktues që të pranojë produktet ose instalimet që kanë karakteristika të ndryshme teknike ose karakteristika të tjera që janë materialisht të ndryshme nga produktet ose instalimet që janë blerë më parë, dhe këto ndryshime do të rezultojnë në mospërputhshmëri apo vështirësi teknike të jashtëzakonshme në funksionim dhe mirëmbajtje. Me kusht që, sidoqoftë, ky nen 35.2.2(i) të mund të përdoret vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për dërgesa shtesë që vetëm, ose së bashku, e kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës që mbulonte dërgesat fillestare; ose
- (ii) Nëse autoriteti përkatës kontraktues është operator i shërbimeve publike, për blerjen e mallrave në një treg mallrash, vend-shkëmbim mallrash apo platformë ose sistem të ngjashëm tregtar.

2.3 një kontrate të shërbimeve:

- (i) që pason nga një konkurs projektimi i ushtruar përmes procedurave të hapura ose të kufizuara, dhe që kërkohet, sipas rregullave në fuqi, t'i epet kandidatit të suksesshëm.
- (ii) që do ti epet një autoriteti kontraktues që sipas një akti legjislativ ose rregullativ

normativ ose nën-normativ e gëzon një të drejtë ekskluzive për të siguruar shërbimin e tillë.

2.4. një kontratë të shërbimeve ose punëve:

- (i) për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmbyllur më parë, por të cilat, përmes rrethanave të paparashikuara, janë bërë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve ose punëve të përshkruara në projektin ose kontratën e tillë. Me kusht që ky nen 35.2.4 (i) të mund të shfrytëzohet vetëm nëse (a) kontrata që i mbulon shërbimet ose punët e tilla shtesë ti ipet operatorit ekonomik që është duke i ekzekutuar shërbimet ose punët fillestare dhe (b) shërbimet ose punët e tilla shtesë, teknikisht ose ekonomikisht nuk mund të ndahen nga kontrata kryesore pa i shkaktuar dëme autoritetit kontraktues apo (c) kur punët apo shërbimet e tilla, edhe pse të ndara nga ekzekutimi i kontratës origjinale, janë rreptësisht të domosdoshme për atë kompletim. Më tutje, me kusht që, ky nen 35.2.4(i) të mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës fillestare.
 - (ii) Për punë apo shërbime të reja që bëjnë pjesë në përsëritjen e punëve apo shërbimeve të ngjashme dhe që iu besuan operatorit ekonomik të cilit i njeiti autoritet kontraktues i dha kontratën fillestare, me kusht që punët e tilla të janë në përputhje me një procedurë bazik për të cilin kontrata origjinale ishte dhënë sipas procedurës së hapur ose të kufizuar. Sa më heret që projekti i ri të është paraqitur për tender, përdorimi i mundshëm i kësaj procedure do të deklarohet dhe kostonja totale e parashikuar e punimeve apo shërbimeve pasuese duhet të merren në procedurë e nga autoritetet kontraktuese, kur ata të aplikojnë rregullat e vlerësimit të Kapitullit 4. Autoritetet publike mund të përdorin këtë procedurë vetëm gjatë një periudhe prej dy viteve pas përfundimit të kontratës fillestare. Me kusht që, sidoqoftë, nenin 35.2.4 (ii) mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime të reja që, vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës të mëhershme të shërbimeve.
3. Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasinë, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.

Neni 36

Procedurat për kuotimin e çmimeve

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve, furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël nëse:
 - 1.1. në rast të kontratave për punë përfshinë vetëm riparime apo mirëmbajtje, ose
 - 1.2. në rast të mallrave ose shërbimeve (i) mallrat ose shërbimet përkatëse aktualisht janë në dispozicion nga operatorët ekonomik, (ii) mallrat ose shërbimet përkatëse nuk ka nevojë që të prodhohen ose përpunohen posaçërisht, në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues, dhe (iii) vetëm ekziston një treg për mallrat ose shërbimet e tilla.
2. Dosja për kuotimin e çmimeve do të: (i) përshkruajë, në përputhshmëri me nenin 28, punët, mallrat ose shërbimet, (ii) informojë të gjithë operatorët ekonomik se kuotimet e tyre duhet të përmbajnë një shumë të përgjithshme të çmimit të saktë që autoriteti kontraktues duhet ta paguajë në mënyrë që të marrë mallrat ose shërbimet përkatëse dhe se shuma e

tillë e çmimit të saktë duhet të përfshijë çfarëdo dhe të gjitha tatimet dhe doganat e aplikueshme si dhe të gjitha tarifat e tjera të transportimit, sigurimit, instalimit ose tarifat, ngarkesat ose shpenzimet e tjera të çfarëdo lloji dhe (iii) specifikojë datën deri në të cilën duhet të dorëzohen kuotimet e çmimeve.

3. Për një aktivitet të prokurimit që ushtrohet sipas paragrafit 1 të këtij neni, data deri në të cilën duhet të pranohet të gjitha kuotimet e çmimeve duhet që të mos jetë më pak se pesë (5) ditë nga data e dërgimit të Dosjes për kuotimin e çmimeve.

Neni 37

Procedurat për kontratat me vlerë minimale

KRPP është e autorizuar që në rregullat e prokurimit publik të përcaktojë një procedurë të veçantë për të rregulluar dhënien e kontratave me vlerë minimale. KRPP do të sigurojë që procedurat e tilla përmbushin kushtet e Neneve 6 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 38

Kontratat Publike Kornizë

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, të kufizuar apo të negociuar për të dhënë një kontratë publike kornizë. Kontrata publike kornizë nuk do të mund të jepet duke përdorur çfarëdo procedure tjetër.
2. Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen. Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%). pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.
3. Autoriteti kontraktues mund shpërblejë një kontratë publike kornizë kur ka në plan të shpërblejë disa kontrata identike gjatë periudhës që do të përfshihet nga kontrata publike kornizë, dhe konkluzioni i një kontrate publike kornizë që mbulon kontrata të tilla do të reduktojnë shpenzimet e prokurimit dhe administrimit të autoriteteve kontraktuese përkatëse.
4. Pas dhënies së kontratës në bazë të paragrafit 1. të këtij neni kontrata publike kornizë lejon autoritetin kontraktues që gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj të bëjë porosi ose të lidh nën-kontrata në bazë të mini-tenderëve.
5. Kontratat publike kornizë mund ti shpërblehen:
 - 5.1. një operatori ekonomik dhe në këtë rast duhet të përfshihen të gjitha kushtet e nevojshme për të lejuar që porositë të bëhen vetëm në bazë të kontratës, ose
 - 5.2. më shumë se një operatori ekonomik, por të paktën tre, dhe në këtë rast duhet të përfshijnë kriteret e dhënies që do të përdoren për mini-tenderë. Kontratat e tilla kornizë mund të lënë në mënyrë të qartë disa kushte të veçanta të cilat do të përcaktohen në kontratat ndihmese.
6. Vetëm operatorët ekonomik që janë palë të kontratës publike kornizë mund të marrin pjesë në mini-tenderë, sipas nën-paragrafit 5.2 paragrafi 5 të këtij neni. Në rast të përdorimit të

mini-tenderëve autoriteti kontraktues i fton të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë palë të kontratës publike kornizë që të paraqesin ofertat e tyre me shkrim. Afati për dorëzimin e ofertave duhet të jetë së paku pesë (5) ditë. Autoritetet kontraktuese duhet të shpërblejnë kontratën tek operatori ekonomik që ka dorëzuar ofertën më të mirë në bazë të kriterëve të dhënies të përcaktuara në ftesën për ofertim. Në rast se jo të gjithë Operatorët Ekonomikë që janë palë të Kontratës Publike kornize dorëzojnë ofertat e tyre, procedura e mini-tenderimit do të jetë e vlefshme. Autoritetet Kontraktuese do të shpërblejnë kontratën operatorit ekonomik që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterit të dhënies të përcaktuar në ftesën për ofertim. Secili shpërblim i kontratës sipas nën-paragrafit 5.2 paragrafi 5 të këtij neni do të nënshtrohet kërkesave për njoftim të nenit 41 të këtij ligji, kërkesave për nënshkrim të nenit 26 të këtij ligji, dhe dhënia e secilës kontratë të tillë ndihmëse është subjekt i rregullave të cilat rregullojnë procedurën e shqyrtimit të ankesave të përcaktuara në Pjesën IX.

7. KRPP është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që të zhvilloj dhe shpallë rregullat dhe procedurat e nevojshme që qeverisin dhënien dhe përdorimin e kontratave publike kornizë. Rregullat dhe procedurat e tilla do të (i) promovojnë konkurrencë për kontrata të tilla, (ii) të sigurojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë e procesit, (iii) të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji mbi koston ekonomike, efikasitetin si dhe parimin e mos-diskriminimit të përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji; dhe (iv) të jetë në pajtim me praktikën e mira të vendeve anëtare të BE-së.

KREU III **RREGULLAT MBI REKLAMIMIN DHE TRANSPARECËN**

Neni 39 **Njoftimi Paraprak**

1. Kur një autoritet kontraktues ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të, një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej pesë qind mijë (500.000) Euro, lidhur me secilën kategori të përmendur autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin paraprak që përcakton:
 - 1.1. në raste të kontratave të pritura për furnizim, prokurimin e përgjithshëm sipas rajonit të prodhimit nga i cili autoriteti kontraktues synon që të prokurojë brenda një periudhe të tillë dymbëdhjetë (12) mujore;
 - 1.2. në raste të kontratave të pritura të shërbimeve, vlerën e parashikuar të secilës kategori të shërbimeve të cilën autoriteti kontraktues synon që ta prokurojë brenda një periudhe të tillë dymbëdhjetë (12) mujore; dhe
 - 1.3. në raste të kontratave të pritura të punëve, karakteristikat thelbësore të kontratave të punëve të cilat autoriteti kontraktues synon që ti jep brenda një periudhe të tillë dymbëdhjetë (12) mujore.
2. Njoftimi paraprak duhet të përgatitet në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet e gjuhëve të një njoftimi paraprak, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike.
3. Në rast të njoftimeve paraprake të përshkruara në nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 paragrafi 1 të këtij neni autoriteti kontraktues sa më shpejt që është e mundur dhe pas fillimit të vitit përkatës fiskal do të përgatisë njoftimin e tillë paraprak.
4. Në rast të njoftimeve paraprake që përshkruhen në nën-paragrafin 1.3 paragrafi 1. të këtij neni nenin 39.1.3, autoriteti kontraktues do t'i përgatisë njoftimet e tilla paraprake menjëherë pas marrjes së vendimit që e miraton planifikimin e kontratës përkatëse të punëve.

Neni 40

Njoftimi i Kontratës

Kur një autoritet kontraktues synon që të ndërmarrë prokurimin duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara, kuotim të çmimit ose konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues do të përgatisë një njoftim të kontratës në gjuhët e cekura në Nenin 13. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi të kontratës, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike.

Neni 41

Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës

Nëse autoriteti kontraktues ka dhënë një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, e negociuara pa publikim, ose procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas dhënies së kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin mbi dhënien e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi për dhënien e kontratës, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike. Autoriteti kontraktues, së bashku me Njoftimin për dhënie të kontratës, duhet të dorëzoj në KRPP një kopje të deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve për kontratën e shpërblyer.

Neni 41/A

Njoftimi për nënshkrimin e kontratës

Nëse autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuara pa publikim, procedurat e kuotimit të çmimeve, ose procedurat me vlera minimale, Autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin për nënshkrimin e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji.

Neni 42

Publikimi i njoftimeve

1. Çdo autoritet kontraktues menjëherë do t'i dorëzojë KRPP-së versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi që ka përgatitur sipas nenit 39, 40, 41 ose 41/A të këtij ligji. KRPP-ja do të vendosë rregulla që e rregullojnë dorëzimin e këtyre njoftimeve.
2. Brenda dy (2) ditëve pasi që KRPP-ja të ketë pranuar njoftimin në fjalë nga një autoritet kontraktues sipas paragrafit 1 të këtij neni, KRPP-ja do t'i publikojë versionet në të gjitha gjuhët e njoftimit në fjalë në faqen e KRPP-së në internet dhe në Regjistrin e prokurimit Publik. KRPP mundet që brenda afatit të njëjtë kohor të kërkojë që autoriteti kontraktues të korrigjojë gabimet apo mangësitë në njoftim. Autoriteti kontraktues në rastet e përfshira me paragrafin 4. të këtij neni do të publikojë dhe qarkullojë korrigjimet.
3. Asnjë njoftim dhe asnjë informatë në një njoftim, nuk mund të bëhet publike ose t'i zbulohen një personi ose ndërmarrje para se të bëhet publikimi i njoftimit në fjalë në përputhshmëri me paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 43

Forma dhe Përmbajtja e Njoftimeve

Çdo njoftim do të hartohet në përputhje me formularin standard aplikativ të miratuar nga KRPP-ja.

Neni 44

Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose

Kërkesave për Pjesëmarrje

1. Çfarëdo afati kohor i caktuar nga autoriteti kontraktues për pranimin e tenderëve, ose kërkesave për pjesëmarrje duhet të jetë i mjaftueshëm për t'iu dhënë operatorëve të interesuar ekonomik, kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentet në fjalë. Gjatë caktimit të afatit kohor, autoriteti kontraktues do të marrë parasysh qëllimin dhe kompleksitetin e prokurimit përkatës dhe kontratën që do të jepet, si dhe nivelin e vështirësisë dhe/ose kompleksitetit të përgatitjes së një tenderi, të përgjegjshëm ose kërkesë për pjesëmarrje.
2. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është:
 - 2.1 kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë; dhe
 - 2.2. kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.
3. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurat e kufizuara, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve dhe kërkesave për pjesëmarrje që është:
 - 3.1. kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe jo më pak se dyzet (40) ditë për pranimin e tenderëve; dhe
 - 3.2. kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe jo më pak se njëzet (20) ditë për pranimin e tenderëve.
4. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti kontraktues do të caktojë një kohë për pranimin e tenderëve siç është cekur në paragrafin 3 të nenit 36 të këtij ligji.

Neni 45

Rregullat e posaçme për përcaktimin e afatit kohor për pranimin e tenderëve të një kontrate publike të përfshirë nga një njoftim paraprak

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 44 të këtij ligji, gjatë një aktiviteti të prokurimit që zbaton procedurat e hapura ose të kufizuara dhe që ka për qëllim një kontratë me vlerë të madhe e cila më parë ka qenë lëndë e njoftimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të përcaktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve, që nuk është më i shkurtër se njëzetekatër (24) ditë nga: (i) në rast të procedurave të hapura, data e publikimit të njoftimit të kontratës përkatëse, ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara, data në të cilën ose deri në të cilën të gjitha ftesat për tenderim janë dërguar.
2. Afatet kohore të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni mund të përdoren vetëm nëse: (i) njoftimi paraprak në fjalë i përfshin të gjitha informacionet e përcaktuara në formularin standard të miratuar nga KRPP dhe (ii) data e publikimit të njoftimit të tillë paraprak është jo më pak se dyzet (40) ditë dhe jo më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj, para publikimit të njoftimit të kontratës përkatëse.

Neni 46

Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore

1. Nëse ekzistojnë rrethanat që: (i) kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente; (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve kohore të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji ose nëse është e aplikueshme edhe në nenin 45 të këtij ligji; (iii) nuk shkaktojnë urgjencat e parashikuara nga neni 35.2.1 (iii), nuk mund tu atribuohen

veprimeve ose mos-veprimeve të autoritetit kontraktues, autoriteti kontraktues mundet të zbatojë prokurimin me përdorimin e afateve të përsheptuara kohore që përcaktohen me këtë nen.

2. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdor procedurat e hapura të prokurimit, autoriteti kontraktues mund të përcaktojë një afat të caktuar kohor për pranimin e tenderëve që është:

2.1. nëse kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë; ose

2.2. nëse kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dhjetë (10) ditë.

3. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdor procedurat e kufizuara, autoriteti kontraktues mund të caktojë një afat kohor që: (i) nuk është më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë, për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje; dhe/ose (ii) nuk është më i shkurtër se dhjetë (10) ditë, për pranimin e tenderëve.

Neni 47

Fillimi i Afatit Kohor për Pranimin Kërkesave për Pjesëmarrje dhe Tenderëve

1. Afatet kohore të caktuara në nenin 44 - 46 të këtij ligji do të kalkulojnë në sipas Nenit 5 dhe fillojnë si në vijim:

1.1. për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdor procedurat e hapura ose procedurat e kuotimit të çmimeve, në datën e publikimit të njoftimit të kontratës;

1.2. për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që përdor procedurat e kufizuara ose procedurat konkurruese me negociatë, në datën e publikimit të njoftimit të kontratës;

1.3. për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdor procedurat e kufizuara ose procedurat konkurruese me negociatë, në datën kur të gjitha ftesat për dorëzimin e tenderit janë dërguar; dhe

1.4. për pranimin e tenderëve në një aktivitet të prokurimit që përdor procedurat e kuotimit të çmimeve, në datën kur të gjitha ftesat për dorëzimin e kuotimeve janë dërguar.

Neni 48

Dorëzimi i Dosjes së Tenderit

1. Nëse operatori ekonomik me kohë ka parashtruar një kërkesë për të marrë një dosje të tenderit që i përmbush kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës përkatëse nga autoriteti përkatës kontraktues shprehimisht kërkohet që të ia dorëzojë operatorit përkatës ekonomik dosjen e kërkuar të tenderit pa pagesë, siç vijon:

1.1. nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është më shumë se tridhjetë (30) ditë, jo më vonë se gjashtë ditë pas pranimit të kërkesës së tillë;

1.2. nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është më shumë se njëzet (20) ditë por më pak se tridhjetë (30) ditë, jo më vonë se katër ditë pas pranimit të kërkesës së tillë; dhe

1.3. nëse afati kohor për pranimin e tenderëve është më i shkurtër se njëzet (20) ditë, jo më vonë se tri (3) ditë pas pranimit të kërkesës së tillë.

2. Pavarësisht kërkesës së dorëzimit të dosjes së tenderit pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni autoriteti kontraktues mund të vendosë një tarifë në rastet, kur shpenzimet për prodhim të materialit të tenderit janë të larta si në rastet, kur ato përmbajnë modele apo numër të madh të kopjeve teknike. Shuma e tarifës së kërkuar në këto raste nuk bënë të tejkaloj shumën e prodhimit të këtij materiali.

Neni 49

Mënyra e Dërgimit të Kërkesave për Pjesëmarrje

Kërkesat për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që shpien drejt dhënies së ndonjë kontrate publike, mund të paraqiten në mënyrë elektronike, me shkrim ose telefaks.

Neni 50

Dërgimi dhe Përmbajtja e Ftesave për Tender

1. Gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues njëkohësisht do t'u dërgoj me shkrim të gjithë kandidatëve të zgjedhur ftesën për tenderim.
2. Gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, të gjitha ftesat për tenderim do të dërgohen së bashku me dosjen e tenderit, përveç nëse autoriteti kontraktues ka bërë të mundshme marrjen e dosjes së tenderit në mënyrë elektronike. Nëse autoriteti kontraktues i ka vënë materialet e tilla në dispozicion në mënyrë elektronike, ftesa do të përmbajë informacione të mjaftueshme që t'i mundësojë kandidatit qasje në këtë material.
3. Forma dhe përmbajtja e secilit tender, dokument ose informatë tjetër dorëzuar kandidatit, duhet të jetë identike me ato që i dorëzohen secilit kandidat tjetër. Asnjë kandidat nuk do të ketë më pak ose më shumë qasje në çfarëdo dokumenti ose informacioni, sesa cilido kandidat tjetër.
4. Nëse një aktivitet i prokurimit që përdor procedurat e kufizuara ose procedurat konkurruese me negociata zbatohet me afate të përshpejtuara kohore sipas paragrafit 3. të nenit 46 të këtij ligji, autoriteti kontraktues do të dërgojë ftesat për dorëzimin e tenderëve në mënyrën më të shpejtë të komunikimit që është e mundur.

Neni 51

Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

1. Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënie e një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose procedurave konkurruese me negociata, për të pranuar një ftesë për tenderim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.
2. Autoriteti kontraktues duhet: (i) të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundshme, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje; dhe (ii) të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit, të gjitha dokumentet dhe informatat në fjalë. Të gjitha këto kërkesa për dokumente dhe informata do të kufizohen vetëm në aq dokumente dhe informata sa është e nevojshme për ti lejuar autoritetit kontraktues që të verifikojë se operatori përkatës ekonomik: (i) nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas

nenit 65 të këtij ligji, dhe (ii) nëse aplikohet, i përmbush kriteret minimale të përzgjedhjes të saktësuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në asnjë rast njoftimi i kontratës ose dosja e tenderit nuk do të kërkojnë nga operatori i interesuar ekonomik që të dorëzojë dokumente ose informata që nuk kërkojnë ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65-70 të këtij ligji.

3. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Neni 52

Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikojë kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm.
2. Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t'i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin ekonomikisht më të favorshëm, autoriteti kontraktues në fjalë duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre.
3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.
4. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të paragrafit 3. të këtij neni dhe kriterëve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kriterëve.
5. Në rast të kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm është e detyrueshme që të konvertohet çdo element i kriterëve të dhënies në pikë dhe më pas të peshohet në bazë të formulës dhe peshave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe Dosjen e Tenderit.
6. Në rast të kriterit, tenderi me çmimin më të ulët nuk lejohet konvertimi i çmimeve në pikë dhe të peshohen pikët. Në rast të kontratave për shërbime të shumfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.
7. Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.

Neni 53

Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

1. Gjatë përgatitjes së tenderit, çdo operator ekonomik mund të bëjë kërkesë me shkrim te autoriteti përkatës kontraktues për çfarëdo informate apo sqarim shtesë që operatori ekonomik beson se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi

përkatës, me kusht që çdo kërkesë e tillë me shkrim të pranohet nga autoriteti kontraktues:

- 1.1. Jo më pak se njëzet (20) ditë para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është dyzet (40) ditë ose më gjatë;
 - 1.2. jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është 30 ditë apo më gjatë por jo më pak se dyzet (40) ditë;
 - 1.3. jo më pak se dhjetë (10) ditë para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është njëzet (20) ditë apo më gjatë por jo më pak se tridhjetë (30) ditë, ose
 - 1.4. jo më pak se tri (3) ditë para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është pesë (5) ditë ose më gjatë por jo më pak se njëzet (20) ditë.
2. Një kërkesë e tillë mund t'i dorëzohet autoritetit kontraktues në mënyrë elektronike, me shkrim ose telefaks.
 3. Autoriteti kontraktues do të përcaktojë datën deri te cila datë do të pranojë kërkesën nga dosjet tenderuese.
 4. Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkesë të tillë për të përcaktuar nëse operatorët ekonomik kanë apo nuk kanë nevojë për informatat sqaruese ose plotësues të kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm.
 5. Nëse autoriteti kontraktues konstaton se operatorët ekonomik nuk kanë nevojë për informatat e kërkuara, autoriteti kontraktues menjëherë do t'i njoftojë mbi refuzimin e kërkesës me shkrim operatorit përkatës ekonomik.
 6. Nëse autoriteti kontraktues konstaton se ndonjëra nga informatat e kërkuara sqaruese ose plotësuese e cila kërkohet nga operatorët ekonomik për kontraktim është e domosdoshme për ta, autoriteti kontraktues menjëherë dhe në të njëjtën kohë siguron informata me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, të gjithë operatorëve ekonomik, që kanë marrë ose kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen e tenderit përkatës ose ftesën për tenderim. Autoriteti kontraktues nuk do të zbulojë identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar informatat sqaruese.
 7. Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtë se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do ti zgjatet afati i tillë për ti dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për ti dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do ti lejohet që të dorëzojë një përmirësim për tenderin përkatës, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që janë të lidhura me informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë.
 8. Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të kuotimit të çmimeve, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose shtesë operatorëve ekonomik, dhe data në të cilën informatat e tilla jepen është më shkurt se tri (3) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoriteti kontraktues do të zgjasë afatin e tillë kohor për t'i dhënë operatorëve ekonomik së paku tri (3) ditë nga data në të cilën informatat e tilla, për t'i dorëzuar tenderët e tyre. Nëse operatori ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do t'i lejohet që të dorëzojë një ndryshim për tenderin në fjalë, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që janë të lidhura me

informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë.

9. Nëse, në çfarëdo kohe para afatit të caktuar kohor për pranimin e tenderëve, një autoritet kontraktues vendos ose i bëhet me dije - përmes çfarëdo mjeti - se ndonjë nga informatat sqaruese ose shtesë janë të nevojshme për autoritetin kontraktues menjëherë dhe në të njëjtën kohë siguron informata me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, të gjithë operatorëve ekonomik, që kanë marrë ose kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen e tenderit përkatës ose ftesën për tenderim. Në rast të tilla, autoriteti kontraktues do të zgjasë afatin kohor për pranimin e tenderëve në përputhje me paragrafin 7. ose 8. të këtij neni, cilado që të jetë e aplikueshme

Neni 54

Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

1. Kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt.
Njoftimi i tillë duhet që së paku të përmbajë informatat të cilat shpjegojnë arsyet përkatëse në përputhshmëri me:
 - 1.1. në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati.
 - 1.2. në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë.
 - 1.3. në rast të një tenderuesi të pa-suksesshëm, që ka paraqitur tender të përgjegjshëm, njoftimi do të saktësojë karakteristikat dhe përparësitë përkatëse të tenderit fitues si dhe emrin e tenderuesit fitues.

Neni 55

Mënyrat e Komunikimit

1. Përveç gjatë vend-shikimeve ose mbledhjeve para-tenderimit, të gjitha komunikimet dhe këmbimet e informacioneve ndërmjet operatorëve ekonomik dhe një autoriteti kontraktues do të bëhen: (i) me shkrim – në letër, me faks dhe/ose në mënyrë elektronike dhe (ii) në përputhshmëri me të gjitha dispozitat e tjera të aplikueshme të këtij ligji.
2. Nëse autoriteti kontraktues formalisht aranzhon një vend-shikim ose mbledhje para-tenderimit për operatorët e interesuar ekonomik, autoriteti kontraktues mund të komunikojë në mënyrë gojore me operatorët e interesuar ekonomik të pranishëm në vendshikim ose mbledhje para-tenderimit, nëse: (i) të gjithë operatorëve të interesuar u është dhënë njoftim i arsyeshëm dhe mundësi e arsyeshme për të marrë pjesë në vendshikim ose në mbledhjen para-tenderimit, (ii) komunikimet gojore bëhen në publik dhe në mënyrë transparente, dhe (iii) menjëherë pas komunikimit të tillë gojor, autoriteti kontraktues përgatit një përmbledhje të të gjitha aspekteve materiale të komunikimit të tillë dhe të njëjtin ua dërgon apo e vë në dispozicion për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik.
3. Komunikimi dhe këmbimi i tillë i informacioneve, bëhet në mënyrën me të cilën sigurohet integriteti i të dhënave dhe sekretit i tenderëve dhe të gjitha informacioneve të dhëna nga operatorët ekonomik dhe që autoriteti kontraktues të mund të shqyrtojë përmbajtjen e të gjitha tenderëve ose kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pas skadimit të afateve të caktuara për pranimin e tyre.

KREU IV

UDHËHEQJA E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Neni 56

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
 - 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;
 - 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.
2. Në rastin e procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, autoriteti kontraktues do t'i zgjedhë kandidatët që do të ftohen për të dorëzuar tender ose propozim, vetëm në bazë të:
 - 2.1. kriterëve të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me paragrafin 2. të nenit 51 të këtij ligji dhe
 - 2.2. Dokumenteve, informatave dhe/ose dëshmime mbi kualifikimet e dorëzuara nga kandidatët si përgjigje të drejtpërdrejt ndaj kërkesave të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet parakualifikuese. Kandidatët që nuk zgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtejshme. Të gjithë kandidatët të cilët konstatohet se i plotësojnë kriteret e specifikuar dhe të cilët nuk janë përjashtuar sipas këtij paragrafi, do të ftohen që të dorëzojnë tender, përveç nëse numri i këtyre kandidatëve tejkalon numrin gjashtë (6). Nëse numri i kandidatëve tejkalon numrin gjashtë (6) atëherë autoriteti kontraktues do të ftojë vetëm gjashtë (6) kandidatët më të kualifikuar që të dorëzojnë tender. KRPP-ja në rregullat e prokurimit publik do të vendosë një procedurë detale që autoritetet kontraktuese duhet ta respektojnë gjatë përzgjedhjes në fjalë. KRPP-ja do të sigurojë që procedura e tillë është: (i) në përputhshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare, (ii) siguron konkurrencë dhe transparencë adekuate, (iii) zbaton parimin e mos-diskriminimit, dhe (iv) përndryshe është në përputhshmëri me dispozitat aplikative të këtij ligji. Autoriteti kontraktues duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dokumentet e parakualifikimit (i) informatat të cilat do të formojnë bazën për përzgjedhjen e kandidatëve (ii) kriteret objektive dhe jo-diskriminuese që do të merren parasysh gjatë procedurës së përzgjedhjes dhe peshën që i është dhënë secilit kriter.
3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Neni 57

Sigurimi i Tenderit

1. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet, në rast se:
 - 1.1. autoriteti kontraktues vendos, duke u bazuar në fakte të verifikuara se tenderuesi në fjalë i ka dhënë autoritetit kontraktues informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese,
 - 1.2. tenderuesi në fjalë e tërheqë tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në

dosjen e tenderit.

- 1.3. tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon: (i) që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në dosjen e tenderit; (ii) që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose (iii) që të ekzekutojë një kontratë që përputhet me kushtet e specifikuara në dosjen e tenderit.
2. Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit.
3. Nëse autoriteti kontraktues vendos që të detyrojë depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se një për qind (1%) dhe jo më shumë se tre për qind (3%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se një mijë (1.000) Euro.
4. Nëse autoriteti kontraktues vendos kusht për siguri të tenderit, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit:
 - 4.1. të gjitha kushtet në lidhje me natyrën, formën, shumën si dhe kushtet e tjera për sigurinë e tenderit; me kusht që, të gjitha kushtet e tilla të jenë në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e prokurimit publik;
 - 4.2. shuma e saktë e sigurimit të tenderit dhe periudha e nevojshme e vlefshmërisë për sigurimin e tenderit;
 - 4.3. afati kohor për pranimin e sigurimit të tenderit, që është i njëjtë me atë për pranimin e tenderëve; dhe
 - 4.4. një deklaratë të rasteve, sipas paragrafin 1. të këtij neni, në të cilat siguri i tenderit humbet.
5. Sigurimi i tenderit bëhet në formë të çekut të vërtetuar, letër krediti, garancion bankar ose polisë e sigurimit; sidoqoftë, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit të gjitha kushtet – e parapara në rregullat e prokurimit – që duhet të përmbushë lëshuesi i çekut, letrës së kreditit, garantimit bankar apo polisës së sigurimit.
6. Autoritetet Kontraktuese nuk do të kufizojnë në Dosjen e Tenderit diskrecionin e tenderuesve që të paraqesin sigurimin e tenderit në cilëndo nga format e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen, përveç atyre të referuara në paragrafin 5 të këtij neni, do të konsiderohet e pavlefshme.
7. Nëse nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që do të shkaktonte konfiskimin e sigurisë së tenderit, siç është cekur në paragrafin 1. të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kthejë fondet ose dokumentin që është depozituar si siguri e tenderit brenda pesë (5) ditëve pas ndodhjes të cilësdo nga këto ngjarje në vijim:
 - 7.1. skadimi i datës së vlefshmërisë së tenderit;
 - 7.2. dhënia dhe hyrja në fuqi e kontratës përkatëse publike;
 - 7.3. anulimi formal ose përfundimi i aktivitetit të prokurimit para dhënies ose hyrjes në fuqi të kontratës përkatëse publike; ose

7.4. tërheqja e tenderit para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve, përveç nëse dosja e tenderit në mënyrë eksplicite thotë se tërheqja e tenderit nuk lejohet.

8. Nëse autoriteti kontraktues konstaton se ka ndodhur një ngjarje që kërkon konfiskimin e sigurisë së tenderit sipas paragrafit 1 të këtij neni autoriteti i tillë kontraktues do të njoftojë tenderuesin përkatës me shkrim mbi vendimin e tillë. Sidoqoftë, nëse siguria e tenderit në fjalë është deponuar në formë kredie ose sigurie bankare, autoriteti kontraktues duhet që së pari të marrë të gjitha masat e nevojshme për ti marrë fondet përkatëse nga lëshuesi i tyre para se ti dërgojë tenderuesit njoftimin e kërkuar nga fjalë e mësipërme. Autoriteti kontraktues do ti lërë fondet e tilla të deponuara të cilat nuk mund të shfrytëzohen përderisa tenderuesi përkatës të ketë shpenzuar pa sukses të gjitha të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të autoritetit kontraktues. Pasi që tenderuesi ti ketë shpenzuar pa sukses të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të tillë, dhe nuk është pranuar asnjë urdhër nga OSHP-ja, ose një gjykatë kompetente që kërkon nga autoriteti kontraktues që të mos bëjë asnjë sistemim tjetër të fondeve në fjalë, autoriteti kontraktues do të:

8.1. nëse autoriteti kontraktues u nënshtrohet akteve normative mbi çështjet publike buxhetore ose çështjet e përvetësimeve, trajtojë konfiskimin e depozitit të tillë të sigurisë si gjobë dhe/ose dënim dhe do ti transferojë fondet e tilla në Fondin e Buxhetit të Kosovës në përputhshmëri me dispozitat përkatëse të akteve të tilla; ose

8.2 nëse autoriteti kontraktues nuk u nënshtrohet akteve të tilla, transferojë fondet e tilla të konfiskuara në xhirollogarinë e tij të përgjithshme rrjedhëse dhe për qëllime të kontabilitetit dhe tatimore, do t'i trajtojë fondet e tilla të konfiskuara të tenderit, si të ardhura të zakonshme.

Neni 58 **Hapja e Tenderëve**

1. Tenderët e pranuar në një aktivitet prokurimi të kryer duke përdorur procedurat e hapura apo të kufizuara do të hapen vetëm publikisht. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit vendin dhe kohën e hapjes së tenderëve. Nëse autoriteti kontraktues, në përputhshmëri me këtë ligj e nxjerr një dokument, duke e autorizuar zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e tenderëve, autoriteti i tillë kontraktues, në dokumentin e tillë duhet të specifikojë afat të ri kohor për hapjen e tenderëve. Afati i caktuar për hapjen publike të tenderëve duhet të jetë menjëherë pas afatit të fundit kohor të caktuar për pranimin e tenderëve. Autoriteti kontraktues nuk do të hapë tenderët në çfarëdo vendi tjetër ose në çfarëdo kohe tjetër.
2. Të gjithë tenderët që dorëzohen para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve do të hapen në vendin dhe kohën e specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni. Tenderët që janë dorëzuar pas afatit të fundit kohor nuk do të hapen ose shqyrtohen dhe menjëherë do t'i kthehen të pahapura operatorëve ekonomik që i kanë dorëzuar ato. Çdo tenderues ka të drejtë që të dërgojë një përfaqësues që të vëzhgojë hapjen e tenderëve.
3. Zyrtari përkatës i prokurimit e bën hapjen e tenderëve. Gjatë hapjes së çdo tenderi, Zyrtari i Prokurimit do t'u lexojë me zë atyre që janë të pranishëm: (i) emrin dhe vendin e tenderuesit, (ii) çmimin e përgjithshëm të tenderit të specifikuar në tenderin e tillë dhe, kurdo që është e mundur, çmimet për njësi, përveç kur dokumenti përkatës është vetëm komponenti i propozimit teknik të tenderit dypjesësh, dhe ndonjë vërejtje. Kur për arsye të jo atypëratyshme çmimet për njësi nuk mund të lexon, çmimet e tilla në çdo rast duhet të bëhen të dukshme gjatë hapjes publike për të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, si për shembull duke bërë postimin e tyre ose duke përdorur ndonjë tjetër metodë adekuate e cila garanton transparencë. Në çdo rast, secila faqe e çdo tenderi financiar do të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër. Në rast të aktivitetit të prokurimit ku kriteri i shpërblimit të kontratës është tenderi ekonomikisht me i favorshëm çdo gjë që ka të bëjë me numra duhet të lexohet si afati i dërgesës, periudha e garancionit dhe të ngjashme. Të gjitha informatat që lexohen kështu do të regjistrohen në procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, i cili në fund të mbledhjes do të nënshkruhet

nga Zyrtari përkatës i Prokurimit, anëtarët e Komisionit të Hapjes dhe secili përfaqësues i tenderuesit që janë të pranishëm në mbledhje. Procesverbali në fjalë menjëherë do të përfshihet në shënimet mbi aktivitetin e prokurimit që kërkohen nga paragrafi 1 i nenit 10 të këtij ligji dhe kopjet e procesverbalit në fjalë do t'u dërgohen menjëherë të gjithë tenderuesve.

4. Në rastin e tenderëve dypjesësh të cilët përbëhet nga një propozim teknik dhe një propozim financiar. Të dyja propozimet duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë mirëpo në zarfe të veçanta. Autoriteti kontraktues përcakton në dosjen e tenderit se propozimet teknike do të hapen në mënyrë publike në një datë ndërsa propozimet financiare në një datë tjetër të mëvonshme. Në datën e hapjes së propozimeve financiare, Zyrtari i Prokurimit së pari do të bëjë të ditur notat e secilit propozim teknik dhe më pas do të hapë propozimet financiare. Kërkesat e paragrafit 3. të këtij neni do të aplikohen për të dyja ceremonitë e hapjes.

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyrues lidhur me këtë çështje.
2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.
3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tender të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidohet ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.
4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.
5. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar.

Neni 60

Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:
 - 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;
 - 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.
2. Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do ti jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji.

Neni 61

Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.
2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:
 - 2.1. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
 - 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
 - 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
 - 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.
3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.
4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.
5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen.

6. KRPP-ja nxjerr akt nënligjor për rregullimin në hollësi për përcaktimin e çmimit jonormalisht të ulët.

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
 - 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
 - 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
 - 2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Neni 63 **Siguria e Ekzekutimit**

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë një kontratë që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së tillë nëse: (i) kontrata e tillë është kontratë e punëve; (ii) kontrata e tillë është kontratë e shërbimeve për krijimin e programeve kompjuterike, ose; (iii) ekziston rreziku se thyerja e kontratës së tillë do të shkaktojë dëme substanciale autoritetit kontraktues dhe/ose mund të kërkojë që autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë.
2. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që shumën e çfarëdo sigurie të ekzekutimit që kërkohet nga paragrafi 1. i këtij neni: (i) të jetë e barabartë me së paku dhjetë përqind (10%) të vlerës së kontratës dhe (ii) përndryshe është vendosur në një nivel që është në përputhshmëri me praktikën e zakonshme publike dhe afariste të aplikueshme ndaj llojit të veçantë dhe lëndës së kontratës përkatëse.
3. Në rastet e kontratave të mesme apo të mëdha, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të bëjë sigurimin e ekzekutimit për përfitimin dhe zbatimin e rasteve të autoritetit kontraktues si parakusht të nënshkrimit dhe hyrjen në fuqi të kontratave të tilla dhe vlerën e një sigurimi të tillë që do të jetë e barabartë me dëmet dhe shpenzimet që autoriteti kontraktues parashikon se do të ketë në rast të shkeljes së kontratës nga operatori ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që dosja e tenderit dhe kontrata përkatëse publike të përmbajnë dispozita detale mbi karakterin, formën, shumën, statusin, kushtet, konfiskimin dhe kthimin e çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit. Dispozitat e tilla duhet të jenë në përputhshmëri me praktikën e zakonshme publike dhe afariste për llojin dhe lëndën e veçantë të kontratës publike. Në veçanti, kontrata përkatëse duhet që: (i) të kërkojë nga autoriteti kontraktues që t'i sigurojë operatorit ekonomik një njoftim me shkrim mbi çfarëdo pretendimi të tij se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën, dhe (ii) t'i japë operatorit ekonomik një afat të caktuar kohor për të korrigjuar dështimin e tillë.
5. Sigurimi i ekzekutimit mund të bëhet në çek të vërtetuar, letër krediti, bono të performancës, ose siguri bankare; të lëshuara nga një bankë me reputacion që merr mbi vete ti bëjë pagesën autoritetit kontraktues, pa vërtetime të mëtutjeshme apo kushte, dhe pa zbritje, ndonjë shumë deri në shumën e specifikuar, në pranimin e kërkesës me shkrim të autoritetit kontraktues në rast se operatori ekonomik është në shkelje të obligimeve ndaj autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit

kushtet shtesë që duhet përmbushur nga autorizuesi i sigurimeve të ekzekutimit.

6. Autoritetet Kontraktuese nuk do të kufizojnë në Dosjen e Tenderit diskrecionin e tenderuesve që të paraqesin sigurimin e ekzekutimit në cilëndo nga format e përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen, përveç atyre të referuara në paragrafin 5 të këtij neni, do të konsiderohet e pavlefshme.

7. Nëse nuk ka ngjarë asgjë që mund të shkaktojë konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, autoriteti kontraktues do t'i kthejë fondet ose dokumentet që janë depozituar në formë të sigurisë së ekzekutimit, në përputhshmëri me kushtet e kontratës përkatëse.

8. Nëse autoriteti kontraktues vendos se ka ndodhur një ngjarje që kërkon konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, siç është cekur në kontratën përkatëse, autoriteti i tillë kontraktues mund të zbatojë rregulla të tilla të këshilluara nga kontrata, letra e kreditit, bono të performances apo sigurimin bankar, apo nga ligji. Në pranimin e ndonjë fondi të marrur sipas konfiskimit të sigurimit të ekzekutimit autoriteti kontraktues do të:

8.1. nëse autoriteti kontraktues u nënshtrohet akteve normative mbi çështjet publike buxhetore ose çështjet e përvetësimeve, trajtojë konfiskimin e depozitit të tillë të sigurisë së ekzekutimit si gjobë dhe/ose dënim dhe do ti transferojë fondet e tilla në Fondin e Buxhetit të Kosovës në përputhshmëri me dispozitat përkatëse të akteve të tilla; ose

8.2. nëse autoriteti kontraktues nuk u nënshtrohet akteve të tilla, të transferojë fondet e tilla të konfiskuara në xhirollogarinë e tij të përgjithshme rrjedhëse dhe për qëllime të kontabilitetit dhe tatimore, t'i trajtojë fondet e tilla të konfiskuara të tenderit, si të ardhura të zakonshme (përgjithshme) të autoritetit kontraktues.

KREU V KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË DHE TË KUALIFIKIMIT

Neni 64 Dëshmitë e kërkesave

Një kandidat ose tenderues do të dëshmojë me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji.

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

1.1. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose

1.2. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit.

1.3. Duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1.75.

2. Pavarësisht nga dispozitat e më sipërme, autoriteti kontraktues duhet t'i japë operatorit ekonomik që s'kualifikohet sipas paragrafit 1 të këtij neni, një mundësi për t'i demonstruar autoritetit kontraktues se ai nuk ka arritur ndonjë përparësi në konkurrencë nga pjesëmarrja ose asistenca e tillë. Nëse operatorit ekonomik mund të ia demonstrojë këtë bindshëm autoritetit kontraktues, atëherë ai nuk shkualifikohet sipas paragrafit 1 të këtij neni. Të gjitha vendimet e autoritetit kontraktues për këtë çështje mund të apelojnë para OSHP-së nga operatori ekonomik ose ndonjë palë tjetër e interesuar.
3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;
 - 3.1. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
 - 3.2. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndë profesionale **e konstatuar nga një gjykatë kompetente;**
 - 3.3. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose
 - 3.4. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;
 - 3.5. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
 - 3.6. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.
4. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik
 - 4.1. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimi të urdhrit për likuidim ose përmbyllje të aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër.
 - 4.2. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
 - 4.3. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafte që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
 - 4.4. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët 4.1, 4.2. të

këtij neni; ose

4.3 të këtij paragrafi që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;

4.5. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operator të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.

4.6. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;

4.7. gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;

4.8. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;

4.9 është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;

4.10. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës; ose

4.11. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes.

5. Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprind datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

Neni 66

Përshtatshmëria Profesionale

1. Kur një operator ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike duhet të regjistrohet në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në mënyrë që të zbatohet aktivitetet për të cilat një regjistrim i tillë kërkohet, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend. **Regjistri komercial nuk kërkohet në rastet e organizatave të shoqërisë civile.**

2. Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.

Neni 67

Provat Shkresore

1. KRPP përgatit dhe miraton rregullat lidhur me llojet e dokumenteve, provave dhe/ose deklaratave që operatori ekonomik duhet ti paraqes për të dëshmuar se ai nuk është i përjashtuar sipas dispozitave të nenit 65 të këtij ligji. KRPP-ja po ashtu duhet të përgatisë dhe miratojë rregulla për llojet e dokumentacionit që autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga një operator ekonomik për të dëshmuar përshtatshmërinë e tij profesionale sipas nenit 66 të këtij ligji. KRPP-ja duhet të sigurojë që sipas rregullave në fjalë të mos kërkohej rreptësisht paraqitja e dokumente ose deklaratave që nuk janë në dispozicion në vende ose rajone të caktuara. KRPP-ja duhet të sigurojë që rregullat në fjalë në masë të arsyeshme të lejojnë operatorëve ekonomik paraqitjen e deklaratave nën betim, deklaratave të noterizuara e të ngjashme. Në të gjitha rastet, nga operatori ekonomik kërkohej që të pranojë mundësinë e sanksionimit të tij penal dhe civil si dhe përgjegjësinë e tij për dënimet dhe dëmet, nëse operatori ekonomik me dashje ose nga pakujdesia paraqet një dokument, deklaratë ose raport materialisht të pasaktë ose mashtrues.
2. Autoriteti kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet: (i) certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji, (ii) certifikatë, dokument ose ndonjë provë tjetër të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme kërkohej nga autoriteti kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji, që në mënyrë të arsyeshme tregojnë se kandidati ose tenderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës.

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohej, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do të referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohej të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:
 - 1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;
 - 1.2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;
 - 1.3. kopjet e certifikuar të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohej publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose
 - 1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose
- 1.5. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.
2. Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender

ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe/ose referencat e tjera kërkohen prej tij.

3. Nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorit ekonomik i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm.
4. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera.

Neni 69

Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.
2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpjen drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:
 - 2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
 - 2.2. përshkrimit të pajisjeve teknike të operatorit ekonomik, masave të sigurimit të cilësisë dhe pajisjeve për zhvillim;
 - 2.3. shënimit për përfshirjen e teknikëve dhe organeve teknike, sidomos të atyre që janë përgjegjës për kontrollimin e cilësisë;
 - 2.4. mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen; dhe/ose
 - 2.5. certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranura që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.
3. Nëse lidhur me procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet livrimi i produkteve, të gjitha produktet që duhet të furnizohen janë komplekse ose, përjashtimisht, kërkohen për qëllime të posaçme, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës që t'i nënshtrohen një inspektimi me qëllim të verifikimit të kapaciteteve të tyre prodhuese, dhe nëse është e rëndësishme, të

pajisjeve të tyre të hulumtimit dhe zhvillimit dhe masat për vërtetimin e cilësisë. Inspektimin e tillë, me shpenzimet e autoritetit kontraktues, mund ta kryej autoriteti kontraktues ose organi kompetent i pavarur në vendin në të cilin themelohet autoriteti ekonomik përkatës.

4. Në procedurat që shpjen në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshkohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkojnë lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:
 - 4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve;
 - 4.2. listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenëshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;
 - 4.3. një shënim të personelit teknik ose organeve teknike të përfshira, pavarësisht se a i takojnë ose nuk i takojnë drejtpërdrejt operatorit ekonomik, sidomos për ata që janë përgjegjës për kontrollimin e cilësisë;
 - 4.4. raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e fundit;
 - 4.5. raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve;
 - 4.6. përshkrimin e masave që do të merren nga operatori ekonomik për të siguruar cilësinë dhe pajisjet për hulumtime e zhvillim;
 - 4.7. përshkrimin e elementeve të kontratës përkatëse që operatori ekonomik planifikon që t'i nënkontrakttojë; dhe/ose
 - 4.8. informacione tjera përkatëse dhe te duhura.
5. Nëse, lidhur me procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike me të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, të gjitha shërbimet që duhet të furnizohen janë komplekse ose, përjashtimisht, kërkojnë për qëllime të posaçme, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës që t'i nënshtrohen një inspektimi me qëllim të verifikimit të kapaciteteve të tyre prodhuese, dhe nëse është e rëndësishme, për lehtësirat për hulumtime e zhvillim dhe masat për vërtetimin e cilësisë. Inspektimin e tillë, me shpenzime të autoritetit kontraktues, mund ta kryej autoriteti kontraktues ose organi i pavarur kompetent i pavarur në vendin në të cilin është themeluar operatori ekonomik në fjalë.
6. Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të

kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkatëse me:

- 6.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore;
 - 6.2. listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;
 - 6.3. raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore;
 - 6.4. raportin për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara;
 - 6.5. raportin për teknikët ose të njësitë teknike në të cilët mund të thirret kontraktuesi për zbatimin e projektit të punëve ose realizimin e aktiviteteve ndërtimore, pavarësisht se a i takojnë ose nuk i takojnë operatorit ekonomik; dhe/ose
 - 6.6. informacion tjetër përkatës dhe relevant.
7. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tenderim do të specifikojë se cilat referenca (dokumentacione) të saktësuara në këtë nen, i nevojiten.
 8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera.

Neni 70

Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara.

Neni 71

Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

1. Grupi i operatorëve ekonomik mund të dorëzojë ftesë për pjesëmarrje ose një tender. Nga asnjëri grup i tillë nuk kërkohet që të marrë përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin; mirëpo, nga grupi i përzgjedhur mund të kërkohet që të bëjë këtë pasi që të epet kontrata në fjalë, për aq sa kjo është e nevojshme, për përmbushjen e mjaftueshme të kontratës.
2. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtojnë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast se një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.
3. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje.
4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësuar certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

PJESA III

RREGULLAT PËR KONKURSET E PROJEKTIMIT

Neni 73

Dispozitat e Përgjithshme

1. Rregullat për organizimin dhe udhëheqjen e një konkursi për projektim duhet të jenë në përputhshmëri me dispozitat e përcaktuara në këtë Pjesë III dhe ato do t'u komunikohen të gjithë personave dhe ndërmarrjeve që i përgjigjen njoftimit për konkursin e projektimit.
2. Konkursi i projektimit do të ushtrohet në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtat afate kohore

siç ushtrohen aktivitetet e prokurimit për kontratat me vlerë të madhe që zbatojnë procedurat e hapura ose të kufizuara.

3. Nëse, pa kurrfarë qëllimi që të diskriminojë në favor ose kundër një personi ose ndërmarrje, autoriteti kontraktues vendos se: (i) konkursi i nevojshëm i projektimit mund të sigurohet, furnizohet ose ekzekutohet nga personi ose ndërmarrja me kualifikimet adekuate profesionale ose teknike dhe (ii) autoriteti i tillë kontraktues do të pranojë vetëm konkursin e dorëzuar nga personat ose ndërmarrjet që i posedojnë kualifikimet e caktuara minimale, autoriteti kontraktues do t'i vendosë kushtet për kualifikimet e tilla në mënyrë të qartë, objektive dhe jo-diskriminuese dhe do t'i publikojë të gjitha kërkesat e tilla në njoftimin për konkursin e projektimit.

Neni 74 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Pjese vlejnë për të gjitha konkursin e projektimit.

Neni 75 Njoftimi mbi Konkursin e Projektimit

Kur autoriteti kontraktues planifikon të mbajë një konkurs për projektim, autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin mbi konkursin e projektimit në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues menjëherë do të ia dorëzojë KRPP-së versionet në të gjitha gjuhët e njoftimit në fjalë.

Neni 76 Formulari dhe Përmbajtja e Njoftimeve për Konkursin e Projektimit

Të gjitha njoftimet lidhur me konkursin e projektimit do të përpilohen dhe publikohen në pajtim me formularin e aplikueshëm standard që miratohet nga KRPP.

Neni 77 Publikimi i Njoftimeve për Konkursin e Projektimit

1. Rregullat që drejtojnë publikimin e një njoftimi për konkursin e projektimit janë të njëjta me rregullat e parashtruara në nenin 42 të këtij ligji që e drejtojnë publikimin e njoftimeve të kontratës për kontratat që e kanë vlerën e njëjtë me konkursin përkatës të projektimit.
2. Rregullat që drejtojnë dërgimin dhe publikimin e një njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit janë të njëjta me rregullat e parashtruara në nenin 42 të këtij ligji që drejtojnë dërgimin dhe publikimin e njoftimit për dhënien e kontratës, për kontratat që e kanë vlerën e njëjtë me konkursin përkatës të projektimit.
3. Përveç për njoftimet mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i janë dërguar një pjesëmarrësi nga autoriteti kontraktues, asnjë njoftim dhe asnjë informacion në një njoftim, nuk mund të bëhen publike ose të zbulohen para një personi ose ndërmarrjeje, para publikimit të tij në përputhshmëri me këtë nen.

Neni 78 Njoftimi mbi Rezultatet e Konkursit të Projektimit

Autoriteti kontraktues që ka mbajtur konkursin e projektimit, duhet që brenda dy (2) ditëve të punës pas përfundimit të konkursit të përgatisë një njoftim lidhur me rezultatet e konkursit të projektimit në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i dorëzojë KRPP-së versionet në të gjitha gjuhët e njoftimit në fjalë.

Neni 79 Mjetet e komunikimit

1. I tërë komunikimi dhe këmbimi i informacioneve i përmendur në këtë Pjesë mund të kryhet përmes letrës, faksit ose mjeteve elektronike, varësisht sipas zgjidhjes së autoritetit kontraktues.
2. Komunikimi dhe këmbimi i informacioneve të përfshira në kuadër të kësaj Pjese do të bëhet në mënyrën me të cilën sigurohet mbrojtja e tërësisë dhe sekretit të të gjitha informacioneve të dorëzuara nga pjesëmarrësit, dhe mundësinë që autoriteti kontraktues të mund të studiojë përmbajtjen e të gjitha planeve ose projekteve pas skadimit të afateve të caktuara për pranimin e tyre.
3. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që njoftimi për konkursin e projektimit dhe rregullat e specifikuar në paragrafin 1. të nenit 73 të cekin se, nëse planet ose projektet paraqiten përmes mjeteve elektronike, dërguesi është i detyruar që t'i paraqes autoritetit kontraktues origjinalin fizik - ose, kur është e përshtatshme kopje të të gjitha dokumenteve, certifikatave, dëshmimeve dhe deklaratave që kërkohen nga autoriteti kontraktues jo më vonë se në afatin e caktuar për pranimin e planeve ose projekteve.

Neni 80 Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

1. Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.
2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.
3. Kriteret për shpërblim të cilat përdoren për konkurs projektimi janë obliguese vetëm me kriteret matëse dhe peshat të paraqiten në aspekte monetare kurdo që është e mundur dhe nuk kufizohen me kriteret e përmendura në paragrafin 3. të nenit 52, pasi që edhe kriteret që ndërlidhen me vlera artistike mund të merren parasysh. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen.
4. Asnjë person jashtë jurisë nuk mund të ndikojë ose të tentojë të ndikojë në vendimet e jurisë ose në opinionin e cilitdo nga anëtarët e jurisë.
5. Personave që nuk janë anëtarë të jurisë do t'u zbulohet vetëm vendimi i jurisë. Diskutimet e jurisë dhe opinionet e anëtarëve të jurisë gjatë diskutimeve të tilla do të mbahen si sekret nga të gjithë anëtarët e jurisë. Asnjëri nga anëtarët e jurisë nuk do të zbulojë përmbajtjen e diskutimeve të jurisë para një personi tjetër që nuk është anëtar i jurisë, përveç kur kërkohet nga një urdhër me shkrim nga KRPP-ja, OSHP, ose një gjykatë kompetente.

PJESA IV

Neni 81 Aktivitetet e Menaxhimit të Kontratës

1. Autoritetet kontraktuese duhet që si pjesë e përgatitjes së aktivitetit të prokurimit:
 - 1.1. të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet e

aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratave duke përfshirë në bazë të rrethanave: (i) ekipet e menaxhimit të projekteve; (ii) rishikime të shpeshta të kontratës; (iii) protokollet për dorëzimin e pajisjeve të autorizuar; (iv) dialogun e rregullt me kontraktuesit; (v) përdorimin e standardeve korrekte të cilësisë; (vi) menaxhimit të pagesave / kërkesave; (vii) procedurat e ankesave; (viii) mjetet e kontrollit të specifikuar në kontratë, dhe (ix) sigurimi i ekzekutimit mbahet për defekte / korrigjim dhe

- 1.2. përcakton procedurat për këto në vijim sa herë që është e nevojshme: (i) inspektimin e vendit të punimeve, materialeve dhe të objekteve të prodhimit; (ii) sigurimin e dorëzimit efektiv, ruajtjen dhe sigurinë e artikujve të përfshira në kontratë; (iii) caktimi i afatit të dorëzimit; (iv) variacionet / ndryshimet.
2. Plani i menaxhimit duhet të jetë i rënë dakord midis palëve të kontratës dhe të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës. KRPP-ja është e autorizuar të nxjerrë një formular standard për planin e menaxhimit të kontratës dhe rregullat e më tejme që detajojnë dhe plotësojnë temat e përmendura më sipër në lidhje me menaxhimin e kontratave.
3. Plani i menaxhimit të kontratave duhet të paktën të përfshijë: (i) emrin e zyrtarit/zyrtarëve të autoritetit kontraktues përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe ku është e aplikueshme, rezidentin e kualifikuar për mbikëqyrje apo inxhinierin / inxhinierët e projektit; (ii) numri dhe kategoritë e personelit ndihmës në dispozicion të zyrtarit për qëllime të menaxhimit të kontratave, duke përfshirë ekspertë teknik të jashtëm të rekrutuar; (iii) një afat kohor ose një plan projekt gantogram (ganat charts), diagrame për aktivitetet e menaxhimit të kontratave që përfshijnë kohëzgjatjen e kontratës. KRPP-ja monitoron menaxhimin e kontratës.

PJESA V

AKTIVITETET E PROKURIMIT TË OPERATORËVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Neni 82

Fushëveprimi

1. Nenet 83-85 të këtij ligji mund të përdoren vetëm nga Operatorët e Shërbimeve Publike dhe jo nga autoritetet tjera kontraktuese. Operatorët e Shërbimeve Publike mund të përdorin këto dispozita gjatë dhënies së kontratave të cilat janë në mbështetje të aktiviteteve të shërbimit publik.
2. Një Operatorë i Shërbimeve Publike i angazhuar në një aktivitet të shërbimeve publike të theksuar në nenin 4.1.49 (i) të këtij ligji, mund të bëjë prokurimin e energjisë elektrike për rrjetin e tyre pa përfillur dispozitat në Pjesën II të këtij ligji.

Neni 83

Ftesa për tender me anë të Njoftimit Paraprak

1. Njoftimet për kontratë që ftojnë pjesëmarrësit në procedura të kufizuar ose në procedurakonkurruese me negociata mund të zëvendësohen me një Njoftim Paraprak. Njoftimi Paraprak duhet që në çdo rast: (a) ti referohet në mënyrë specifike furnizimeve, punëve ose shërbimeve që do të jenë subjekt i kontratës që do të shpërblehet, (b) të tregojë që kontrata do të jepet në një tender që përfshinë vetëm operatorët ekonomik të ftuar.
2. Operatorët e Shërbimeve Publike rrjedhimisht do të ftojnë të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, së paku Brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas datës së publikimit të Njoftimit Paraprak sipas paragrafit 1. të këtij neni, të konfirmojnë interesimin e tyre në bazë të informacioneve të detajuara në kontratën përkatëse para fillimit të

përzgjedhjes së tenderuesve ose pjesëmarrësve në negociata.

3. KRPP nxjerr rregullat në lidhje me formatin dhe përmbajtjen e Njoftimit Paraprak në raste kur përdoret sipas paragrafit 1. të këtij neni si dhe informatat e kërkuara në ftesë sipas paragrafit 2. të këtij neni.

Neni 84 **Sistemi i Kualifikimit**

1. Njoftimet për kontratë dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve sipas nenit 56 të këtij ligji mundet që në raste të procedurave të cekura në paragrafin 1. të neni 83 të këtij ligji të zëvendësohet me një njoftim sipas paragrafit 2. të këtij neni në lidhje me sistemin e kualifikimit. Ftesat për tenderë duhet që në ato raste të bëhen vetëm për operatorët ekonomik të përfshirë të kualifikuar në një sistem të kualifikimit.
2. Operatorët e Shërbimeve Publike që dëshirojnë të vendosin një sistem të kualifikimit duhet të publikojnë një njoftim i cili i paralajmëron operatorët ekonomik për ekzistimin e sistemit dhe i fton ata të aplikojnë për përfshirje. Një sistem i kualifikimit duhet të vendoset për një afat maksimal prej tri (3) vitesh dhe njoftimet duhet të publikohen çdo vit.
3. KRPP nxjerr rregulla në lidhje me formatin dhe përmbajtjen e Sistemit Kualifikues kur është e duhur që të përdoret sipas paragrafit 1. të këtij neni.
4. Operatorët e Shërbimeve Publike të cilat vendosin dhe praktikojnë një sistem të kualifikimit do të sigurojnë që operatorët ekonomik mund të aplikojnë në çdo kohë për tu përfshirë në sistem dhe se një numër prej së paku tre operatorë ekonomik të kualifikuar do të përfshihen në çdo kohë për të siguruar konkurrencë të mjaftueshme.
5. Operatori i Shërbimeve Publike duhet që të mbaj me shkrim të dhënat e operatorëve ekonomik të kualifikuar, mundësisht të ndara në kategori sipas llojit të kontratës për të cilën kualifikimet e tyre janë valide.

Neni 85 **Vlerësimi i Aplikantëve në Sistemin e Kualifikimit**

1. Operatorët ekonomik të cilët aplikojnë për përfshirje në sistemin e kualifikimit duhet të vlerësohen sipas kërkesave të përshtatshmërisë të përcaktuara për sistemin në përputhje me rregullat normale në nenin 56, 65-70 të këtij ligji. Një sistem kualifikues mund të përfshijë nivele të ndryshme të kërkesave të përshtatshmërisë të cilat vlejnë për lloje të ndryshme të kontratave.
2. Një grup i operatorëve ekonomik i referuar si në nenin 71 të këtij ligji mund të bazohet në kapacitetet e përbashkëta të pjesëmarrësve në grup për të përmbushur kërkesat e përcaktuara sipas paragrafit 1. të këtij neni. Marrëveshja sipas paragrafit 2. të nenit 71 të këtij ligji duhet që në atë rast të përmbajë një premtim se kapacitetet e duhura do të jenë në dispozicion të grupit gjatë tërë periudhës së validitetit të sistemit të kualifikimit.
3. Dokumentacioni në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të vihet menjëherë në dispozicion të operatorëve ekonomik pas kërkesës dhe brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e një kërkesë të tillë. Çfarëdo ndryshimi në këto kërkesa duhet të publikohet në një njoftim sipas paragrafit 2. të nenit 84 të këtij ligji dhe brenda afatit kohorë të mësipërm dokumentacioni i nevojshëm duhet të komunikohet operatorëve ekonomik me kërkesë.
4. Operatorët ekonomik që kanë aplikuar për përfshirje duhet të informohen rreth vendimit mbi aplikimin e tyre sa më shpejt të jetë e mundur. Në rast se vendimi parashikohet të merr kohë më shumë se një muaj, Operatori i Shërbimeve Publike duhet të informojë aplikantin, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e aplikimit, për arsyet që justifikojnë vonesën dhe për datën kur aplikimi i tij do të pranohet ose refuzohet. Periudha

totale nuk lejohet në asnjë rast që të tejkalojë katër muaj nga data e aplikimit.

5. Operatoret e Shërbimeve Publike të cilëve i është refuzuar aplikimi do të informohen me shkrim për arsyet për refuzim sa më shpejtë të jetë e mundur dhe brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e refuzimit. Arsyet duhet të bazohen në kërkesat e paragrafit 1. të këtij neni.
6. Operatoret e Shërbimeve Publike mund të largojnë operatorët ekonomik nga sistemi i kualifikimit vetëm në raste kur ata nuk i përmbushin më tutje kërkesat e paragrafit 1. të këtij neni. Çdo largim i planifikuar duhet të njoftojë me shkrim operatorin ekonomik paraprakisht së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës në të cilën largimi është planifikuar të ndodhë, së bashku me arsyet që justifikojnë vendimin e propozuar.

PJESA VI KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Neni 86 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

1. KRPP është agjenci e pavarur rregullatore, që do të thotë se asnjë zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim në KRPP në lidhje me ndonjë veprim ose vendim të caktuar operacional apo rregullativ të KRPP-së.
2. KRPP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. KRPP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme të ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës në të njëjtën masë sikurse autoritet e tjera publike ose organizatat buxhetore.

Neni 87 Funksionet Themelore të KRPP-së

1. KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.
2. Përveç çështjeve të parapara më lartë, eksperti i prokurimit ka përgjegjësinë dhe autorizimin që:
 - 2.1. të kryej monitorimet e aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave për qëllim të monitorimit të zbatimit të këtij ligji;
 - 2.2. tu ofroj opinione autoriteteve kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave;
 - 2.3. Të pranoj raportet nga autoritetet kontraktuese siç referohet në nenin 35, paragrafi 1 dhe nenin 61, paragrafi 5, të këtij ligji, në mënyrë që të kryej aktivitetin e parashikuar në nën-paragrafin e mëposhtëm 2.13. KRPP-ja në çdo rast mund të vendos që të kontrolloj vendimet e sipërpërmendura dhe, nëse është e nevojshme, mund të ftojë autoritetin përkatës kontraktues për të rishikuar vendimin e tij në përputhje me opinionin e lëshuar. Nëse KRPP-ja vendos që të kontrolloj vendimet e sipërpërmendura, KRPP-ja këtë duhet ta bëjë brenda dy (2) ditëve pas pranimit të raportit të tillë. Opinione të KRPP-së të lëshuara në përputhje me këtë paragraf, kanë karakter jo-detyrues për autoritetet kontraktuese, por autoritetet kompetente mund të marrin ato në konsideratë gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura në përputhje me Pjesën IX të këtij ligji.
 - 2.4. të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të këtij ligji nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilën nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të këtij ligji; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në këtë ligj si dhe çfarëdo

kërkese të detyrueshme të BE-se për prokurim;

- 2.5. të përgatisë dhe shpërndajë doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas këtij ligji në doli të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- 2.6. të përforcojë vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij;
- 2.7. t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- 2.8. të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
- 2.9. të krijojë dhe të mirëmbajë një Regjistër elektronik të Prokurimit Publik që shërben si vend për ruajtjen e kopjeve elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara ose të nxjerra në lidhje me çdo aktivitet prokurimi të kryer ose të iniciuar nga një autoritet kontraktues;
- 2.10 të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese, duke përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që duhet të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese subjekte të këtij ligji;
- 2.11 të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna;
- 2.12 për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të marsit të vitit vijues kalendarik;
- 2.13 të krijojë dhe mirëmbajë një webfaqe informative në internet që i ofron publikut qasje të pa kufizuar në (i) këtë ligj dhe gjithë legjislacionin sekondar të nxjerrë sipas këtij ligji, (ii) interpretimet dhe dokumentet e përcaktuara në këtë nen dhe (iii) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik;
- 2.14 të zhvillojë një webfaqe dhe një sistem elektronik informativ në mbarë Kosovën për të përmirësuar publikimin e njoftimeve të kërkuara nga ky ligj;
- 2.15 të mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik, ankandit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik;
- 2.16 të përgatisë dhe mbajë një listë të autoriteteve kontraktuese që i identifikon të gjitha entitetet që janë subjekt i këtij ligji, me kusht që nëse KRPP-ja nuk e përfshin një entitet në këtë listë, kjo (mos-përfshirja) të mos vendosë çështjes se nëse entiteti është jo autoritet kontraktues në kuptim të këtij ligji; dhe
- 2.17 të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.
- 2.18 të zhvilloj dhe implementoj rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese.

Funksionet e Vëzhgimit dhe të Mbikëqyrjes të KRPP-së

1. KRPP ka gjithashtu autoritetin dhe përgjegjësinë të vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të nxjerra nga KRPP sipas autorizimit të këtij ligji.
2. Për këtë qëllim, **eksperti i prokurimit** përgatit dhe zbaton një metodologji dhe mekanizëm të përshtatshëm raportimi të mbështetur nga një sistem elektronik i menaxhimit të informacionit që i mundëson asaj (i) të vëzhgojë zbatimin e këtij ligji; (ii) të përgatisë raporte mbi rezultatet dhe zbatimin që identifikojnë përparësitë dhe dobësitë në zbatimin e këtij ligji ose sistemit të prokurimit; (iii) të identifikojë ato fusha që kanë nevojë të përmirësohen dhe zhvillohen, (iv) të përgatisë raportet vjetore që kërkohen nga ky ligj në mënyrë që të japin një vlerësim të përgjithshëm por të saktë të gjendjes së sistemit kombëtar të prokurimit si dhe vlerësime të veçanta të shkallës së përputhjes/mospërputhjes nga autoritetet individuale kontraktuese; dhe(v) të bëjë rekomandimet e duhura për ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit.

Neni 89

Emërimi i Anëtarëve

1. Bordi i KRPP-së përbëhet prej tre (3) anëtarëve. Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat prej 5 (pesë) vjeçar pa të drejtë riemërimi. Bordi i KRPP-së i emëruar nën miratimin e mëhershëm do të mbajnë mandatin deri në skadimin e atij emërimi, dhe në çdo rast, deri sa të zgjidhen anëtarët e ri nga Kuvendi.
2. Kryetari dhe anëtarët e KRPP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi. Gjatë propozimit të personave në fjalë, Qeveria duhet të respektojë kërkesat për anëtarësim, të specifikuara në paragrafin 3. dhe 4. të këtij neni.
3. Asnjë person nuk mund të propozohet, emërohet ose të shërbejë si anëtar i KRPP-së nëse ai/ajo nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit për ndonjë arsye të ndonjë dispozite të listuar në paragrafin 3. të nenit 65 të këtij ligji. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojë që asnjë person i tillë të mos propozohet ose emërohet për anëtar në KRPP.
4. Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që çdo person i propozuar për anëtar të KRPP-së, të përmbushë kushtet si në vijim:
 - 4.1 të ketë diplomë universitare;
 - 4.2 së paku pesë (5)vjet përvojë në fushën e financave publike dhe në fushën e prokurimit.

Neni 90

Organizimi dhe Votimi në KRPP

1. Kryetari përfaqëson, udhëheq dhe organizon punën e KRPP-së.
2. Kryetari ka të drejtë që të caktoj një anëtar për të organizuar dhe udhëhequr punën e KRPP-së në një fushë të caktuar.
3. Kryetari do të thërras mbledhjet e KRPP-së kur ai e konsideron të nevojshme ose kur një gjë e tillë kërkohet nga dy (2) anëtarë të tjerë të KRPP-së.
4. KRPP do të bëjë çdo përpjekje për të marrë vendimet në takime me konsensus. Në rast që kryesuesi i takimit konstaton që konsensusi nuk mund të arrihet, çështja duhet të parashtrahet për votim. Vendimet duhet të kenë përkrahjen e mazhorancës së anëtarëve.
5. Kryetari do të kryesojë mbledhjet e KRPP-së. Në raste të caktuara, kur është e nevojshme

që KRPP të mbaj takimin në mungesë të Kryetarit, Kryetari do të autorizojë njërin nga anëtarët tjerë të KRPP-së për ta kryesuar takimin.

6. KRPP-ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të nxjerrë rregulla procedurale shtesë për të udhëhequr aktivitetet e saj. KRPP-ja do t'i sigurojë një kopje të rregullave të tilla çdo personi që i kërkon ato.

Neni 91

Masat zbatuese

1. Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj sipas paragrafit 2. të nenit 87 të këtij ligji, **eksperti i prokurimit** është përgjegjës për përgatitjen dhe shpalljen e masave të hollësishme zbatuese të përshkruara në këtë ligj. Masat zbatuese përbëhen nga rregulla, udhëzime, direktiva, dokumente dhe formularë standard të tenderit dhe kontratës si dhe dokumente dhe formularë të tjerë që autoritetet kontraktuese, zyrtarët e prokurimit, ndërmarrjet dhe personat duhet ti respektojnë, përdorin dhe/ose marrin parasysh gjatë ekzekutimit ose pjesëmarrjes në aktivitetet e prokurimit të rregulluara me këtë ligj.
2. **Eksperti i prokurimit** gjithashtu do të hartojë një kod etik të prokurimit që duhet të respektohet nga të gjithë nëpunësit publik, nëpunësit civil dhe personat e tjerë të punësuar nga autoritetet kontraktuese. Ky kod etik në minimum duhet të përfshijë një përmbledhje të qartë të rregullave të detyrueshme mbi shmangien e konflikteve të interesave.
3. Për të ndihmuar punën e saj gjatë formulimit të masave zbatuese, **eksperti i prokurimit** merr sa më shumë mendime të atyre që janë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit në Kosovë. Për këtë arsye, do të shqyrtoj rregullisht komentet dhe qëndrimet me shkrim të Drejtorit të AQP-së, Drejtorit të Thesarit; zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese (duke përfshirë dhe operatorët e shërbimeve publike) dhe organizatave që përfaqësojnë operatorët ekonomikë.
4. Nëse një person ose autoritet kontraktues beson se KRPP ka marrë një vendim, ka nxjerrë një rregull të prokurimit publik ose interpretim që nuk është i autorizuar ose në përputhje me një ose më shumë dispozita të këtij ligji, personi ose autoriteti kontraktues në fjalë mund ta kundërshtojë vendimin, rregullin, ose interpretimin përmes dorëzimit të padisë në gjykatën kompetente në pajtim me rregullat e zakonshme për shqyrtimin gjyqësor të vendimeve administrative.

Neni 92

Fshehtësia

KRPP mund të mbrojë nga përhapja në publik ose persona të paautorizuar, informacionet e përgatitura ose marra prej KRPP-së gjatë kryerjes së detyrave të veta, por vetëm në masën e lejuar nga ky ligj edhe Ligji për Qasjen në Dokumentet Publike. Pavarësisht nga sa më sipër, KRPP i ofron qasje dhe kopje të çdo informacioni dhe dokumenti që ka në posedim ose kontroll, duke përfshirë informacionin dhe dokumentet e fshehta, nga Auditori i Përgjithshëm, OSHP-së dhe/ose ndonjë panel shqyrtues menjëherë pas kërkesës apo urdhrit të ndonjërit prej tyre. KRPP

i ofron po ashtu qasje dhe kopje të informacioneve dhe dokumenteve të tilla një gjykatë kompetente nëse kjo qasje ose këto kopje kërkojnë me një urdhër të nxjerrë nga kjo gjykatë.

Neni 93

Pezullimi dhe suspendimi i anëtarëve të KRPP-së

1. Nëse një anëtar i KRPP-së i nënshtrohet një procedure gjyqësore në të cilën akuzohet për vepër penale apo nëse ka kryer ndonjë vepër që bie ndesh me etikën profesionale dhe profesionalizimin lidhur me detyrat profesionale largohet apo suspendohet.
2. Procedura e largimit dhe suspendimit të anëtarëve të KRPP-së është e njëjtë me procedurat e emërimit të tyre.

PJESA VII
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

Neni 94
Agjencia Qendrore e Prokurimit

1. Në bazë të këtij ligji në Ministrinë përkatëse për Financa themelohet Agjencia Qendrore e Prokurimit ("AQP"). AQP do të zbatojë dhe të kryej funksione dhe përgjegjësi të specifikuara në këtë ligj.
2. AQP-ja për çdo vit kalendarik përgatitë dhe i dorëzon ministrit të Financave një raport vjetor, që pasqyron aktivitetet e prokurimit publik të udhëhequra nga AQP-ja për atë vit kalendarik. Ky raport dorëzohet jo më vonë se në fund të muajit shkurt të vitit vijues kalendarik.

Neni 95
Aktivitetet e Prokurimit të AQP

1. Për shkaqe të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efijencës ose çështjeve të tjera legjitime, Ministri i Financave ka autoritetin për ta përcaktuar AQP-në si autoritetin kontraktues përgjegjës për kryerjen e atij aktiviteti prokurimi. Në një rast të tillë (i) AQP njofton autoritetin përkatës kontraktues ose autoritetet, të cilat nuk janë më të autorizuar të kryejnë prokurimin në fjalë, dhe (ii) AQP, për të gjitha qëllimet e ligjit aktual, do të konsiderohet "autoriteti kontraktues" për aktivitetin në fjalë të prokurimit.
2. Qeveria sipas propozimit të Ministrisë së Financave do të themeloj brenda dates 31 janar të çdo viti një listë të mallrave ose të artikujve, punëve ose shërbimeve të përdorimit të përbashkët, që do të shpërblehen nga AQP-ja duke përdorur marrëveshjet kornizë. Kjo listë miratohet në formën e një Udhëzimi Administrativ. Kjo listë dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohen në media dhe të shpallen në faqen e internetit të KRPP-së, të përcaktuar në nën-paragrafin 2.10 të paragrafit 2 të nenit 87 të këtij ligji.
3. Në rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm, një autoritet kontraktues porositi AQP-në për mallrat, punët ose shërbimet e prokuruar nga AQP-ja siç referohet në paragrafin 2. Për këta artikuj, pune apo shërbime autoriteti kontraktues nuk do të udhëheq ndonjë aktivitet të pavarur të prokurimit. Çdo kontratë e lidhur në shkelje të këtij paragrafi do të deklarohet si e pavlefshme.
4. Bazuar në një arsyetim adekuat, një autoritet kontraktues mund ti kërkojë AQP-së kryerjen e një aktiviteti prokurimi në emër të tij. Ministri i Financave, pas shqyrtimit të këtij arsyetimi nga autoriteti kontraktues, mund ti lejojë AQP-së të kryejë atë aktivitet prokurimi. Autoriteti kontraktues gjithashtu mund të kërkojë nga AQP-ja që ekspertët e AQP-së të ndihmojnë autoritetet kontraktuese për kryerjen e aktivitetit të prokurimit të cilat kryhen nga vet Autoriteti Kontraktues.

Neni 96
Emërimi, Largimi dhe Pezullimi i Drejtorit të AQP-së

1. AQP do të administrohet nga një drejtor i emëruar për një periudhë tre (3) vjeçare.
2. Drejtori i AQP do të emërohet në pajtim me procedurën e përcaktuar në ligjin për shërbimin civil për emërim në pozita të larta drejtuese.
3. Drejtori do të ketë pozicion të barasvlershëm me Sekretarët e Përgjithshëm dhe do të nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me nëpunësit civilë në pozita të

larta drejtuese.

4. Asnjë person nuk mund të propozohet, emërohet ose shërbejë si Drejtor i AQP-së nëse ai nuk mund të marrë pjesë në një aktivitet prokurimi për shkak të ndonjërës nga dispozitat e paragrafit 3. të nenit 65 të këtij ligji.
5. Drejtori duhet të përmbushë njërin nga kriteret në vijim: ai të jetë jurist, ekonomist ose profesionist tjetër me diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme në prokurim.

Neni 97 Fshehtësia

AQP mund të mbrojë nga përhapja në publik ose persona të paaautorizuar, informacionet e përgatitura ose marra prej AQP-së gjatë kryerjes së detyrave të veta, por vetëm në masën e lejuar nga ky ligj edhe Ligji për Qasjen në Dokumentet Publike. Pavarësisht nga sa më sipër, AQP i ofron qasje dhe kopje të çdo informacioni dhe dokumenti që ka në posedim ose kontroll, duke përfshirë informacionin dhe dokumentet e fshehta, Auditorit të Përgjithshëm, KRPP, dhe/ose OSHP menjëherë pas kërkesës apo urdhrit të ndonjërit prej tyre. AQP i ofron po ashtu qasje dhe kopje të informacioneve dhe dokumenteve të tilla një gjykate kompetente nëse kjo qasje ose këto kopje kërkohen me një urdhër të nxjerrë nga kjo gjykatë.

PJESA VIII ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Neni 98 Organi Shqyrtues i Prokurimit

1. OSHP-ja është organ i pavarur shqyrtues dhe ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj.
2. OSHP do të jetë organ i pavarur për shqyrtim administrativ. OSHP-ja përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Bordit. Për mbështetje administrative OSHP-së i ndihmon Sekretariati i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit. Asnjë person ose zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim politik ose ndikim të paligjshëm në OSHP apo ndonjë punonjësi të tij për ndonjë vendim. Ndikimi nuk do të konsiderohet politik apo i paligjshëm nëse shfaqet në mënyrë të hapur, në pajtim me rregullat e ligjit dhe procedurave, dhe në besim të plotë se haptas avancohet ankesën ose mbrojtjen.
3. OSHP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. OSHP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme, ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës, në masë të njëjtë sikurse autoritetet e tjera publike dhe organizatat buxhetore.

Neni 99 Funksionet dhe Kompetencat e OSHP

1. OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë Pjesë.
2. Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga

pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

3. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative.

Neni 100

Emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të OSHP-së

1. Bordi i OSHP-së përbëhet nga pesë (5) anëtarë që emërohen për një mandat pesë (5) vjeçar pa të drejtë riemërimi.
2. Qeveria i propozon Kuvendit së paku dy kandidatë për pozitën e lirë të kryetarit të OSHP-së dhe së paku dy kandidatë për secilën pozitë të lirë të anëtarëve të OSHP-së, të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë para skadimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve aktualë. Kuvendi emëron kryetarin dhe secilin anëtarë të OSHP-së, bazuar në rekomandimin e dhënë nga një organ përzgjedhës i pavarur. Organi përzgjedhës i pavarur interviston, vlerëson dhe klasifikon me pikë kandidatët bazuar në meritë. Kuvendi emëron kandidatët me pikët më të larta për pozitën e kryetarit dhe për secilën pozitë të lirë të anëtarëve të OSHP-së. Në çdo rast, organi përzgjedhës i pavarur ia dorëzon Kuvendit listën e plotë të kandidatëve të vlerësuar.
3. Organi përzgjedhës i pavarur, sipas paragrafit 2 të këtij neni, themelohet nga Kuvendi dhe përbëhet prej tre gjyqtarëve të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
4. Çdo kandidatë që propozohet për kryetar ose anëtar të OSHP-së, duhet të ketë kualifikimet dhe plotësojë kriteret vijuese:
 - 4.1. të jetë shtetas i Kosovës;
 - 4.2. të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale ose të mos jetë i akuzuar për ndonjë vepër penale;
 - 4.3. të ketë të përfunduar provimin e jurisprudencës;
 - 4.4. të ketë së paku 3 (tre) vjet përvojë profesionale në njërin nga këto fusha: drejtësi, administratë publike, financa publike ose prokurim;
 - 4.5. të ketë aftësi për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, me vendosmëri dhe përgjegjshmëri.

Neni 101

Suspendimi, largimi dhe shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të OSHP-së

1. Nëse ndaj kryetarit apo një anëtarit të OSHP-së ngritët aktakuzë për vepër penale, ai/ajo suspendohet me pagesë prej 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës së tij/ saj, deri në largimin e tij/saj ose derisa të shpallet i pafajshëm me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës. Suspendimi hyn në fuqi që nga momentin i ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit.
2. Gjykata kompetente në ditën e ngritjes së aktakuzës ndaj kryetarit apo ndonjë anëtarit të OSHP-së e dërgon njoftimin tek Kryetari i Kuvendit, i cili në emër të Kuvendit si institucion që e ka emëruar, e njofton OSHP-në për suspendimin e kryetarit apo anëtarit të tij.

3. Kryetari ose anëtari i OSHP-së largohet nga detyra nëse ai/ajo shpallet fajtor për ndonjë vepër penale me anë të aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës. Ky largim hyn në fuqi që nga momenti i shqiptimit të aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës, me të cilin aktgjykim njoftohet kryetari i Kuvendit, i cili në emër të Kuvendit, si institucion që e ka emëruar, e njofton OSHP-në për largimin e kryetarit apo anëtarit të tij.
4. Përveç siç është paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, Qeveria i propozon Kuvendit, shkarkimin e kryetarit apo një anëtari të OSHP-së, nëse ai/ajo vepron në kundërshtim me etikën profesionale që ndërlidhet me detyrat e tij/saj.

Neni 102

Organizimi i OSHP

1. Kryetari përfaqëson, menaxhon dhe organizon punën e OSHP-së; dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e administrimit të përditshëm dhe veprimtarisë së OSHP-së.
2. Kryetari është i autorizuar të caktojë një anëtar për të organizuar dhe drejtuar punën e OSHP në një fushë të veçantë.
3. Në rast se kryetari mungon për shkaqe shëndetësore apo për shkaqe të tjera, kompetencat e dhe funksionet e tij ushtrohen nga anëtari me i vjetër i OSHP-se.

PJESA IX

PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PROKURIMIT

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 103

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj pjese përcaktohen të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 104

Parimet themelore

1. Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë. Çdo procedurë e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat në fuqi të Pjesës IX.
2. Zbatimi i ndonjë procedure të shqyrtimit dhe asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.
3. Të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike sipas kësaj Pjese.
4. Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, (ii) të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe (iii) të marrë për bazë

pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

KREU II

Neni 105 Kompetencat e OSHP-së

1. OSHP mund të përcaktojë se ankesat do të shqyrtohen nga një panel shqyrtues nën OSHP sipas nenit 106 të këtij neni të këtij ligji.
2. OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë Pjesë IX që:
 - 2.1. të shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji;
 - 2.2. të hetojnë dhe të përcaktojnë faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla;
 - 2.3. t'i japin urdhër çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar nga një person, ndërmarrje ose autoritet i tillë që të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente (përveç këshillave të privileguara juridike), dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshëm të diskrecionit të vet, i konsideron të rëndësishme për zbatimin e hetimeve ose të procedurave për shqyrtimin e prokurimit.
 - 2.4. të nxjerrin një urdhër ndaj çdo personi për tu paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të japë dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshëm të diskrecionit të tij, i konsideron relevante lidhur me lëndën e kësaj procedure;
 - 2.5. të marrin çfarëdo masë tjetër të nevojshme dhe të përshtatshme për të verifikuar argumentet apo pretendimet të bëra nga palët;
 - 2.6. nëse kontrata përkatëse nuk është nënshkruar ende ligjërisht nga të dy palët, dhe deri më tani të lejuar nga ky ligj, të japin urdhër me të cilën mënjanohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike ose rezultati i një konkursi të projektimit;
 - 2.7. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga ky ligj, duke e detyruar autoritetin e tillë që të suspendojë ose përfundoj zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose zbatimin e vendimit të autoritetit të tillë lidhur me ose gjatë aktivitetit në fjalë;
 - 2.8. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga ky ligj, duke e detyruar autoritetin e tillë që të anuloj ose revokoj vendimin e autoritetit të tillë lidhur me - ose të marrë gjatë aktivitetit të prokurimit, përfshirë kushtet e paligjshme dhe specifikat në dosjen e tenderit;
 - 2.9. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të ia paguaj kompensimin parashtruesit të ankesës;
 - 2.10. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejshëm të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale tjetër të interesuar;

- 2.11. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues që të mënjanojë specifikimet diskriminuese teknike, ekonomike, financiare ose të përzgjedhjes, kërkesat ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit; dhe
- 2.12. të lëshojnë një urdhër me të cilin detyrohen zyrtarët për zbatimin e ligjit që të ndihmojnë OSHP-në në ekzekutimin e një urdhri të OSHP-së .
- 2.13. të lëshojnë një urdhër i cili e shndërron një kontratë të konkluduar dhe të nënshkruar infektive, nëse kontrata është konkluduar pa publikim të njoftimit sipas nenit 42, ose nëse nënshkrimi i kontratës është kryer para skadimit të afatit kohor të përcaktuar në nën-paragrafin 4.1 paragrafi 4. të nenit 26 i këtij ligji.
- 2.14. imponoj gjyba, nëse autoriteti kontraktues, përkundër vendimit të cekur nën nën-paragrafin 2.13. të këtij neni, vazhdon të vëzhgojë apo të impelmentoj kontratën e cila është temë e atij vendimi; dhe
- 2.15. kompetenca tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet përkatëse.
- 2.16. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Neni 106

Themelimi dhe përbërja e paneleve shqyrtuese

OSHP organizon punën e saj në një numër të paneleve shqyrtuese. Varësisht nga vlera apo madhësia e kontratës së propozuar apo bazuar në vështirësinë ose rëndësinë e çështjes së ngritur nga ky rast, OSHP është përgjegjëse për nxjerrjen e rregullave të brendshme në lidhje me emërimin e anëtarëve për një panel shqyrtues, të cilat nënshkruhen nga Kryetari i OSHP-së. Paneli shqyrtues mund të përbëhet nga një, tre ose pesë anëtarë.

Neni 107

Rregullorja e procedurave të OSHP-së

OSHP do të vendosë rregulloren e punës për të udhëhequr ushtrimin e procedurave të shqyrtimit. Rregullorja e punës që përmendet më lartë duhet të jetë në përputhshmëri me këtë ligj, veçanërisht me dispozitat e kësaj Pjese IX. Rregullat e tilla do të vendosin procedura për të siguruar sidomos: (i) të drejtën e palëve për tu dëgjuar, përfshirë të drejtën për parashtresë me shkrim; (ii) të drejtën e palëve për të informuar përreth argumenteve dhe supozimeve të bëra nga pala tjetër dhe për t'ju përgjigjur argumenteve dhe supozimeve të tilla; (iii) të drejtën e palëve për përfaqësim ligjorë; (iv) të drejtën e palëve për të dorëzuar dëshmitë dhe argumentet në dëgjimin para OSHP-së, përfshirë provat dhe marrjen e dëshmitarëve në pyetje; (v) e drejta e palëve për të kërkuar emërimin e dëshmitarëve teknik; Kryetari është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e përpilimit (hartimit) të kësaj rregulloreje. OSHP duhet të publikojë rregulloren e punës në faqen e saj informative të internetit si dhe ti sigurojë çdo personi që kërkon një kopje të rregullores së punës.

Neni 108

Konfidencialiteti

OSHP mund të mbrojë nga përhapja në publik ose persona të paautorizuar, informacionet e përgatitura ose të pranuar nga OSHP gjatë kryerjes së detyrave të veta, por vetëm në masën e lejuar nga ky ligj edhe Ligji për Qasjen në Dokumentet Publike. Pavarësisht nga ky obligim, OSHP i ofron qasje dhe kopje të çdo informacioni dhe shënimi që ka në posedim ose kontroll, duke përfshirë informacionin dhe shënimet e fshehta, Auditorit të Përgjithshëm ose një gjykatë kompetente menjëherë pas urdhrit të lëshuar nga Auditori i Përgjithshëm apo një gjykatë e tillë.

Neni 108/A

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliken me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.
2. Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.
3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:
 - 3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;
 - 3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.
 - 3.3 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.
4. Aplikimet për rishqyrtim duhet të paraqiten me shkrim dhe duhet të përmbajnë të njëjtin informacion dhe dokumente të përcaktuara në nenin 111 paragrafi 1 të këtij ligji, me përjashtim të nën-paragrafit 1.9 dhe 1.10.
5. Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësoj kërkesën e tij Brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohet si e paplotë.
6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.
7. Kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ankuesi mund të paraqesë një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.
8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:
 - 8.1. kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;
 - 8.2. ankesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në paragrafin 1 të këtij neni;
 - 8.3. ankesa nuk përputhet me kërkesat e përmendura në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni;

- 8.4. autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.
9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.
10. Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:
- 10.1. të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabaza;
- 10.2. të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;
11. Vendimet e parashikuara në këtë pjesë janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe duhet të zbatohen menjëherë.
12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe të komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.
13. Pavarësisht nga paragrafi 3 i këtij neni, miratimi i një refuzimi apo vendimi në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni përfshin pezullimin e menjëhershëm të masave të miratuara sipas paragrafit 2 të këtij neni.
14. Kundër refuzimeve të miratuara sipas nën-paragrafëve 1, 2 dhe 3 të paragrafit 8 dhe vendimeve të marra sipas nën-paragrafëve 1 dhe 2 të paragrafit 10 të këtij neni, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar, nëse ka, mund të paraqesë, në çdo rast, një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.

KREU III

FILLIMI DHE ZBATIMI FILLESTAR I PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Neni 109

Afatet për Dorëzimin e Ankesës

1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrtojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.
2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Neni 110

Autoriteti për të ndjekur ankesat

Në rast të tërheqjes së ankesave të parashtruara sipas Pjesës IX të këtij ligji OSHP ka autoritetin për të vazhduar në emër të vet shqyrtimin e supozimeve (në mënyrë direkt apo indirekte) të paraqitura në një ankesë të tillë.

Neni 111

Arkivimi dhe Përmbajtja Thelbësore e Ankesës

1. Çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP; sidoqoftë, OSHP do të marrë masa vetëm nëse ankesa e tillë:
 - 1.1 përmban emrin, adresën dhe informatat kontaktuese të parashtruesit të ankesës;
 - 1.2 përmban emrin e autoritetit përkatës kontraktues;
 - 1.3 përmban një përshkrimin specifik të arsyeshëm të aktiviteteve përkatëse të prokurimit;
 - 1.4 e ka të bashkangjitur një kopje të njoftimit për dhënien e kontratës ose të njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, nëse diç e tillë është nxjerrë ose publikuar.
 - 1.5 vërteton se parashtruesi i ankesës kualifikohet si “palë e interesuar” siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji;
 - 1.6 përshkruan rrethanat faktike që përbëjnë ose që ngrisin supozimin për shkeljen e këtij ligji;
 - 1.7 specifikon dispozitën ose dispozitat e këtij ligji që supozohet të jenë shkelur; dhe;
 - 1.8 përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës në raste kur ankuesi përfshin pretendimin për kompensim.
 - 1.9 e ka të bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A; dhe
 - 1.10 siguron dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.
2. Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës në fjalë, do të ia dërgojë OSHP-së dhe njëkohësisht do të ia dërgojë, në mënyrën e njëjtë, apo përmes postës së rregullt, një kopje edhe autoritetit kontraktues.
3. OSHP, pas pranimit të ankesës, menjëherë do ta shqyrtojë atë për t'u siguruar që ajo i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP duhet të përfundojë shqyrtimin e ankesës brenda një (1) dite pas pranimit të ankesës.
4. Nëse OSHP konstaton se ankesa nuk i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP menjëherë do të informojë parashtruesin e ankesës me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, mbi karakterin e të metat që janë gjetur. Nëse afati për parashtrimin e ankesës ka skaduar ose skadon për më pak se katër (4) ditë, parashtruesi i ankesës do të ketë në dispozicion katër (4) ditë pas marrjes së njoftimit të tillë për të korrigjuar të metat e tilla dhe për të ri-parashtruar ankesën. Nëse afati për parashtrimin e ankesës akoma nuk ka skaduar dhe nuk skadon për më pak se dy (2) ditë, parashtruesi i kërkesës mund të ri-parashtrtojë kërkesën në çdo kohë para skadimit të afatit për parashtrim.
5. Nëse OSHP konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP menjëherë do të (i) caktojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 113 dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t'i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë.

Neni 112

Efekti pezullues i ankesave

1. Përveç nëse paneli përkatës shqyrtues nxjerr një vendim tjetër me shkrim dhe përderisa ta nxjerrë këtë vendim, dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin kontraktues që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni të këtij ligji, nëse kërkohet nga autoriteti kontraktues, Kryetari i OSHP mund të nxjerrë urdhër për heqjen e obligimit për pezullimin automatik të aktivitetit të prokurimit nëse duke marrë parasysh pasojat e mundshme negative që mund të ketë pezullimi në të gjitha interesat që mund të dëmtohen duke përfshirë interesin publik dhe interesat e ankuesit, Kryetari vendos se pasojat negative që mund të ketë pezullimi i tejkalojnë përfitimet e mundshme. Para se të marrë çfarëdo veprimi mbi kërkesën e autoritetit kontraktues, ankuesit do t'i jepet mundësia që t'i dorëzojë argumente me shkrim Kryetarit të OSHP-së lidhur me atë se pse pezullimi nuk duhet të hiqet. Kryetari do të njoftojë ankuesin dhe autoritetin përkatës me shkrim për vendimin e tij.
3. Vendimi për heqjen e obligimit për pezullim të aktivitetit të prokurimit nuk e paragjykon dhe nuk ndikon në mënyrë negative në ankesën ose në ankuesin.

Neni 113

Shqyrtimi fillestar nga ekspertit shqyrtues

1. OSHP menjëherë do t'i caktojë ekspertit shqyrtues, detyrën e shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë.
2. OSHP duhet të punësojë një numër të mjaftueshëm të ekspertëve për shqyrtim. Ekspertët shqyrtues, duhet të janë të paanshëm, dhe që kanë njohuri të lartë lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit, si dhe të kenë njohuri për këtë ligj.

Neni 114

Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues

1. Eksperti shqyrtues, në afat prej dhjetë (10) ditësh, menjëherë pas emërimit të tij do të: (i) shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse, (ii) intervistojë, nëse ai e sheh të arsyeshme ose të nevojshme, cilindo zyrtar, nëpunës ose këshilltar të autoritetit kontraktues ose palës ankuese, dhe (iii) pajisë panelin shqyrtues, ankuesin dhe kryesuesin e autoritetit kontraktues me një vlerësim me shkrim mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë.
2. Eksperti do të rekomandojë veprime korrigjuese e nevojshme që duhet të ndërmerren nga autoriteti kontraktues që mund të përfshijnë, sipas nevojës dhe varësisht nga rrethanat: (i) anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhënies së kontratës ose rezultati i një konkursi të projektimit (ii) zgjatjen e afatit kohor (iii) ndryshimin ose anulimin e një vendimi të autoritetit kontraktues dhe/ose (iv) marrjen e çfarëdo masave të tjera të nevojshme për të korrigjuar shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues.

Neni 115

Vendimi i autoritetit kontraktues

1. Autoriteti kontraktues, në afat prej katër (4) ditëve pas marrjes së vlerësimit të ekspertit shqyrtues të specifikuar në paragrafin 1. të nenit 114 i këtij ligji, i dërgon ekspertit shqyrtues, panelit shqyrtues dhe parashtruesit të ankesës vendimin e autoritetit kontraktues në lidhje me çështjet e parashtruara në ankesë.
2. Vendimi me shkrim që kërkohet nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të bëjë vlerësimin detal të autoritetit kontraktues mbi vlefshmërinë e secilës nga pretendimet e bëra në ankesë. Nëse vendimi bën një vlerësim mbi një pretendim, që ndryshon nga vlerësimi i dhënë nga eksperti shqyrtues, autoriteti kontraktues në vendimin e tij paraparak do të bashkëngjisë një

deklaratë me shkrim në të cilën shpjegohen arsyet e këtij ndryshimi. Nëse vendimi e refuzon një pretendim ose e mohon vlefshmërinë e tij, autoriteti kontraktues duhet që të përfshijë edhe një deklaratë me të cilën shpjegohen arsyet për refuzimin ose mohimin e tillë.

3. Nëse, në vendimin e tij, autoriteti kontraktues konstaton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme, dhe ankuesi nuk ka refuzuar, ai brenda pesë (5) ditëve, apo afatit të lejuar nga eksperti, do të ndërmerr çfarëdo veprimi korrigjues të rekomanduar nga eksperti për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj dhe të mënjanojë aq sa është e mundur çdo dëm ose kërcënim që shkon në dëm të parashtruesit të ankesës ose operatorëve të tjerë ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues menjëherë do të informojë panelit shqyrtues, parashtruesin e ankesës dhe operatorët e tjerë përkatës ekonomik për veprimin korrigjues të ndërmarrë.
5. Nëse, brenda afatit kohor të specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni autoriteti kontraktues nuk e nxjerr vendimin që e refuzon ose e mohon vlefshmërinë e një pretendimi ose që nuk e vlerëson farë vlefshmërinë e një pretendimi, ankesa do t'ju referohet panelit shqyrtues.
6. Nëse autoriteti kontraktues e nxjerr një vendim duke konstatuar se një pretendim i bërë në ankesë është i vlefshëm, por ai nuk ndërmerr masa adekuate korrigjuese brenda afatit kohor të specifikuar në paragrafin 5. të këtij neni, parashtruesi i ankesës, pastaj mundet që brenda tri (3) ditëve nga skadimi i afatit të tillë kohor, të dorëzojë një njoftim me shkrim tek paneli shqyrtues dhe autoriteti kontraktues, lidhur me dështimin e autoritetit kontraktues dhe që kërkon nga paneli shqyrtues që të shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë një urdhër për autoritetin kontraktues sipas nenit 105.2.10 të këtij ligji.
7. Nëse autoriteti kontraktues, më kohë e pranon njoftimin me shkrim nga parashtruesi i ankesës sipas paragrafit 6. të këtij neni autoriteti kontraktues brenda tri (3) ditëve pas pranimit të njoftimit në fjalë, do t'i transferojë të gjitha dokumentet dhe shënimet lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit në panelin shqyrtues.

KREU IV PROCEDURAT PARA OSHP-së

Neni 116 Procedurat e vendim-marrjes

1. Çështjet që parashtruesi i ankesës i ka identifikuar në njoftimin e paraqitur në përputhje me paragrafin 5. dhe 6. të nenit 115 i këtij ligji do të shqyrtohen dhe do të vendosen OSHP.
2. Procedurat do të ushtrohen në përputhshmëri me dispozitat e kësaj Pjesë IX dhe Rregulloren e Punës sipas nenit 107 i këtij ligji.
3. Para marrjes së një vendimi përfundimtar mbi një çështje, OSHP mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë. OSHP ka të drejtë që të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të dorëzojë materiale ose dëshmi që me arsye mendon se kanë të bëjnë me çështjen përkatëse. Ngjashëm, OSHP ka të drejtë që të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të sigurojë dëshmi që paneli shqyrtues me arsye mendon se kanë të bëjnë me çështjen përkatëse.
4. Me kërkesë të parashtruesit të ankesës ose autoriteti kontraktues OSHP mund të lejojë për një mundësi të paraqesë informacion shtesë dhe / ose shpjegime. Paragrafi 3 i këtij neni vlen në mënyrë të ngjashme.

5. Nëse cilado palë në procedurë dështon ose refuzon që të marrë pjesë plotësisht në procedurat ose që të përmbushë kërkesat e kësaj Pjese IX, Rregulloren e Punës që përshkruhet në nenin 107 i këtij ligji, ose një urdhër të nxjerrë nga OSHP, paneli shqyrtues e merr vendimin në bazë të provave që i ka në dispozicion dhe në bazë të argumenteve të sjella nga palët me pjesëmarrje aktive në procedurë. OSHP është i autorizuar ta trajtojë (zgjidhë) refuzimin ose dështimin e tillë, siç e sheh të arsyeshme, duke: (i) vendosur mbi çfarëdo çështje ligjore dhe/ose çështje faktike në favor ose kundër palës kundërshtuese, dhe/ose (ii) vendosur mbi çfarëdo pretendimi në favor ose kundër palës kundërshtuese.
6. Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Neni 117

Afati i fundit për marrjen e vendimeve

1. OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen e vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrin të tij.
2. Vendimi i OSHP-së do të publikohet në webfaqen e OSHP-së brenda pesë (5) ditëve në gjuhën origjinale të vendimit dhe brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve sa i përket gjuhëve tjera, si dhe në gjuhën angleze për të gjitha rastet me vlerë të lartë të kontratës.

Neni 118

Siguria, Gjocat dhe Dëmet

1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet të bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare.
2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet.
3. Tarifa duhet t'i kthehet ankuesit, kur OSHP e aprovon ankesën si të bazuar.
4. Nëse paneli shqyrtues konstaton se cilado nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme, OSHP mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës që të paguajë një gjobë shtesë deri në pesëmijë (5.000) Euro. Në raste të tilla, parashtruesi i ankesës është i papërshtatshëm për pjesëmarrje në çfarëdo mënyrë në një aktivitet të prokurimit që mbulohet nga ky ligj përderisa (i) gjoba në fjalë nuk paguhet plotësisht, ose (ii) një gjykatë me kompetente e anulon vendimin e OSHP për pagimin e gjobës në fjalë. Nëse OSHP e vendos një gjobë sipas këtij paragrafit 4 të këtij neni ajo do të lëshojë një urdhër për parashtruesin e ankesës, urdhër ky që kërkon nga ai që (i) të paguajë gjobën në fjalë, (ii) i referohet këtij paragrafit 4. të këtij neni dhe (iii) e njofton parashtruesin e tillë të ankesës se përderisa të paguhet gjoba plotësisht ose përderisa një gjykatë kompetente të mos e anulojë vendimin e lëndës, parashtruesi i ankesës konsiderohet (është) i papërshtatshëm për pjesëmarrje në çfarëdo mënyrë në aktivitetet e prokurimit që mbulohen nga ky ligj.
5. Nëse një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës konstatohet se është i vlefshëm, paneli shqyrtues mundet (i) të caktojë një anëtar për të llogaritur, në përputhshmëri me aktet e aplikueshme normative, dëmet që i janë shkaktuar, nëse ka të tilla,

parashtruesit të ankesës si pasojë e shkeljeve të bëra nga autoriteti përkatës kontraktues, dhe (ii) të nxjerrë një urdhër që kërkon nga autoriteti kontraktues që të ia paguajë shumën e dëmeve parashtruesit të ankesës.

6. OSHP do të hap në pajtim me Rregullat Financiare, një xhirollogari të ndarë me kamatë në një bankë të licencuar komerciale në Kosovë, me qëllim të pranimit dhe mbajtjes së (i) fondeve të pranuar në formë të sigurimit ose një kredi apo garancion bankar që është depozituar si sigurim i tenderit në vijë me paragrafin 1. të këtij neni, dhe (ii) fondet e pranuar nga një gjobë që është vënë sipas paragrafi 4. të këtij neni. OSHP menjëherë do t'i depozitojë dhe mbajë fondet e tilla në këtë xhirollogari. OSHP nuk do t'i kthejë, transferojë ose t'i shfrytëzojë në çfarëdo mënyrë tjetër këto fonde, përveç siç autorizohet saktësisht nga paragrafi 7. të këtij neni.
7. OSHP mund ti lërë fondet e tilla të depozituara në xhirollogarinë e përmendur në paragrafit 6. të këtij neni përderisa (i) kthimi i tyre kërkohej nga paragrafi 3. i këtij neni ose (ii) parashtruesi i ankesës i ka shpenzuar pa sukses të gjitha të drejtat e tij për të apeluar vendimin e panelit shqyrtues, vendim ky i marrë në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni. Pasi që parashtruesi i ankesës ti ketë shpenzuar pa sukses të gjitha të drejtat e tij për të apeluar kundër këtij vendimi dhe asnjë gjykatë me juridiksion kompetent nuk e ka lëshuar një urdhër të OSHP duke e udhëzuar OSHP që t'i sistemojë fondet ndryshe, OSHP do ti trajtojë fondet e tilla, nëse aplikohet, si një gjobë ose dënim dhe do t'i transferojë fondet në fjalë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me dispozitat përkatëse të akteve të aplikueshme normative mbi çështjet buxhetore dhe të përvetësimeve.
8. Nëse një autoritet kontraktues është organizatë buxhetore ose pjesë e një organizatë buxhetore dhe ky autoritet kontraktues nuk e zbaton një aktgjykim përfundimtar të nxjerrë nga OSHP-ja i cili kërkon që autoriteti kontraktues t'i paguajë ankuesit kompensim për dëme ankuesi mund të veprojë në bazë të dispozitave të nenit 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë për të siguruar pagesën.

Neni 119 **Veprimet e Gjykatave**

1. Nëse parashtruesi i ankesës mendon se vendimi përfundimtar ose konstatimi i një paneli shqyrtues ose OSHP është në kundërshtim me faktet ose me këtë ligj, parashtruesi i ankesës mund të kërkojë nga Gjykata Themelore shqyrtimin e vendimit. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit të vendimit të OSHP-së në përputhje me paragrafin 2. të nenit 117 të këtij ligji.
2. Nëse, pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e mëparshme që i është dorëzuar OSHP nuk ka qenë i pavlefshëm, gjykata do të lëshojë një urdhër duke kërkuar nga OSHP që të ia kthejë parashtruesit të ankesës dhe çfarëdo gjobe që i është vendosur atij sipas nenit 118 të këtij ligji.
3. Nëse pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e tij të mëparshme që i është dorëzuar OSHP-së është bërë në mënyrë të vlefshme, gjykata lëshon një urdhër (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marrë nga OSHP-ja, dhe/ose (ii) nëse parashtruesi i ankesës mund të demonstrojë se ai është dëmtuar nga veprimi ose mos-veprimi i autoritetit kontraktues, atëherë gjykata gjithashtu mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues që t'ia paguajë parashtruesit të ankesës kompensimin për dëmin e shkaktuar.

KREU V **RAPORTIMI**

Neni 120

Raportimi në Kuvend

OSHP do t'i raportojë çdo vit Kuvendit mbi mbarëvajtjen e procedurave të përcaktuara të shqyrtimit të prokurimit ose në bazë të kësaj Pjese IX.

Neni 121

Dërgimi i Informacioneve

1. Për çdo vit kalendarik, OSHP do t'i sigurojë Kuvendit, më së voni deri në fund të shkurtit të vitit pasues kalendarik, informacionet dhe të dhënat në vijim, sipas llojeve të procedurave dhe objekteve të aktivitetit përkatës të prokurimit:
 - 1.1. numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar;
 - 1.2. numrin e ankesave të refuzuara për shkak të mungesës së afateve kohore ose joplotësisë sipas nenit 109 të këtij ligji ose nenit 111 të këtij ligji ose dështimin për të depozituar sigurimin e kërkuar nga neni 118 të këtij ligji;
 - 1.3. numrin e ankesave që janë konstatuar se nuk përmbajnë pretendime të vlefshme;
 - 1.4. numrin e aktiviteteve të prokurimit që janë anuluar si rezultat i një ankese;
 - 1.5. informata të detajuara mbi çdo ngjarje ku autoriteti kontraktues ka dështuar në respektimin e një urdhërese të OSHP-së; dhe
 - 1.6. numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar në konstatimin se aktiviteti përkatës i prokurimit dhe dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme.
2. Qeveria, në konsultim me OSHP dhe në bazë të informacioneve që janë përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni do të përgatisë propozimin e masave që kanë për qëllim reduktimin ose eliminimin e disa shkeljeve të caktuara dhe të përsëritura, duke përfshirë edhe përgatitjen e propozim-amendamenteve për këtë ligj.

PJESA X

PROCEDURAT E POSAÇME TË PROKURIMIT PËR MISIONET DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE

Neni 122

Përgjegjësitë për Prokurim në Misionet Diplomatike dhe Konsullore

1. Nënshkrimi i kontratave për vlera minimale dhe të vogla, në aktivitetet e prokurimit të Misioneve diplomatike dhe konsullore, bëhet nga shefi i Misionit diplomatik apo konsullor ose i autorizuari i tij.
2. Nënshkrimi i kontratave për vlera të mesme dhe të mëdha në aktivitetet e prokurimit të cilat autorizohet të kryhen nga shefi i Misionit diplomatik/konsullor apo i autorizuari i tij, nënshkruhen nga shefi i misionit/diplomatik.
3. Shefi i Misionit diplomatik/konsullor është përgjegjës për shpenzimet e buxhetit brenda Misionit diplomatik/konsullor.
4. Neni 26 i këtij ligji, paragrafi 1., 2., 3. dhe 4. nuk aplikohet në misionet diplomatike/konsullore.

Neni 123
Kontratat me Vlerë të Mesme dhe të Madhe

Aktivitetet e prokurimit të vlerave të mesme dhe të mëdha për misionet diplomatike dhe konsullore zhvillohen nga Ministria e Punëve të Jashtme në pajtim me procedurat e përcaktuara në LPP, me përjashtim të aktiviteteve të prokurimit të cilat barten te misionet diplomatike/konsullore.

Neni 124
Miratimi

1. Aktivitet e prokurimit për vlera të mesme dhe të mëdha për blerjen e automjeteve, sigurimet shëndetësore, renovimet dhe adaptimet të hapësirave të objektit të misioneve, sigurimin e objektit të misioneve zhvillohen në Misionet diplomatike/konsullore pas miratimit nga Ministri i ministrisë përkatëse për punë të jashtme.
2. Në shtetet pranuese, ku formularët e dosjes së tenderit nuk gjejnë zbatim, formularët do të konsiderohen jo – obligativ. Në këtë rast lejohet përdorimi i formave standarde të operatorëve ekonomik në shtetin pranues.

Neni 125
Përdorimi i Procedurës së Negociuar

1. Misionet diplomatike/konsullore mund të përdorin procedura të negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e kontratës për blerjen e automjeteve për misione, sigurimet shëndetësore, renovimet dhe adaptimet të objektit të misionit dhe sigurimin e objektit të misionit.
2. Shefi i misionit diplomatik/konsullor paraprkisht duhet të bëjë një kërkesë me shkrim te ZKA me arsyetimin e nevojës për blerjen e automjeteve. Pas miratimit të kërkesës themelohet një komision në MPJ nga ZKA, i cili bën vlerësimin e markave më të përshtatshme të automjeteve dhe të vendosë për llojin dhe specifikat e automjetit i cili duhet të blihet në misionet diplomatike/konsullore. Pas vendimit të Komisionit të MPJ, në misionet diplomatik shefi i misionit diplomatik themelon një komision për zhvillimin e negociatave të drejtpërdrejta për blerjen e automjeteve me përfaqësuesit e njohur të markave të automjeteve ose përfaqësitë e këtyre prodhuesve mbi bazën e parimeve të transparencës jo diskriminimit dhe ekonomicitetit, Shefi i Misionit diplomatik/konsullor është përgjegjës për nënshkrimin dhe pranimin e automjetit.
3. Për procedurat e blerjes dhe marrjes me qira të objekteve për misionet diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës sipas propozimit të Ministrisë përkatëse për punë të jashtme dhe Ministrisë përkatëse për financa, nxjerr akt nënligjor.

Neni 126
Përdorimi i Procedurës së Kuotimit të Çmimeve

1. Për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit për misionet diplomatike/ konsullore, të cilat nuk tejkalojnë vlerën njëmijë (1.000) Euro, bëhet përjashtimi i procedurave të prokurimit të përcaktuara në nenin 37 të LPP-së.
2. Misionet Diplommatike dhe Konsullore zhvillojnë procedurat e kuotimit të çmimit për furnizime dhe shërbime për nevojat e veta.
3. KRRP-ja përcakton procedure të veçantë për kuotimin e çmimit për misionet diplomatike/konsullore dhe harton legjislacionin sekondar për këtë procedurë brenda tridhjetë (30) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Në raste kur formularët e kuotimit të çmimit të aprovuara nga KRPP-ja nuk gjejnë zbatim, me qëllim të realizimit të procedurave, bëhet përjashtimi i këtyre formularëve dhe ofertat e marra nga ana e ofertuesve janë të barasvlershme.
5. Ministria përkatëse për Punë të Jashtme mbikëqyr kryerjen dhe përfundimin e këtyre procedurave.

Neni 127
Mos zbatimi i neneve 57 dhe 63

Nenet 57 dhe 63 të këtij ligji nuk zbatohen në misionet diplomatike/konsullore.

Neni 128
Konsultimi mes KRPP dhe MPJ

Të gjitha çështjet të cilat i referohen procedurave të prokurimit publik në misionet diplomatike që nuk janë të rregulluara me këtë ligj, rregullohen me akte nënligjore të KRPP-së në konsultim me Ministrinë përkatëse për punë të jashtme.

PJESA XI Neni 129
Prokurimi Elektronik

1. KRPP-ja është e autorizuar të nxjerrë rregulla në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese.
2. Metodatat e prokurimit elektronik mund të përfshijnë një sistem dinamik të blerjes dhe blerjeve elektronike.
3. KRPP-ja është e autorizuar që të nxjerrë rregulla në lidhje me pajisjet e dorëzimit elektronik dhe pranimin e tenderëve si dhe për pajisjet për pranimin elektronik të kërkesave për pjesëmarrje. Këto rregulla duhet të përfshijnë një nënshkrim të avancuar elektronik, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
4. Përdorimi i prokurimit elektronik është i obligueshëm, në momentin kur Qeveria e Kosovës merr vendim për këtë çështje.

PJESA XII
MJETET JURIDIKE, DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE PËRFUNDIMTARE

KREU I
SHKELJET E LIGJIT DHE NDËSHKIMET

Neni 130
Ndikimi i Paligjshëm

1. Pa paragjykuar dhe sipas ligjit përkatës penal dhe ligjit tjetër në fuqi, konsiderohet shkelje e këtij ligji, e dënueshme dhe e zbatueshme në pajtim me ligjin në fuqi përkatës për çdo person:
 - 1.1. sigurojë, ofrojë, kërkojë, ose pranojë ose të tregojë gatishmëri për të siguruar, ofruar, kërkuar ose pranuar diç që është e vlefshme (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, para, ofertë pune, pasuri materiale dhe jomateriale, favorizim ose shërbime) për përfitimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose pasurimin e punonjësit ose të ish punonjësit, zyrtarit ose ish zyrtarit të një autoriteti kontraktues, ose të një personi apo ndërmarrje që ka lidhje me ose që bashkëpunon me punonjësin, ish punonjësin, zyrtarin ose ish zyrtarin, në tërësi ose pjesërisht për të ndikuar ose tentuar për të ndikuar në vendimin ose masat

që dëmtojnë, ose lidhen me iniciimin, zbatimin ose rezultatet e aktivitetit të prokurimit ose shqyrtimit;

- 1.2. të ndërmarrë masa, ose të tregojë gatishmëri për të marrë masa, me qëllim të frikësimit, shtrëngimit, dëmtimit ose shkaktimit të dëmit (fizik, financiar ose të ndryshëm) të ndonjë personi ose ndërmarrje, në tërësi ose pjesërisht me qëllim që të ndikojë, të tentojë të ndikojë ose të hakmerret për një vendim ose veprim lidhur me iniciimin, zbatimin ose rezultatet e aktivitetit të prokurimit ose shqyrtimit.
 - 1.3. të kërkojë ose të hyjë në çfarëdo marrëveshje, aranzhim ose mirëkuptim me çfarëdo personi ose ndërmarrje tjetër, nëse marrëveshja, aranzhimi ose mirëkuptimi i tillë ka për qëllim që të ndikojë ose të parandalojë, kufizojë ose të ngatërroj konkurrencën për cilëndo kontratë publike; ose
 - 1.4. të ia lehtësojë ose ta inkurajojë cilindo person ose ndërmarrje që të merret me cilëndo nga veprimet e specifikuar në pikat “1.1”, “1.2” ose “1.3” më lartë.
2. Nën-paragrafi 1.3. i paragrafit 1. të këtij neni nuk do të zbatohet gjatë negociatave ose ekzekutimit të marrëveshjeve formale me shkrim të një grupi të operatorëve ekonomik, nëse marrëveshja e tillë ka të bëjë me themelimin e grupit dhe kështu të përgatitë tenderin.
 3. Çdo nëpunës civil, punonjës ose zyrtar i autoritet kontraktues që vihet në dijeni, përmes çfarëdo mjeti, për veprën e përshtetur në paragrafin 1. të këtij neni ose për ndonjë rast që pritet të përfshijë një vepër të tillë, menjëherë duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme.
 4. Me të mësuar për një shkelje ose ngjarje të tillë, Ministria e Punëve të Brendshme menjëherë zhvillon hetime paraprake lidhur me çështjen, dhe nëse ka arsye të mjaftueshme për të konstatuar se një shkelje e tillë ka ndodhur, Ministria zyrtarisht ia përcjell çështjen agjencionit për zbatimin e ligjit për hetime të mëtejme, në përputhje me ligjin në fuqi, për të ndërmarr të gjitha masat e tjera të nevojshme të cilat Ministria i konsideron të domosdoshme dhe të përshtatshme për të rregulluar gjendjen.
 5. Çdo person ose ndërmarrje që me dashje ose nga pakujdesia e rëndë ofron, ose shkakton ose nxit personin tjetër ose ndërmarrjen për të siguruar, informacione përmbajtësish të pasakta ose mashtruese, dëshmi ose të dhëna Ministrisë së Punëve të Brendshme ose zyrës së prokurorit publik duke pohuar ose duke tentuar të dëshmoj ose të mos e pranoj veprën penale të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni i nënshtrohet ndjekjes penale sipas ligjit penal të Kosovës për një vepër të tillë dhe po ashtu përgjigjet për të gjitha dëmet financiare dhe dëmet e tjera që ai u ka shkaktuar personave të tretë dhe ndërmarrjeve.
 6. Kur një kundërvajtje e saktësuar në paragrafin 1. të këtij neni pretendohet të jetë kryer nga ose në emër të ndërmarrjes, personi ose personave fizik që faktikisht janë të përfshirë në rastet që kanë shkaktuar ndjekjen penale të një veprimi të tillë, po ashtu ndiqen penalisht për këtë. Veç kësaj, çdo drejtor ose zyrtar i lartë ekzekutiv i ndërmarrjes së tillë që ka qenë në dijeni ose - sipas kujdesit të arsyeshëm drejtues - është dashur të ketë qenë në dijeni për rastet që kanë shkaktuar ndjekjen e veprës së tillë penale, po ashtu do të ndiqen penalisht. Kur vepra penale është vepër penale e paraparë në paragrafin 5. të këtij neni, personat, drejtorët dhe zyrtarët e tillë, së bashku me ndërmarrjen, do të përgjigjen në mënyrë të përbashkët për të gjitha dëmet financiare ose dëmet e tjera që u kanë shkaktuar personave të tretë ose ndërmarrjeve.

Neni 131

Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues

OSHP-ja do të vendosë një gjobë prej jo më pak se pesëmijë (5.000) Euro për autoritetin kontraktues që nuk zbaton një urdhër ose për mosrespektimin e urdhrit të OSHP-së brenda

pesë (5) ditëve.

Neni 132
Prokurimet e Mbyllura në Kundërshtim me Këtë Ligj

1. Kontrata publike ose konkursi i projektimit mund të shfuqizohen pjesërisht ose plotësisht nga OSHP ose një gjykatë, nëse të përmendurit konstatojnë se kontrata publike ose konkursi i projektimit:
 - 1.1. ishte dhënë pa publikimin e mëhershëm të njoftimit kur ishte kërkuar nga ky ligj;
 - 1.2. ishte përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontratës;
2. Në rast se OSHP ose një gjykatë konstaton se një kontratë publike ose konkurs projektimi mund të shfuqizohet për shkaqet e përcaktuara në nenin 132.1, OSHP ose gjykata mund të nxjerrë urdhër:
 - 2.1. për shfuqizimin e kontratës publike, pjesërisht ose plotësisht;
 - 2.2. për detyrimin e autoritetit kontraktues që të kryejë një prokurim të ri për kontratën publike ose konkursin e projektimit ose cilëndo pjesë të tyre që nuk është ekzekutuar ende në masë kënaqshme;
 - 2.3. nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuara nga ana e operatorit ekonomik gjatë aktivitetit të prokurimit, për ta detyruar operatorin ekonomik që të paguajë dëmet e shkaktuara autoritetit kontraktues dhe/ose një operatori tjetër ekonomik të dëmtuar nga sjelljet e tilla;
 - 2.4. nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuara nga ana e autoritetit kontraktues gjatë aktivitetit të prokurimit, për ta detyruar autoritetin kontraktues që të paguajë dëmet e shkaktuara cilitdo operator ekonomik që është dëmtuar nga shkeljet e tilla.
3. Gjatë vendosjes për shfuqizimin e një kontrate publike ose konkursi të projektimit, pjesërisht ose plotësisht, OSHP ose gjykata duhet të marrin parasysh dëmet në interesin publik që mund të rezultojnë nga ky veprim. Nëse OSHP ose gjykata konstaton se shfuqizimi do të kishte pasoja të rënda në interesin publik, atëherë OSHP ose gjykata nuk do të shfuqizojnë kontratën publike ose konkursin e projektimit, por do të përpiqen ta rregullojnë çështjen përmes nxjerrjes së një urdhri për kompensimin e dëmit sipas nën-paragrafëve 2.3 dhe/ose 2.4 paragrafi 2. të këtij neni.
4. Nëse një urdhër i nxjerrë nga OSHP ose gjykatë sipas këtij neni është subjekt i shqyrtimit gjyqësor ose procedurës ankimore, dhe operatori ekonomik dhe/ose autoriteti kontraktues e njofton me kohë organin urdhërues për qëllimin e tij që të paraqesë ankesë ose kërkesë për shqyrtim, organi urdhërues e pezullon përmbarimin e urdhrit deri në kohën kur urdhri nuk do të jetë më subjekt i shqyrtimit gjyqësor ose procedurës ankimore. Në këto raste, organi urdhërues duhet që menjëherë të urdhërojë operatorin ekonomik dhe/ose autoritetin kontraktues që menjëherë të depozitojë sigurim për përmbarimin e urdhrit, në një shumë e cila është së paku e barasvlershme me (i) dëmet, nëse ka të këtilla, që janë përcaktuar në urdhër, dhe (ii) çfarëdo shume tjetër të arsyeshme që organi urdhërues e konsideron të nevojshme për të siguruar të drejtat e palëve të tjera dhe/ose për të siguruar përmbarimin e urdhrit, nëse i njëjti konfirmohet nga shqyrtimi gjyqësor ose procedura ankimore. Sigurimi i kërkuar nga ky paragraf mund të depozitohet në të njëjtën mënyrë sikurse sigurimi i tenderit ose sigurimi i përmbarimit
5. Nëse operatori ekonomik dhe/ose autoriteti kontraktues nuk e bën depozitimin e sigurimit të kërkuar sipas paragrafit 4. të këtij neni brenda shtatë (7) ditëve pasi të jetë informuar

për shumën e sigurimit, urdhri nuk do të konsiderohet i pezulluar dhe i njëjti mund të përmbahet menjëherë.

6. Asgjë në këtë Nen ose në cilëndo dispozitë tjetër të këtij ligji, nuk e kufizon dhe nuk mund të interpretohet për të kufizuar pushtetin e gjykatës që (i) të pezullojë cilindo aktivitet prokurues të autoritetit kontraktues dhe cilëndo procedurë të OSHP-së ose një gjykatë të shkallës më të ulët gjatë ankimit para gjykatës ose procedurës së shqyrtimit, (ii) të pezullojë, ndryshojë ose vërtetojë çfarëdo urdhri të nxjerr nga OSHP ose një gjykatë më e ulët, (iii) të nxjerrë çfarëdo urdhri të përkohshëm që duhet të respektohet gjatë ankimit para gjykatës ose procedurës së shqyrtimit; ose (iv) të nxjerrë çfarëdo urdhri tjetër që gjykata e konsideron të nevojshëm për të ruajtur gjendjen ekzistuese ose përmbartimin e një vendimi që mund të nxirret në të ardhmen nga gjykata për këtë çështje.

Neni 132/A

Kontraktimi i shërbimeve nga OSHP

Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile.

Neni 133

Deklaratat e jo-efektivitetit

1. Kontrata publike ose konkursi i projektimit do të shfuqizohen pjesërisht ose plotësisht joefektive, nga OSHP ose një gjykatë, nëse konstatohet se kontrata publike ose konkursi i projektimit për cilëndo arsye të cekur në paragrafin 1. të nenit 132 të këtij ligji.
2. OSHP ose një gjykatë mund të vendosë se një kontratë nuk duhet të jetë i joefektive, edhe pse ajo ishte dhënë në mënyrë të paligjshme mbi bazën e përmendur në paragrafin 1., në qoftë se pasi ka shqyrtuar të gjitha aspektet relevante, ka arsye thelbësore që lidhen me një interes të përgjithshëm që kërkojnë që efektet e kontratës duhet të mbahen. Me kusht që:
 - 2.1. interesat ekonomike në efektivitetin e kontratës mund të konsiderohen si arsyet mbizotëruese në rrethana të jashtëzakonshme joefektiviteti do të çojnë në pasoja jo-proporcionale.
 - 2.2. interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejt me kontrata përkatëse nuk do të përbëjnë arsye thelbësore në lidhje me një interes të përgjithshëm.
 - 2.3. interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejt me kontratën përfshijnë, inter alia, shpenzimet që rezultojnë nga vonesa në zbatimin e kontratës, shpenzimet që rezultojnë nga nisja e procedurave të reja të prokurimit, shpenzimet që rezultojnë nga ndryshimi i operatorit ekonomik kryerjen e kontratës dhe në shpenzimet e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga jo-efektiviteti.
3. Një kontratë nuk do të deklarohet të jetë e joefektive edhe në qoftë se ka baza për të bërë kështu, nëse:
 - 3.1. autoriteti kontraktues mendon se dhënia e një kontrate pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës është në pajtim me këtë ligj,
 - 3.2. autoriteti kontraktues ka publikuar një njoftim duke shprehur synimin e tij për lidhje kontratën, dhe,
 - 3.3. kontrata nuk ka përfunduar para skadimit të një periudhe prej të paktën dhjetë (10) ditë, me efekt nga dita që pason datën e publikimit të këtij njoftimi.
4. Kur OSHP ose një gjykatë vendos që mos ta shpall një kontratë si jo efektive edhe pse ka bazë për një deklaram të tillë atëherë ajo do të marrë parasysh nëse ajo mund të

imponojë gjoba alternative në formë të gjobës tek autoriteti kontraktues siç është cekur në nenin 132 të këtij ligji. Dëshmipërblimi nuk do të përbën një ndëshkim të përshtatshëm alternativ.

5. Cilado palë e interesuar siç përmendet në paragrafin 6. të këtij neni mund të kërkojë një deklaratë të jo-efektivitetit nga OSHP ose gjykata. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet
- 5.1. para skadimit të tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit të shpërblimit të kontratës; ose
- 5.2. autoriteti kontraktues informoi ofertuesit dhe kandidatët në fjalë për arsyet përkatëse për përfundimin e kontratës.
6. Ofertuesit do të konsiderohen të jenë një palë me interes, nëse ato nuk janë përjashtuar definitivisht ende nga një tender dhe se një përjashtim është definitiv nëse ajo ka qenë e njoftuar për këtë tender dhe ka qenë konsideruar i ligjshëm ose nga një organ i pavarur ose nuk mund ti nënshtrohet një procedure shqyrtimi.
7. Kandidatët do të konsiderohen të jenë një palë me interes, nëse autoriteti kontraktues nuk vënë informatat në dispozicion në lidhje me refuzimin e aplikimit të tyre para njoftimit të vendimit për dhënien e kontratës të tenderuesit në fjalë.

KREU II DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 134 Shfuqizimi i Legjislacionit të Mëparshëm

1. Ky ligj dhe rregullat e prokurimit publik që do të nxirren sipas këtij ligji do t'i zëvendësojnë të gjitha legjislacionet paraprake dhe rregullat mbi prokurimin publik në Kosovë. Legjislacioni i mëparshëm në fjalë dhe rregullat do të dalin nga fuqia në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Ky ligj aplikohet për aktivitetet e prokurimit të publikuara pas hyrjes së ligjit në fuqi ndërsa sa i përket aktiviteteve të prokurimit pa publikim procedurat e tilla të iniciuara pas të njëjtës kohë.
3. Me fillimin e zbatimit të këtij ligji, anëtarët e bordeve aktuale do të vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e përcaktuara nga ky ligj deri në skadimin e mandatit të tyre.

Neni 135 Hyrja në fuqi e ligjit

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-042 29 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-032-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.